



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTESA**  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL



# BULETINI

**I PANELIT ZGJEDHOR  
PËR ANKESA DHE  
PARASHTESA**

**VËLLIMI nr. III**  
Praktika e vendimeve



# **BULETINI**

## **I PANELIT ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**

**VËLLIMI nr. III**  
Praktika e vendimeve

## ZGJEDHJET E PARAKOHSHME PËR KUVENDIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS GJATË VITIT 2019

1.	<b>Mos emërimi i anëtarëve të KKZ-së</b>	10
	VENDIMI - Anr.01/2019	
2.	<b>Kundër Udhëzimit Nr.965/2019</b>	12
	VENDIMI - nr.04/2019	
3.	<b>Tërheqje nga lista e kandidatëve për deputet</b>	17
	VENDIMI - nr.09/2019	
4.	<b>Mos emërimi i anëtarëve në listën e KVV</b>	19
	VENDIMI – Anr.84/2019	
5.	<b>Mos përfshirja në listën e votuesve Jashtë Kosovës si votues</b>	20
	VENDIMI - Anr.39/2019	
6.	<b>Mos përfshirja në listën e votuesve Jashtë Kosovës si votues-pa interes juridik</b>	21
	VENDIMI – Anr. 36/2019	
7.	<b>Përdorimi i gjuhës së urrejtjes</b>	24
	VENDIMI Anr.90/2019	
8.	<b>Përdorimi i fëmijëve në fushatë zgjedhore</b>	28
	VENDIMI – Anr.95/2019	
9.	<b>Përdorimi i pjesëtarëve të institucioneve shtetërore gjatë fushatës zgjedhore</b>	30
	VENDIMI –Anr.108/2019	
10.	<b>Vendosja e materialit zgjedhor në hapësira publike</b>	32
	VENDIMI – Anr.124/2019	
11.	<b>Shpërndarja e materialit ushqimor, presion ndaj votuesve për të votuar subjektin e caktuar politik</b>	34
	VENDIMI – Anr.127/2019	
12.	<b>Përdorimi i gjuhës denigruese, fyese, nxitëse dhe ofenduese</b>	36
	VENDIMI – Anr.148/2019	
13.	<b>Bërja e fushatës zgjedhore me fëmijë të mitur</b>	40
	VENDIMI – Anr.169/2019	
14.	<b>Thyerja e heshtjes zgjedhore-dërgimit të mesazhit telefonik</b>	43
	VENDIM - Anr.329/2019	
15.	<b>Thyerja e heshtjes zgjedhore-dërgimit të mesazhit telefonik</b>	45
	VENDIM- Anr. 332/2019	
16.	<b>Thyerja e heshtjes zgjedhore- vendosjes se postereve në afërsi të qendrës se votimit 100 metra,</b>	47
	VENDIM- Anr. 326/2019	
17.	<b>Humbja e Fletëvotimeve,</b>	50
	VENDIMI –Anr. 344/2019	
18.	<b>Vendosja e flamujve ne vendvotim,</b>	53
	VENDIMI –Anr. 346/2019	
19.	<b>Votim me dokumente të UNMIK- ut dhe dokumente të shtetit serb,</b>	57
	VENDIMI –Anr. 366/2019	
20.	<b>Rezultatet preliminare, numërimi i pakove me fletëvotime nga jashtë, në QNR,</b>	60
	VENDIMI Anr.375/2019	
	VENDIMI Anr.375-2/2019	

21.	Rezultatet përfundimtare-pako të fletëvotimeve të dorëzuara nga persona të paautorizuar, VENDIMI Anr.428/2019	63
-----	--	----

## ZGJEDHJET E PARAKOHSHME PËR KUVENDIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS GJATË VITIT 2021

22.	Kundër vendimit të KQZ-së, për verifikimin e aplikacioneve të votuesve jashtë Kosove VENDIMI – Anr. 1/2021	66
23.	Mos përfshirja në listën e votuesve Jashtë Kosovës VENDIMI – Anr. 19/2021	68
24.	Kundër vendimit të KQZ-së, për certifikimin e kandidatit E.N në listën e kandidatëve të komunitetit tjetër VENDIMI - Anr.14/2021	69
25.	Mos certifikimi i plotë i listës së kandidatëve për deputet të subjektit politik VENDIMI - Anr.5/2021	72
26.	Përdorimi i gjuhës denigruese dhe nxitëse VENDIMI – Anr.351/2021	77
27.	Përdorimi i gjuhës së urrejtjes VENDIMI Anr.352/2021	81
28.	Vendosja e shiritave të kuqe në vende publike VENDIMI Anr.365/2021	85
29.	Përdorimi i gjuhës denigruese dhe nxitëse VENDIMI – Anr.366/2021	87
30.	Shënimi i grafikëve me përmbajtje zgjedhore në hyrje të oborrit të shkollës VENDIMI – Anr.371/2021	90
31.	Mbajtje e tubimit elektoral në ambient të mbyllur VENDIMI – Anr.502/2021	92
32.	Thyerja e heshtjes zgjedhore- sponzorim i fushatës zgjedhore në rrjetin social “Facebook”, në ditën e heshtjes zgjedhore dhe në ditën e votimit, VENDIM - Anr.378/2021	94
33.	Thyerja e heshtjes zgjedhore- mbajtje e tubimit, në ditën e heshtjes zgjedhore, VENDIM- Anr. 439/2021	97
34.	Thyerja e heshtjes zgjedhore- bërja e fushatës duke dhënë deklaratë publike, në ditën e heshtjes zgjedhore gjatë votimit, VENDIM - Anr. 419/2021	100
35.	Presion ndaj votuesve, VENDIM - Anr. 457/2021	104
36.	Rezultatet përfundimtare, votat e fituara në disproporcion me numrin e votuesve. VENDIMI Anr.656/2021	107

## ZGJEDHJET LOKALE GJATË VITIT 2021

37.	<b>Mos certifikimi i Subjektit Politik-për mos ndryshim të emërtimit</b>	<b>110</b>
	VENDIMI - Anr.548/2021	
38.	<b>Largimi nga lista e kandidatëve për kryetar komune</b>	<b>114</b>
	VENDIMI - Anr.537/2021	
39.	<b>Largimi nga lista e kandidatëve për këshilltar komunal</b>	<b>116</b>
	VENDIMI - Anr.568/2021	
40.	<b>Vendosja e posterit në objekt privat</b>	<b>120</b>
	VENDIMI – ZL.Anr.605/2021	
41.	<b>Pjesëmarrja e përfaqësuesve të bashkësive fetare në tubime politike</b>	<b>122</b>
	VENDIMI – ZL.Anr.1110/2021	
42.	<b>Thyerja e heshtjes zgjedhore-Sponsorizim i Fushatës Zgjedhore gjatë heshtjes zgjedhore nëpërmjet Facebookut,</b>	<b>125</b>
	VENDIM - Anr.647/2021	
43.	<b>Thyerja e heshtjes zgjedhore- Qëndrimi në afërsi të Qendrës së Votimit,</b>	<b>127</b>
	VENDIM - Anr.1136/2021	
44.	<b>Manipulim dhe vjedhja e votave në ditën e votimit,</b>	<b>129</b>
	VENDIMI - Anr.664/2021	
45.	<b>Fotografim i votës gjatë votimit,</b>	<b>130</b>
	VENDIMI - Anr.671/2021	
46.	<b>Votim i dyfishtë,</b>	<b>132</b>
	VENDIMI - Anr.697/2021	
47.	<b>Rezultatet preliminare, fletëvotime të pavulosura në vendvotim,</b>	<b>134</b>
	VENDIMI Anr.673/2021	
48.	<b>Rezultatet preliminare, tentim për blerje të votës dhe ndikim tek votuesit,</b>	<b>136</b>
	VENDIM Anr.693/2021	
49.	<b>Rezultatet përfundimtare për kandidatët për anëtarë të kuvendit komunal,</b>	<b>140</b>
	VENDIMI Anr. 783/2021	
50.	<b>Rezultatet përfundimtare, Raundi i II-të, i Zgjedhjeve Lokale 2021</b>	<b>144</b>
	VENDIMI Anr. 1143/2021	



## Parathënie

Edicioni i tretë i Buletinit paraqet përmbledhjen e pesëdhjetë (50) vendimeve më të rëndësishme që Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa ka nxjerr për tri palë zgjedhje të organizuara në Kosovë në vitin 2019 dhe në vitin 2021 lidhur me ankesat e parashtruara nga subjektet politike, kandidatet për deputet për Kuvend të Republikës e Kosovës, kandidatet për anëtar të Kuvendeve Komunale, kandidatet për Kryetar të Komunave, Organizatave Jo Qeveritare, qytetarët etj. për të gjitha fazat e procesit zgjedhor dhe atë për:

***Para fushatën zgjedhore, fushatën zgjedhore, thyerjen e heshtjes zgjedhore, ditën e zgjedhjeve, administrimin e Rezultateve në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR).***

Vendimet e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa të përzgjedhura dhe që do të perfshihen/paraqiten në Edicionin e tretë të Buletinit janë ato që kanë të bëjnë lidhur me: anulimin e të gjitha fletëvotimeve të dorëzuara përmes postës dhe përsëritja e procesit të votimit nga jashtë, për Raundin e Dytë të zgjedhjeve, për kryetar të Komunës së Dragashit, rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për kandidatët për Kuvend Komunal në Mitrovicën e Jugut, anulimi në tërësi i votave për subjektet politike boshnjake në këto Komuna: Zubin Potok, Shtërpçë, Ranillug, Graçanicë, Partesh, Klllokot dhe Novobërdë, për Ujedinjina Zajednica - Adrijana Hodzic, Koalicioni – VAKAT, Social Demokratska - UNIJA SDU, Nasha Iniciativa- Nasha, Nova Demokratska Stranka, pastaj shpallja e pa vlefshme e 3782 (tre mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e dy) pakove me fletëvotime të ardhura nga Republika e Serbisë, të dorëzuara në Postën Nr. 6, në Rrugën “Agim Ramadani”, të dorëzuara nga dy persona të paautorizuar në fahun postal të Kosovës.

Gjatë procesit zgjedhor për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të mbajtura në vitin 2019 dhe 2021, si dhe Zgjedhjeve Lokale të mbajtura në vitin 2021, janë parashtruar, 666 ankesa dhe 1765 apele, gjithsej 2431 ankesë/apel të parashtruara në PZAP

Për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura me datën 06 tetor 2019, janë parashtruar 325 ankesa dhe 189 apele, ku sa i përket mënyrës së marrjes së vendimeve nga këto janë miratuar 194 ankesa/apete si të bazuara, 181 ankesa/apete të refuzuar si të pabazuara, 78 ankesa/apete të hedhura si të palejuara, 41 ankesa/apete të hedhura si të pasafatshme, 20 ankesa/apete të hedhura si të parregullta dhe 1 ankesë është konsideruar e tërhequr.

Gjatë zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të mbajtura me 14 Shkurt 2021, janë parashtruar 189 ankesa dhe 583 ankesa/apete, ku sa i përket mënyrës së marrjes së vendimeve janë të miratuara 325 ankesa/apete, 319 ankesa/apete janë refuzuar si të pabazuara, 70 ankesa/apete të hedhura si të palejuara, 51 ankesa/apete të hedhura si të pasafatshme, 9 ankesa/apete të hedhura si të parregullta, 1 ankesë është konsideruar e tërhequr.



Ndërsa, gjatë procesit zgjedhor për Zgjedhjet Lokale në Republikës së Kosovës të mbajtura me 17 Tetor 2021, janë parashtruar 152 ankesa dhe 993 apele, ku sa i përket mënyrës së marrjes së vendimeve janë të miratuara 224 ankesa/apele, 793 ankesa/apele janë refuzuar si të pabazuara, 90 ankesa/apele janë hedhura si të palejuara, 18 ankesa/apele janë hedhur si të pasaftrashme, 13 ankes/apele janë hedhur si të parregullta, 2 ankesa/apele janë konsideruar të tërhequra dhe 2 janë përcjellë në kompetencë të mëtutjeshme në Komisionine Pavarur të Medie - KPM.

Vlen të theksohet se rëndësia e këtij buletini është një mundësia e mirë për të gjithë personat të cilët kanë interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-së, ose të drejtat e të cilëve ju shkelen në të ardhmen për sa i përket procesit zgjedhor të rregulluar sipas Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme ti përdorin këto raste dhe praktika të vendimeve për mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave të tyre në zgjedhjet e ardhshme.

Qëllimi i publikimit të vendimeve të PZAP-it është informimi i opinionit të gjerë publik se anëtarët e PZAP-it, i marrin vendimet e tyre në mënyrë të pavarur dhe plotësisht transparente, duke zbatuar standardet më të larta të të drejtave të njeriut të garantuara me kushtetutë.

Në fund, dëshiroj të falënderoj dhe të shpreh mirënjohjen time të veçantë për të gjithë stafin e PZAP-it, për angazhimin, përkushtimin dhe kontributin e tyre dhe është bërë i mundur publikimi i Edicionit të tretë të Buletinit me vendime të PZAP-it.

Shukri SYLEJMANI  
Kryesues i PZAP-it

## Të drejtat e autorit

Asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet apo transmetohet në çfarëdo forme apo përmes çfarëdo mjetesh, elektronike apo mekanike, duke përfshirë fotokopjimin dhe incizimin, apo ruajtjen në sisteme ripërdorimi, pa lejen paraprake me shkrim nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, përveç nëse një kopjim i tillë në mënyrë të qartë lejohet nga ligji përkatës për të drejtat e autorit.


## Përrjashtim i përgjegjësisë

Sipas nenit 118.3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme të Republikës së Kosovës, vendimet e PZAP-it publikohen në përputhshmëri me rregullat dhe procedurat e PZAP-it. Ky Buletin nuk zëvendëson burimin primar për vendimet e PZAP-it. Në rast të ndonjë konflikti apo mospërputhje në mes të vendimeve të botuara në këtë Buletin dhe vendimeve të publikuara nga PZAP-i, mbizotëron versioni origjinal i vendimit i arkivuar në arkivin e PZAP-it, dhe i cili është i publikuar në web faqen zyrtare të PZAP-it. Qëllimi i përmbledhjes së vendimeve është për të dhënë një pasqyrë të përgjithshme faktike dhe juridike të rasteve dhe një përmbledhje të shkurtër të vendimeve të PZAP-it. Gjithashtu emrat e palëve ankuese janë anonimizuar në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale Nr.06/L-082.



**ZGJEDHJET E PARAKOHSHME PËR  
KUVENDIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
TË MBAJTURA NË VITIN  
2019**

Në këtë pjesë janë të përzgjedhura vendimet të cilat i referohen procesit zgjedhor të para fushatës zgjedhore për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës



## Parashtruesi i çështjes, Subjekti politik X.X, apel kundër vendimit të KQZ, nr. 919/2019 dt.04.09.2019 për mos aprovimin e emërimit të anëtarëve të KKZ-ve

[Lidhur me këtë çështje PZAP-i, ka nxjerr Vendimin Anr.01/2019 të datës 10.09.2019](#)

**Faktet e Çështjes-** Subjekti politik X.X, në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ka parashtruar apel kundër vendimit të KQZ-së të datës 04.09.2019, për shkak të mos aprovimit të emërimit të anëtarëve të KKZ-ve, prej propozimeve të subjektit politik XX në komunat Istog dhe Klinë për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 6 tetor 2019.

Subjekti politik XX me seli në Prishtinë, ka paraqitur apel në PZAP, kundër vendimit të KQZ-së të datës 04.09.2019, për shkak të mos aprovimit të emërimit të anëtarëve të KKZ-ve, prej propozimeve të subjektit politik XX në komunat Istog dhe Klinë për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më 6 tetor 2019. Parashtruesi i apelit në vazhdim pretendon se duke u bazuar në Ligjin për Zgjedhjet Qendrore dhe Lokale, rregulloreve në fuqi, përbërjes së KQZ-së, dhe frymës të gjitha këtyre më lartë do të duhej të jenë anëtarë të KKZ-ve, të paktën njëra nga partitë, e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian.

Sipas parashtruesit të apelit komisionet komunale të zgjedhjeve në Istog dhe Klinë janë të pa përfaqësuar me partitë e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian dhe pretendon se iu është bërë një mohim i të drejtës tyre për të marrë pjesë në organizimin dhe monitorimin e procesit zgjedhor, në këto dy komuna. XX në apelin e tyre theksojnë se subjekti i tyre ka qenë anëtarë e KKZ-ve në Istog dhe Klinë në dy palë zgjedhjet e kaluara të mbajtura më vitin 2018.

Andaj ka propozuar për panelin, që kërkesa e tyre të shqyrtohet me përgjegjësi të lartë dhe në një afat sa më të shkurtë të merret një vendim për emërimin e anëtarëve në komisionet komunale zgjedhore në Istog dhe Klinë.

PZAP-i, duke u mbështetur në dispozitën e nenit 118. paragrafi 1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, si dhe nenit 11. paragrafi 6 të Rregullës Nr.02/15 të PZAP-it, **apelin e parashtruar e ka refuzuar si të pabazuar**, sepse parashtruesi i apelit nuk ka paraqitur asnjë provë me të cilën do të vërtetoheshin pretendimet e tij.

Paneli vlerëson se, pretendimet ankimore të parashtruesit të apelit se me rastin e marrjes së vendimit nga KQZ-ja për nominimin e anëtarëve për KKZ në 8 komuna të Kosovës i është bërë e padrejte, janë të paqëndrueshme ngase KQZ me rastin e nominimeve të anëtarëve të KKZ-ve, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të datës 06.10.2019, si kriter ka marrë për bazë përfaqësimin e drejtë në KKZ, për të gjitha subjektet politike, si dhe për gjitha komunitetet brenda një komune.

## Arsyetimi i Panelit – PZAP



PZAP-i, në kuptim të nenit 11 paragrafi 7 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, më datën 06.09.2019, e ka informuar KQZ-në dhe ka kërkuar nga ky komision që të përgjigjet lidhur me apelin e parashtruar.

Në përgjigjen e ofruar KQZ thekson se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), me vendimin e datës 04.09.2019, nr.919/2019 ka emëruar Komisionet Komunale të Zgjedhjeve me të cilën gjatë emërimit të KKZ-ve, është bazuar në nenin 67 të LQP-së, ku në rastin konkret tek nominimet e subjektit politik XX, KQZ-ja, është bazuar në nenin 67 paragrafi 3 dhe nenin 67 paragrafi 9 të këtij ligj, ku në momentin e emërimit ka marrë për bazë përfaqësimin e drejtë në KKZ për të gjitha komunitetet me numër të dallueshëm të popullatës brenda një komune.

Paneli pasi shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës, në kuptim të afatshmërisë së apelit, gjeti se pala nuk ka paraqitur asnjë provë me të cilën do të vërtetoheshin pretendimet e parashtruara në apel, andaj vendosi që: **Apelit të jetë i Pabazuar**

### Shënim

*Paneli vlerëson se, pretendimet ankimore të parashtruesit të apelit se me rastin e marrjes së vendimit Nr. 919/2019 të datës 04.09.2019 nga KQZ-ja për nominimin e anëtarëve për KKZ në 8 komuna të Kosovës i është bërë e padrejte, janë të paqëndrueshme ngase KQZ me rastin e nominimeve të anëtarëve të KKZ-ve për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 06.10.2019, si kriter ka marrë për bazë përfaqësimin e drejtë në KKZ, për të gjitha subjektet politike, si dhe për gjitha komunitetet brenda një komune.*

*Mbi këtë bazë Paneli vlerëson se vendimi i apeluar i KQZ-së, për nominimin e kandidatëve të KKZ-së për komunat e lartcekura si në apel, është i bazuar në ligj dhe është në harmoni të plotë me nenin 67 par. 1 dhe 3 të LQP-së, në të cilin KQZ-ja është përprekur dhe ka garantuar përfaqësimin e drejtë dhe në mënyrë proporcionale të KKZ-ve, në komunat e theksuar më lart për të gjitha komunitetet me numër të dallueshëm të popullatës brenda një komune.*

## **Parashtruesi i çështjes, Subjekti politik X.X, apel kundër Udhëzimit Nr.965/2019, të KQZ-së të datës 09.09.2019, për Komisionet Komunale të Zgjedhjeve dhe për Këshillat e Vendvotimeve, për identifikimin e votuesve në vendvotime për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës**

[Lidhur me këtë çështje PZAP-i, ka nxjerr Vendimin Anr.04/2019 të datës 13.09.2019](#)

**Faktet e Çështjes-** Subjekti politik X.X., në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ka parashtruar apel kundër Udhëzimit Nr.965/2019, të KQZ-së, të datës 09.09.2019, për Komisionet Komunale të Zgjedhjeve dhe për Këshillat e Vendvotimeve, për identifikimin e votuesve në vendvotime për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës.

PZAP - i, ka pranuar një apel nga subjekti politik X.X paraqitur kundër Udhëzimit Nr. 965/2019, të KQZ-së, të datës 09.09.2019, për Komisionet Komunale të Zgjedhjeve dhe për Këshillat e Vendvotimeve, për identifikimin e votuesve në vendvotime për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës.

Paraqitësi i apelit, thekson se KQZ-ja, ka nxjerr udhëzim, me të cilën ka udhëzuar KKZ-të dhe KVV-të, të cilët merren me organizimin dhe zbatimin e zgjedhjeve, që në ditën e votimit me datë 06 tetor 2019, të pranojnë dokumente për identifikimin e votuesve në vendvotime siç është përcaktuar me nenin 90, të Ligjit nr.03/L-073, për Zgjedhjet e Përgjithshme: Letërnjoftimi i vlefshëm, Pasaporta e vlefshme, dokumentet e vlefshme të udhëtimit, leje e vozitjes e vlefshme e Republikës së Kosovës. Paraqitësi i apelit thekson se dispozitat e cituara nga udhëzimi i apeluar janë në kundërshtim me nenin 45 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, me nenin 90 të Ligjit nr.2008/03-L073, për Zgjedhjet e Përgjithshme, dhe me nenin 16 të Rregullës Zgjedhore Nr. 09/2013, për votim dhe numërim në vendvotime dhe menaxhim të qendrës së votimit.

Paraqitësi i apelit te dy këto akte juridike, Ligji nr.03/L-073, për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Rregulla Zgjedhore Nr. 09/2013, për votim dhe numërim në vendvotime dhe menaxhim të qendrës së votimit, kanë fuqi më të madhe juridike se sa udhëzimi të cilat i merr KQZ-ja.

Sipas paraqitësi të apelit me paragrafin -I-, të këtij udhëzimi është e mohuar e drejta aktive për të votuar, për persona nga dy kategori: ata të paprekshmit persona - e zhvendosur dhe refugjatët, të cilët në bazë të nenit 90 të Ligjit nr. 03/L-073, për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe nenit 16 të Rregullës Zgjedhore Nr. 09/2013, kanë të drejtë të votojnë edhe me legjitimitimin e vlefshëm IRL, ose legjitimi te vlefshëm i refugjatëve. Ndërsa në paragrafin -II-, të këtij Udhëzimi KQZ-ja, është lëshuar në shpjegimin e dokumenteve të vlefshme dhe ka konstatuar që dokumentet e vlefshme janë vetëm ato të cilat i ka lëshuar Republika e Kosovës, gjë që nuk është thelbi i nenit 90 të Ligjit nr.03/L-073, për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe nenit 16 të Rregullës Zgjedhore Nr. 09/2013, çfarë mund të vërtetohet lehtë nga paragrafët në vijim: Pasaporta e vlefshme dhe Një dokument i vlefshëm i udhëtimit. Më tutje theksohet nga paraqitësi i apelit se kemi të bëjmë me personat, të cilët janë shtetasit e Kosovës, të cilët gjenden në Listën Qendrore të Votuesve dhe ata me dokumentet e tyre nuk fitojnë

asnjë të drejtë, por vetëm e realizojnë të drejtën ekzistuese aktive për të votuar, e cila është e përcaktuar me nenin 45, të Kushtetutës dhe nenin 2 të Ligjit nr. 2008/03-L073, për Zgjedhjet e Përgjithshme, me këtë udhëzim KQZ-ja, po mundohet të anulon të drejtën aktive të votës për të gjithë shtetasit kosovar, të cilët nuk i kanë dokumentet Kosovare dhe në këtë mënyrë t'ia pamundësojnë popullatës serbe, të dalin dhe të votojnë për përfaqësuesit e tyre në këtë proces zgjedhor.

Sipas paraqitësit të apelit ky udhëzim është në kundërshtim me praktikën e deritanishme dhe ekzistuese, të cilat janë të njëjta, për të gjitha proceset zgjedhore, të cilat janë mbajtur, para 4 muajve, për 4 komunitet në Veri të Kosovës, dhe për të gjitha zgjedhjet që janë mbajtur nga dita e nxjerrjes dhe miratimit të Ligjit Nr. 2008/03-L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme të Kosovës, e deri me ditën e sotme. Paraqitësi i apelit pretendon, që nëse ky vendim mbetet në fuqi, kjo do të thoshte se të gjitha mbledhjet e Kuvendit të Kosovës nga dita e marrjes së Ligjit Nr. 2008/03-L-073, për Zgjedhjet e Përgjithshme, kanë qenë të konstituara në kundërshtim me ligjin dhe kështu të gjitha vendimet, ligjet dhe aktet tjera juridike, janë marrë nga organet jo legjitime të pushtetit dhe prandaj të gjitha duhen të anulohen. Sepse është shumë e thjeshtë që të konkludohet që atëherë vendimet e më hershme të KQZ-së, të cilët thonë që mund të votohet me çfarëdo dokumenti të vlefshëm nga shteti i huaj, nëse mund të vërtetohet identiteti i votuesit, kanë qenë të paligjshme.

Paraqitësi i apelit thekson se ky vendim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, e ka shkelur të drejtën e garantuar me nenin 45 dhe nenin 156 të Kushtetutës dhe nenin 90 të Ligjit nr. 2008/03-L073, për Zgjedhjet e Përgjithshme, si dhe nenin 16 të Rregullës Zgjedhore Nr. 09/2013, dhe për këtë arsye i propozon PZAP-së, të aprovohet apeli i parashtruar, të vërtetohet se udhëzimi i KQZ-së, është në kundërshtim me LQP-në, dhe nenin 16 të Rregullës Zgjedhore Nr.09/2013, ta shfuqizoj dhe (ta shpall si të pavlefshëm udhëzimin e kontestuar të KQZ-së, me Nr. 965-2019 i datës 09.09.2019) dhe ta urdhëroi KQZ-në, me e marr një udhëzim të ri me të cilin udhëzim do të pranohet si të vlefshme të gjitha dokumentet identifikimit sipas LQP-së, dhe sipas praktikave të krijuar deri me tani.

PZAP-i, apelin e parashtruar e ka refuzuar si të pabazuar, duke u mbështetur në dispozitën e neneve 117. paragrafi 2 dhe 3 dhe 118 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, sepse nuk qëndron pretendimi i paraqitësit, të apelit se udhëzimi i apeluar është në kundërshtim me nenin 90, të LQP-së, nenin 16, i Rregullores Zgjedhore Nr.09/2013, nenet 45 dhe 156 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Paneli, nga interpretimi i dispozitave ligjore dhe kushtetuese vlerëson se, apeli është i pabazuar dhe se udhëzimi i apeluar nuk është në kundërshtim me dispozitat e lartcekura e as me dispozitat e pretenduar nga paraqitësi i panelit, meqenëse i njëjti është marrë në përputhje me nenin 63 dhe 64 të LQP-së, dhe Rregullës Zgjedhore Nr.09/2013. Udhëzimi i apeluar e ka natyrën e karakterit teknik, i cili saktëson veprimet e Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve dhe Këshillave të Vendvotimeve, në raport me identifikuesit e votuesit, në ditën e votimit.

## Arsyetimi i Panelit – PZAP



Në përgjigjen e saj KQZ-ja, thekson se ka nxjerr vendim për udhëzimin Nr. 965/2019 të datës 09.09.2019, për Komisionet Komunale të Zgjedhjeve dhe Këshillat e Vendvotimeve, për identifikimin e votueseve në vendvotim, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës, që do të mbahen më datë 6 tetor 2019, për me tepër në përgjigjen e saj, thekson se: qëllimi i vetëm i udhëzimit ka qenë, që të shmang të gjitha paqartësitë, lidhur me dokumentet e vlefshme për identifikim të votuesve në vendvotim, në ditën e votimit. Andaj ka nxjerrë udhëzimin për të qartësuar se me cilat dokumente mund të identifikohen votuesit në ditën e votimit. KQZ-ja, vetëm ka sqaruar se cilave dokumente duhet të përdoren gjatë votimit. Me propozim që apeli i paraqitur nga X.X, të refuzohet si i pabazë.

Paneli, pasi shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, e në kuptim të nenin 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, vendosi që: **Apeli është i pabazuar**

## Shënim

*Paneli vlerëson se vendimmarrja e KQZ-së, në raport me Udhëzimin Nr.965/2019 i datës 09.09.2019, është i drejtë dhe i ligjshëm dhe se i njëjti është marr me zbatim të drejtë, të dispozitave të LZP-së.*

*Nuk qëndron pretendimi i paraqitësit, të apelit se udhëzimi i apeluar është në kundërshtim me nenin 90, të LZP-së, nenin 16, i Rregullës Zgjedhore Nr.09/2013, nenet 45 dhe 156 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, për arsye se:*

*Me nenin 5 paragrafi 1 të LZP-së, përcaktohet: “Çdo person ka të drejtë për të votuar në zgjedhje në përputhje me këtë ligj nëse i ka mbushur tetëmbëdhjetë (18) vjet në ditën kur mbahen zgjedhjet dhe e plotëson njërin prej kriterëve vijuese:*

- a) është i regjistruar si qytetar i Kosovës në Regjistrin Qendror Civil;*
- b) banon jashtë Kosovës ose ka lëshuar Kosovën në apo pas 1 janarit 1998, me kusht që t'i plotësojë kriteret e parapara sipas ligjit në fuqi për të qenë qytetar i Kosovës; apo*
- c) ka fituar statusin e refugjatit, siç është përkufizuar në Konventën Lidhur me Statusin e Refugjatëve të 28 korrikut 1951 dhe Protokollin e saj të 16 dhjetorit 1966, në apo pas 1 janarit 1995, dhe ka të drejtë për t'u regjistruar në Regjistrin Qendror Civil si banor i Kosovës”*

*Me nenin 6 paragrafët 1 dhe 2 të LZP-së, përcaktohet se: “Votimi brenda dhe jashtë Kosovës” - 1 Çdo person me të drejtë vote ka të drejtë të votojë në Kosovë në ditën e zgjedhjeve dhe në zonën zgjedhore ku ai apo ajo është i regjistruar, me kusht që emri i tij apo saj paraqitet në Regjistrin Qendror Civil ose është regjistruar si qytetar i Kosovës në një datë të caktuar nga KQZ-ja.*



- 2. *Votuesi me të drejtë vote i cili përkohësisht banon jashtë, ose është zhvendosur nga, Kosova ka të drejtë të votojë në zgjedhje sipas procedurave dhe afateve kohore të përcaktuara në këtë ligj.*

*Me nenin 90 të LZP-së, përcaktohet se: “Për qëllim të këtyre zgjedhjeve në vijim janë dokumentet e pranueshme të identifikimit: a) letërnjoftimi i vlefshëm; b) pasaporta valide; c) dokumenti i vlefshëm i udhëtimit; d) leja e vozitjes e vlefshëm e Kosovës; e) kartela e vlefshme e PZHBV-ve; ose f) kartela e vlefshme e refugjatit”.*

*Me nenin 45 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, përcaktohet se: “Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes”*

*- 1. Çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjidhet, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor.*

*- 2. Vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë. 3. Institucionet shtetërore mbështesin mundësitë për pjesëmarrjen e çdonjërit në aktivitete publike dhe të drejtën e secilit për të ndikuar në mënyrë demokratike në vendimet e organeve publike.*

*Me nenin 156 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, përcaktohet se: “Refugjatët dhe Personat e Zhvendosur Brenda Vendit. Republika e Kosovës promovon dhe lehtëson kthimin e sigurt dhe me dinjitet të refugjatëve dhe personave të zhvendosur brenda vendit, dhe u ndihmon atyre për kthimin e pronave dhe posedimeve të tyre”.*

*Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore dhe kushtetuese, Paneli vlerëson se apeli është i pabazuar dhe se udhëzimi i apeluar nuk është në kundërshtim me dispozitat e lartcekura e as me dispozitat e pretenduar nga paraqitësi i panelit, meqenëse i njëjti është marr në përputhje me nenin 63 dhe 64 të LZP-së, dhe Rregullës Zgjedhore Nr. 09/2013. Udhëzimi i apeluar, e ka natyrën e karakterit teknik, i cili saktëson veprimet e Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve dhe Këshillave të Vendvotimeve, në raport me identifikimin e votuesit, në ditën e votimit.*

*Udhëzimi i apeluar, nuk ia mohon apo cenon të drejtën e votimit askujt, pasi që nuk ka të bëjë me të drejtën e votuesit apo Listën e Votuesve, mirëpo është në funksion të zbatimit në tërësi të dispozitës ligjore të nenin 90 të LZP-së, në identifikimin e votuesit, në ditën e votimit, në vendvotime dhe qartëson se çka nënkupton me dokumente të identifikimit në kuptim të kësaj dispozite*

*Nuk qëndron pretendimi i parashtruesit të apelit, se udhëzimi i apeluar, është diskriminues për komunitetin serb, pasi që siç është theksuar më lart, ky udhëzim i referohet identifikimit të votuesit, pa dallimi të komunitetit, etnisë, gjinisë etj, por udhëzim i apeluar, i referohet të gjithë votuesve, të Republikës së Kosovës dhe mund të ketë ndikim të secili votues në ditën e votimit të cilët nuk prezantojnë ndonjërin nga dokumentet e listuar në udhëzimin e apeluar.*

*Po ashtu duke marr parasysh se nga dita e nxjerrjes së udhëzimit të apeluar, e deri në ditën e votimit, secili qytetar që nuk posedon dokumente të identifikimit të Republikës së Kosovës, sipas këtij udhëzimit të apeluar, mund të pajiset me të njëjtat, pasi që afati për tu pajisur me një dokument identifikues, është 7 deri në 10 ditë, që nënkupton që secili qytetar që ka interes dhe vullnet për ta shfrytëzuar të drejtën e tij kushtetuese, për të votuar mund të pajiset me të njëjtat.*

*Paneli, duke marr parasysh faktin se lista e votuesve, nuk është e pajisur me fotografi të votuesit, por identifikimi bëhet në bazë të emrit, mbiemrit dhe numrit personal në listat e votuesve, ku votuesit e posedojnë vetëm dokumentet e identifikimit të lëshuara nga Republika e Kosovës, që nënkupton se më udhëzimin e apeluar, qëllimi është eliminimi i parregullsive në ditën e votimit dhe garantimi i rregullt i integritetit të procesit zgjedhor dhe në kuptim të kësaj Paneli, vlerëson se çdo identifikim tjetër i votuesit me dokumente të ndonjë shteti tjetër, që numri personal i votuesit nuk është në përputhshmëri me Listën e Votimit, në ditën e votimit, nënkupton identifikim i pjesshëm i votuesit dhe rrjedhimisht cenon integritetin e procesit zgjedhor.*

*Ky Vendim i PZAP-it, me numër Anr.4-2019 i datës 13.09.2019 ishte apeluar në Gjykatën Supreme të Kosovës, e cili me Aktvendimin me nr.A.A.nr.3/2019 të datës 16.09.2019 kishte Refuzuar si të pabazuar apelin e subjektit XX, dhe ka vërtetuar vendimin e PZAP-it, Anr.4-2019.*

## Parashtruesi i çështjes, Kandidatja N.E, për deputete në Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës nga Subjekti politik X.X, apel për tërheqjen nga lista e kandidatëve për deputet për shkak arsye të saja familjare.

[Lidhur me këtë çështje PZAP-i, ka nxjerr Vendimin Anr.09/2019 të datës 16.09.2019](#)

**Faktet e Çështjes-** Kandidatja N.E, për deputete në Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës nga Subjekti politik X.X., në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ka parashtruar apel për tërheqjen nga lista e kandidatëve për deputet për shkak arsyeve të saja familjare.

Me datën 15.09.2019, PZAP-i ka pranuar apelin e dorëzuar nga N.E , kandidate për deputete në Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, nga subjekti politik X.X, me të cilin kërkon që për arsye familjare të tërhiqet nga kandidatura për deputete.

Apelin me të cilin është ankimuar vendimi i lartpërmendur, Paneli e ka aprovuar si të bazuar, në mbështetje të nenit 28. paragrafi 1 lidhur me nenin 122. paragrafi 1 pika c e LPZ-së, që përcakton se nëse kandidati/ja pas certifikimit nuk dëshiron të marrë pjesë në procesin zgjedhor mund të parashtroj apel në PZAP, dhe paneli ia mundëson tërheqjen pa e zëvendësuar të njëjtën me ndonjë kandidat tjetër nëse i plotëson kushtet ligjore, andaj në bazë të neneve: 122. paragrafi 1,pika c, neni 118 paragrafi 1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme(LZP), neneve: 53 paragrafi 4, 131 paragrafi 4 dhe 131 paragrafi 5 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

### Arsyetimi i Panelit – PZAP



KQZ, përmes përgjigjes me shkrim i referohet dhe të njëjtën kohë i citon dispozitat ligjore të LZP-së, sipas interpretimit të së cilave deklaroi se këto dispozita nuk parashohin mundësin e tërheqjes vullnetare të kandidatëve nga lista zgjedhore e subjektit politik me të cilin garon, përveç nëse ajo kërkohet me vendim të PZAP-it, kandidati është pjesë e listës se një subjekti tjetër politik ose ndërron jete, pra ligji nuk lejon KQZ-në, ta tërheq nga lista kandidatin e certifikuar, pasi që KQZ nuk mundet as ta kundërshtoj as t'i vërtetoj arsyet personale të kandidateve, pasi që KQZ mundet vetëm të garantoj për rregullsinë e procesit të aplikimit dhe certifikimit. Si dëshmi ka bashkangjitur: formularin për certifikim të kandidates N.E., formularin financiar të kandidates në fjalë, shkresat nga ZRPPC-ja për subjektin politik X.X dhe listën e kandidateve të këtij subjekti.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa – PZAP-i, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe pas administrimit të pretendimeve ankimore, vendimit kontestues të datës 09.09.2019 me numër protokollit 978/2019 të KQZ-së dhe përgjigjes në apel të KQZ gjeti se: **Apeli është i bazuar**

## Shënim

PZAP-i, vlerëson se qëndrimi juridik i KQZ-së, është i pabazuar pasi i njëjti është marrë me zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Në rastin konkret KQZ-ja, gabimisht ka zbatuar të drejtën materiale në raport me deklarin e kandidatit për tërheqje nga lista e kandidatëve për deputet nga radhët e partisë X.X, meqenëse dispozita të cilës i referohet KQZ-ja, neni 28.1 nuk e sanksionon si ndalesë kandidaten për tërheqje nga lista e kandidatëve, nëse kjo bëhet brenda afatit kohor dy ditor para hedhjes së shortit. Meqenëse e vetmja ndalesë në rastin konkret është tërheqja pas periudhës apo afatit 2 ditor, shkaqet tjera të tërheqjes nuk janë me relevancë as për KQZ-ën, e as për PZAP-në, meqenëse është e drejtë e kandidatit se a dëshiron të garoj në zgjedhje apo jo.

Tërheqja e një kandidati nga listat e kandidatëve nga një subjekt politik ose nga vet kandidati është e rregulluar me LZP konkretisht me nenin 28.1 të LZP-së, ku përcaktohet se: “subjekti politik i certifikuar mund të tërhiqet nga procesi zgjedhor duke i dorëzuar kërkesën KQZ-së, për tërheqje jo më vonë se dy (2) ditë të punës para datës së caktuar për hedhje të shortit”, ku sipas kësaj dispozite apeli i parashtruar nga ana e kandidates N.E, është paraqitur brenda afatit kohor të përcaktuar me LZP-në.

Paneli konstaton se apeli është i bazuar pasi që neni 122.1 pika c i LPZ-së, përcakton se: “nëse kandidati pas certifikimit nuk dëshiron të marrë pjese në procesin zgjedhor mund të parashtroj apel në PZAP”. Andaj mbi këtë bazë paneli konstaton se apeli është i bazuar duke marrë parasysh faktin se kandidatja për deputet N.E, për arsye familjare nuk dëshiron që të jetë pjesë në listat zgjedhore për zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen me datën 06 tetor 2019. Asnjë dispozitë ligjore e LZP-së, nuk e sanksionon të drejtën e tërheqjes së kandidatit nga lista zgjedhore krejt kjo në kuptim të parimit se e drejta për të zgjedh dhe për t'u zgjedh është e drejtë individuale e secilit dhe se në asnjë mënyrë nuk paraqet detyrim, përndryshe kjo do të përbënte cenim të drejtave të njeriut.

E drejta për të zgjedhur dhe për tu zgjedhur është e drejtë dhe jo detyrim i paraparë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës neni 45: “Çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjidhet, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor”. Andaj çfarëdo kufizimi apo interpretimi tjetër jashtë këtij domeni dhe jo mbi bazën e rregullimit ligjor nënkupton shkelje të të drejtave të njeriut.

- Me nenin 53 par. 1 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përcaktohet: “Një akt administrativ mund të anulohet apo shfuqizohet, sipas detyrës zyrtare, nga organi publik që ka kompetenca të nxjerrë aktin, nga organi i tij mbikëqyrës apo nga një organ tjetër i përcaktuar shprehimisht me ligj.

- Me nenin 131 par. 4 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përcaktohet: Kur organi publik kompetent vlerëson se ankesa është e pranueshme dhe e bazuar plotësisht, me një akt të ri administrativ do të anulohet apo ndryshojë aktin e ankimuar, gjegjësisht do të lëshojë aktin e refuzuar, siç është kërkuar nga pala, dhe PZAP-i, meqenëse e aprovoi të bazuar apelin e kandidates për deputet nga partia X.X, vendimin e KQZ-së, e ndryshoi dhe vendosi që të njëjtës t'ia lejoj tërheqjen nga lista e kandidatëve për deputete nga radhët e partisë X.X.

## Parashtruesi i çështjes, Subjekti politik X.X, apel kundër vendimit të Këshillit për Operacione Zgjedhore për shkak që me këtë vendim të datës 23.09.2019, ky subjekt X.X është larguar nga listat e KVV.

Lidhur me këtë çështje PZAP-i, ka nxjerr Vendimin Anr.84/2019 të datës 24.09.2019

**Faktet e Çështjes-** Subjekti politik X.X., në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), ka parashtruar apel me datën 24.09.2019 kundër vendimit të Këshillit për Operacione Zgjedhore për shkak që me këtë vendim të datës 23.09.2019, ky subjekt X.X është larguar nga listat e KVV. Në këtë apel subjekti politik X.X ka propozuar të anulohet vendimi në fjalë.

Me datën 24.09.2019, subjekti politik X.X, ka paraqitur apel në PZAP, në të cilin pretendohet se Këshilli për Operacione Zgjedhore me vendimin e tij në mënyrë të kundërligjshme i ka mohuar anëtarëve të subjektit në fjalë të drejtën për të nominuar anëtarët e tij në KVV, përkundër faktit se apeluasi i ka parashtruar dokumentacionin e nevojshëm konform dispozitave ligjore dhe kriterëve të përcaktuara. Me vendimin e Këshillit për Operacione Zgjedhore të datës 23.09.2019, subjektit politik X.X është larguar nga listat e KVV-ve, në mënyrë të kundërligjshme pa sqaruar arsyet e largimit të këtij subjekti për të nominuar anëtarët e tij në KVV. Në fund ka propozuar që PZAP-i, të anulohet këtë vendim. Parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve në apel si dëshmi ka bashkangjitur transkriptin e vendimit të SKQZ-së.

PZAP-i, apelin e parashtruar e ka hedhur si të pa lejuar për arsye se, parashtruesi i apelit ka atakuar vendimin e Këshillit për Operacione Zgjedhore, ndërsa me nenin 122 par.1 pikat a), b), c), d), e) dhe f) të LQP-së, parashihet se PZAP-i, vendos vetëm për vendime të KQZ-së. Andaj në këtë rast meqenëse nuk ka vendim të KQZ-së, nuk është në juridiksionin e këtij institucioni për të vendosur për kërkesat e Këshillit për Operacione Zgjedhore dhe PZAP-i, në mbështetje të dispozitës së nenit 118 par.1 të LQP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### Arsyetimi i Panelit – PZAP



PZAP-i, pas shqyrtimit të lejueshmërisë së apelit gjeti se: **Apeli është i palejuar.**

### Shënim

PZAP-i, konstatoi se apeli është i palejuar, pasi që parashtruesi i apelit ka atakuar vendimin e Këshillit për Operacione Zgjedhore, ndërsa me nenin 122 par.1 pikat a), b), c), d), e) dhe f) të LQP-së, parashihet se PZAP-i, vendos vetëm për vendime të KQZ-së. Andaj në këtë rast meqenëse nuk ka vendim të KQZ-së, nuk është në juridiksionin e këtij institucioni për të vendosur për kërkesat e Këshillit për Operacione Zgjedhore.

Ky Vendim i PZAP-it, me numër Anr.84-2019 i datës 24.09.2019 ishte apeluar në Gjykatën Supreme të Kosovës, e cili me Aktgjykimin me nr.A.A.-U.ZH.nr.4/2019 të datës 26.09.2019 kishte Refuzuar si të pabazuar apelin e subjektit XX, dhe ka vërtetuar vendimin e PZAP-it, Anr.84-2019.

## Parashtruesi i çështjes, Votuesi M.S, apel kundër vendimit të KQZ-së të datës 19.09.2019, kur është miratuar lista përfundimtare për votuesit jashtë Kosovës me të cilën pas publikimit të listës i njëjti nuk e ka gjetur emrin e tij në listë

[Lidhur me këtë çështje PZAP-i, ka nxjerr Vendimin Anr.39/2019 të datës 22.09.2019](#)

**Faktet e Çështjes-** Votuesi M.S, në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ka parashtruar apel kundër vendimit të KQZ-së të datës 19.09.2019, kur është miratuar lista përfundimtare për votuesit jashtë Kosovës me të cilën pas publikimit të listës i njëjti nuk e ka gjetur emrin e tij në listë.

Me datë 20 shtator 2019 parashtruesi i apelit, M.S, ka parashtruar apel kundër vendimit të KQZ-së të datës: 19.09.2019 kur është miratuar lista përfundimtare e votuesve, me pretendimin se i njëjti edhe pse kishte aplikuar me datë: 05.09.2019 për të hyrë në listë të votuesve jashtë Kosovës, me rastin e publikimit të listës nuk e ka gjetur emrin e tij në listë. I njëjti thekson se në të gjitha zgjedhjet e mëparshme të përgjithshme ka pasur drejtë për të votuar, ndërsa në këtë rast është refuzuar paligjshëm.

PZAP-i, apelin e parashtruar e ka refuzuar si të pabazuar, pasi që nga shkresat e lëndës paneli gjeti se parashtruesi i apelit në momentin e aplikimit për regjistrim për votim jashtë Kosovës nuk ka ofruar dosjen e kompletuar dhe nuk i ka plotësuar kriteret e përcaktuara siç parashihet me dispozitat e Rregullës Zgjedhore 03/2013 të KQZ-së, dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 117. paragrafi 2, 3 dhe 118, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### Arsyetimi i Panelit – PZAP



Në përgjigjen e KQZ-se të datës 21.09.2019 theksohet se parashtruesi i apelit M.S, në momentin e aplikimit ka dërguar vetëm kopje të dokumentit të identifikimit së bashku me formularin, por nuk e ka dërguar një kopje të dokumentit identifikues me të cilin dëshmohet se plotëson njërin nga kriteret juridike për tu përfshirë në listën e votuesve jashtë Kosovës.

Paneli, në kuptim të nenit 117 par.2 të LZP-së, gjeti se: **Apeli është i pabazuar**

### Shënim

Paneli, pasi shqyrtoi lëndën konstatoi se apeli është i pabazuar pasi që parashtruesi i apelit gjatë aplikimit të tij për regjistrim për votim jashtë Kosovës në momentin e aplikimit në KQZ nuk e dërguar një kopje të dokumentit identifikues me të cilin dëshmohet se plotëson njërin nga kriteret juridike për tu përfshirë në listën e votuesve jashtë Kosovës.

Nga shkresat e lëndës Paneli gjeti se parashtruesi i apelit në momentin e aplikimit për regjistrim për votim jashtë Kosovës nuk ka ofruar dosjen e kompletuar dhe nuk i ka plotësuar kriteret e përcaktuara siç parashihet me dispozitat e Rregullës Zgjedhore 03/2013 të KQZ-së.

**Parashtruesi i çështjes, Votuesi K.J, apel kundër vendimit të KQZ-së të datës 19.09.2019, me të cilën i njëjti edhe pse ka aplikuar më datë 05.09.2019 për të hyrë në listë të votuesve jashtë Kosovës, me rastin e publikimit të listës përfundimtare, i njëjti nuk e ka gjetur emrin e tij në listë, edhe pse në zgjedhjet e mëparshme të përgjithshme ka pasur drejtë për të votuar**

Lidhur me këtë çështje PZAP-i, ka nxjerr Vendimin Anr.36/2019 të datës 22.09.2019

**Faktet e Çështjes-** Votuesi K.J, në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), ka parashtruar apel kundër vendimit të KQZ-së, të datës 19.09.2019, me të cilën i njëjti edhe pse ka aplikuar më datë 05.09.2019 për të hyrë në listë të votuesve jashtë Kosovës, me rastin e publikimit të listës përfundimtare, i njëjti nuk e ka gjetur emrin e tij në listë, edhe pse në zgjedhjet e mëparshme të përgjithshme ka pasur drejtë për të votuar.

Me datë 20 shtator 2019 parashtruesi i apelit K.J, ka parashtruar ankesë kundër vendimit të KQZ-së të datës: 19.09.2019 kur është miratuar lista përfundimtare e votuesve, me pretendimin se i njëjti edhe pse kishte aplikuar me datë: 05.09.2019 për të hyrë në listë të votuesve jashtë Kosovës, me rastin e publikimit të listës nuk e ka gjetur emrin e tij në listë. I njëjti thekson se në të gjitha zgjedhjet e mëparshme të përgjithshme ka pasur drejtë për të votuar, ndërsa në këtë rast është refuzuar paligjshëm.

PZAP-i, pasi shqyrtoi apelin e parashtruar e ka hudhur sepse parashtruesit të apelit i mungon interesi juridik. Paneli me rastin e shqyrtimit të apelit, pas pranimit të përgjigjes nga KQZ-ja, është informuar se i njëjti gjendet në listën e votuesve meqenëse i plotëson kushtet për tu përfshirë në listë dhe se vlerëson se në rastin konkret të njëjtit i mungon interesi juridik për parashtrimin e apelit sepse votuesi K.J gjendet në listën e votuesve. Andaj PZAP-i, nga arsyet e sipërsënuar dhe në kuptim të dispozitës së nenit 115.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

## Arsyetimi i Panelit – PZAP



Paneli, pasi që shqyrtoj paraprakisht apelin, gjeti se: **Parashtruesit të Apelit i mungon interesi juridik**

## Shënim

---


Nga shkresat e lëndës rezulton se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me datë: 19.09.2019 ka miratuar listën përfundimtare të votuesve. Me datë: 20.09.2019 parashtruesi i apelit K.J, ka parashtruar ankesë në PZAP, ndaj vendimit për miratim të listës përfundimtare të votuesve. PZAP, ankesën e ankuesit e trajton si apel meqenëse ndaj vendimeve të KQZ palët e interesuar mund të parashtrojnë Apel.

Me rastin e shqyrtimit të Apelit PZAP iu ka drejtuar KQZ për të dhënë përgjigje në raport me apelin e parashtruesit dhe pretendimeve që dalin nga i njëjti.

KQZ me anë të përgjigjes në apel dërguar në PZAP ka konfirmuar se parashtruesi i apelit gjendet në listën e votuesve meqenëse i njëjti i plotëson kushtet për tu përfshirë në listë.

PZAP duke vlerësuar apelin e personit në fjalë vlerëson se në rastin konkret të njëjtit i mungon interesi juridik për parashtrimin e apelit meqenëse i njëjti është i përfshirë në listën e votuesve. Andaj PZAP-i, konstaton se apeli i parashtruar është pa interes juridik pasi K.J, gjendet në listën votuese.





Në këtë pjesë janë përzgjedhur vendimet të cilat i referohen procesit të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e parakohshme të vitit 2019 të mbajtura për Kuvendin e Republikës së Kosovës

## Parashtruesit e çështjes, N.N dhe A.A kanë paraqitur ankesë kundër subjektit politik X.X, për shkak të përdorimit të gjuhës së urrejtjes

### Lidhur me këtë çështje PZAP-i, ka nxjerr Vendimin Anr.90/2019 të datës 27.09.2019

**Faktet e Çështjes-** N.N dhe A.A, në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), kanë paraqitur ankesë kundër subjektit politik X.X, për shkak të përdorimit të gjuhës së urrejtjes, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura me datë 06.10.2019.

PZAP-i, më datën 26.09.2019, ka pranuar ankesën Anr.90/2019 nga N.N dhe ankesën Anr.94/2019, nga A.A, me të cilat pretendojnë se subjekti politik X.X, ka publikuar një spot zgjedhor, me të cilin bënë cenimin e rendit kushtetues dhe thërret në juridiksionin e një shteti tjetër, përkatësisht shtetin e Serbisë dhe si i tillë ky spot, përbën nxitje të urrejtjes për komunitetin shumicë në Kosovë.

Në këtë spot gjithashtu thuhet se: " Kur është vështirë, vetëm së bashku fitojmë, në mbrojtje të asaj që është e jona, kur thërret Serbia unë jap votën time ". Pra parashtruesi i ankesës thekson se spoti i X.X ka mesazhe që nxisin provokim dhe urrejtje ndaj ekzistencës të shtetit të Kosovës dhe janë në kundërshtim me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme. Parashtruesi i ankesës si provë materiale ka bashkangjitur CD.

PZAP-i, duke u mbështetur në dispozitën e nenit 32 paragraf 2, nenit 118 paragraf 1 dhe nenit 120 paragraf 1 pika c) të LZP-së, ankesat e parashtruara i miratoi si të bazuara, pasi që subjekti politik i lartpërmendur ka bërë shkelje të Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e Tyre dhe Kandidatët, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika (l) të LZP-së, ku me qëllim të promovimit të subjektit politik dhe kandidateve të tij në spotin zgjedhor, ka nxitur urrejtjen ndëretnike në Kosovë dhe ka përdorur objektet publike, për të promovuar programin e subjektit të tyre politik, gjatë fushatës zgjedhore.

### Arsyetimi i Panelit – PZAP



Paneli, në bazë të nenit 13 paragraf 2, të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka vendosur të bashkojë ankesat e lartcekura dhe ti trajtojë si një ankesë, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve, dhe për të gjitha të vendos me një vendim për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

PZAP-i, në kuptim të nenit 7 paragrafi 1, të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e ka njoftuar subjektin politik X.X, për ankesën që është bërë ndaj saj dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesave në fjalë deri më datë 27.09.2019 deri në ora 09:00.

Subjekti politik X.X, në përgjigjen në ankesë të datës 27.09.2019, theksoi se pretendimet e parashtruara në ankesë i konsiderojnë absolutisht të pabazuara sepse

video spoti është përgatitur më qëllim që një numër sa më të madh të qytetareve të nacionalitetit serb që kanë të drejtë vote në Kosovë, të dalin dhe të votojnë në pajtim me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë, dhe se në tërë spotin, nuk ka asnjë provokim apo thirrje në akte të dhunës. Subjekti politik X.X është subjekt i cili garon për 10 vende, me pakicë serbe që i takojnë komunitetit serb, në pajtim me nenin 64 të Kushtetutës. Kësisoj që ky video - spot assesi nuk mund të jetë i drejtuar kundër komuniteteve të tjera por është duke bërë thirrje “ në mbrojtje të asaj që është e jona ” ku nënkuptohen 10 vendet e garantuara të cilat janë të paraparë për pjesëtarët e komunitetit serb dhe të cilat janë të garantuara me nenin 64 të Kushtetutës dhe me LZP-në. Kjo ka të bëjë vetëm me komunitetin serb, duke e pasur parasysh se këto janë vendet e garantuara për komunitetin serb dhe nuk mund të provokojnë personat të tjerë në akte të dhunës. Pjesa tjetër e fjalisë së kontestuar “ kur thërret Serbia unë e jap votën time ” është një pjesë e cila ka të bëjë me Marrëveshjen e Brukselit, ku Serbia bën pjesë si pala nënshkruese së bashku me Kosovën, e ku njëra prej përgjegjësive është integrimi i komuniteti serb dhe pjesëmarrja e komunitet serb në zgjedhje. Kjo fjali ka për qëllim shmangien apo parandalimin e bojkotimit të zgjedhjeve dhe mundësinë që dikush ta akuzojë Serbinë dhe komunitetin serb që janë duke e bojkotuar qëllimisht, me vetëdije apo pa vetëdije, marrëveshjet nga Brukseli. Dhe se në pajtim me nenin 64 të Kushtetutës së Kosovës, të mbrohen vendet e “tona” të garantuara me Kushtetutë, për pjesëtarët e komunitetit serb. E kjo do të keqpërdorej nëse do të bojkotohej apo nëse do të dilnin me një numër të vogël në zgjedhje, e cila do të ishte në kundërshtim me Kushtetutë dhe LZP-në. Konsiderojmë se ky video – spot, duhet të shikohet si tërësi e jo që nga kjo tërësi të shkëputen fjalët dhe që të tentohet që të interpretohen gabimisht. Nga ajo që është thënë më lartë, propozojmë që ankesa të refuzohet si e pabazuar, sepse me të njëjtën tentohet që disa fjalë të caktuara të shkëputen nga konteksti e kjo nuk është thelbi i video - spotit si tërësi.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 paragraf 2 të LZP-së, gjeti se: **Ankesa është e bazuar**

## Shënim

*Paneli, pas shikimit të bërë në CD-në, e ofruar si provë materiale e cila është publikuar edhe në web-faqe zyrtare të X.X, ka vlerësuar se subjekti politik X.X, me qëllim të promovimit të subjektit politik dhe kandidatëve të tij në spotin zgjedhor, ka nxitur urrejtjen ndëretnike në Kosovë dhe ka përdorur objektet publike, për të promovuar programin e subjektit të tyre politik, gjatë fushatës zgjedhore.*

*Spoti i subjektit X.X, po ashtu ka mesazhe që nxit dhe provokon urrejtjen ndaj ekzistimit të Shtetit të Kosovës kur thuhet se: “ Kur është vështirë, vetëm së bashku fitojmë, në mbrojtje të asaj që është e jona ”, “Kur thërret Serbia unë jap votën time” dhe sipas vlerësimit të Panelit, me përdorimin e kësaj gjuhe, në spot nxitet urrejtja kundër të tjerëve.*

Ndërsa sa i përket pretendimeve në përgjigjen në ankesë lidhur me vendet e garantuara në Kuvendin e Republikës së Kosovës, Paneli i konsideron si të paqëndrueshme pretendimet ngase në Dispozitat Tranzicionale për Kuvendin e Kosovës me nenin 148 paragraf 1 të Kushtetutës së Republikës Kosovës, përcaktohet se: "Për (2) mandatet e para zgjedhore Kuvendi i Republikës së Kosovës do të ketë (20) vende të rezervuara për përfaqësim të komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë në mënyrën si vijon: Dhjetë (10) vende do tu ndahen partive, koalicioneve, nismave qytetare dhe kandidatëve të pavarur, që janë deklaruar që përfaqësojnë komunitetin serb të Kosovës, dhe dhjetë(10) vende do tu ndahen komuniteteve të tjera si vijon: komuniteti Rom një (1) vend; komunitetit Ashkali një (1) vend; komunitetit Egjiptian një (1) vend; dhe një vend shtesë do ti jepet komunitetit Rom, Ashkali ose Egjiptian i cili ka numrin më të madh të votave të përgjithshme; komunitetit Boshnjak tri (3) vende, komunitetit Turk dy(2) vende dhe komunitetit Goran një (1) vend. Çdo vend i fituar përmes zgjedhjeve, do të jetë vend shtesë, përveç dhjetë vendeve të rezervuara që u ndahen përkatësisht komunitetit serb të Kosovës dhe komuniteteve tjera", ndërsa me paragrafin 2 të këtij neni përcaktohet se: "Pavarësisht nga pika 1 e këtij neni, mandati ekzistues në kohën e hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute do të konsiderohet si mandati i parë zgjedhor i Kuvendi, në rast se ky mandat zgjatë për së paku dy vite nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute.

Në këtë rast Paneli, vlerëson se subjekti politik i lartpërmendur ka bërë shkelje të Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika (l) të LZP-së, me të cilin përcaktohet: "Gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: Përdorimi i gjuhës në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokoj një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve, ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo lloj materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë".

Paneli me rastin e shqiptimit të gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, mori parasysht shkeljet e lartpërmendura dhe shqiptoj gjobën, duke u bazuar në nenin 120 paragraf 1 pika c) e LZP-së, nenin 3 pika 11, e Rregullores Nr.01/2012, për Kategorizimin e Sanksioneve dhe Gjobave të PZAP-it, për arsye se:

Me nenin 120 paragraf 1 pika c) të LZP-së, i Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme të Republikës së Kosovës, me nr. 03/ L-073 i datës 29 Tetor 2010, neni 14 përcaktohet se: "neni 120 në fuqi paragrafi 1 pika b) dhe c), riformulohen si në vijim: pika c), të vendosë një gjobë një subjekti politik në vlerë deri 50.000 euro".

Me nenin 3 pika 11, e Rregullores Nr.01/2012, për Kategorizimin e Sanksioneve dhe Gjjobave të PZAP-it, përcaktohet se: “ Në qoftë se subjekti politik, mbështetësit apo kandidatët e tij përdorin gjuhën në formë të shkruar ose gojore, që nxitë ose provokon ose që mund të nxis ose provokon një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave të tjerë ose pasurisë, ose nxit apo mund të nxis urrejtjen kundrejt të tjerëve, ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole apo çfarëdo materiali tjetër që ka apo mund të ketë ndikim të tillë:...subjekti politik që është i përfaqësuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës dënohet me 10.000 deri 30.000 euro”.

Paneli, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës duke iu referuar dispozitave ligjore të cekura më lartë e në veçanti duke marr rrethanat e rastit siç janë:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj, në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Faktin se subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, çka nënkuptohet se i njëjti ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, përveç të cekurave i njëjti subjekt, në zgjedhjet e kaluara pikërisht për shkak të gjuhës së përdorur e cila është kualifikuar si jo e përshtatshme dhe përmes së cilës ka mundur të nxit akte të dhunshme është gjobitur dy herë, në proceset zgjedhore të vitit 2017;
- Subjekti politik me video-spotin e publikuar gjatë kësaj fushate zgjedhore ka bërë shkelje të ligjit zgjedhore në fuqi si dhe në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë çka nënkupton se e njëjta është recidiviste - përsëritëse e shkeljeve të ligjit dhe rregullave zgjedhore, që do të thotë se gjobat e shqiptuara në proceset e kaluara nuk kanë ndikuar në përmirësimin dhe disiplinimin e këtij subjekti politik, si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Përveç të cekurave më lartë Paneli, me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e subjektit politik X.X, në kuadër të pretendimeve të theksuara në përgjigje në ankesë, mirëpo të njëjtët ishin të pabazuara, të pa qëndrueshme dhe pa bazë ligjore si në dispozitat e Ligjit për Zgjedhje, dispozitat kushtetuese dhe Marrëveshjes së Brukselit dhe si të tilla nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka Paneli, vlerësoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi

## Parashtruesi i çështjes, Organizata N.N, ka paraqitur ankesë kundër subjektit politik X.X, për shkak të përdorimit të fëmijëve në fushatë zgjedhore

### Lidhur me këtë çështje PZAP-i, ka nxjerr Vendimin Anr.95/2019 të datës 27.09.2019

**Faktet e Çështjes-** Organizata N.N në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ka paraqitur ankesë kundër subjektit politik X.X, për shkak të përdorimit të fëmijëve në fushatë zgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura me datë 06.10.2019.

PZAP-i, më datën 26.09.2019 ka pranuar ankesë nga Organizata N.N me seli në Prishtinë, me të cilën pretendon se kandidati për deputet E.SH, nga radhët e subjektit politik X.X, në postimin e tij në rrjetin social Facebook, ka publikuar një fotografi nga një tubim i fushatës zgjedhore ku shihet së bashku me një fëmijë i mitur i cili mban të veshur një bluzë që bën thirrje për ta votuar kandidatin nga subjekti politik X.X, E.SH. Paraqitësi i ankesës pretendon se me këtë E.SH, kandidat për deputet nga radhët e subjektit politik X.X, ka shkelur rregulloren zgjedhore 13/2013 përkatësisht nenin 5 pikën 5.2.

PZAP-i, duke u mbështetur në dispozitën e nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së PZAP-i, ankesën e parashtruar e miratoi si të bazuar, pasi që kandidati E.SH, nga radhët e koalicionit X.X, ka përdorur fëmijën në një tubim për fushatë zgjedhore dhe ka postuar foto në rrjetin social Facebook nga vetë kandidati në fjalë, veprim ky që është në kundërshtim me zgjedhjet nenin 5.3 e Reformuar pika b), c), d), të Rregullës Zgjedhore nr.20/2019 mbi ndryshimin dhe plotësimin e rregullores zgjedhore nr. 13/2013 të KQZ-së.

### Arsyetime i Panelit – PZAP



Në përgjigje në ankesë të datës 27.09.2019, subjekti politik X.X, thekson se lidhur me këtë rast nuk ka asnjë shkelje nga ana e kandidatit për deputet nga radhët e këtij subjekti politik X.X, dhe se kanë qenë të kujdesshëm në fushatë zgjedhore të mbajtur në sallën 1 Tetori me datën 26.09.2019, për mos përfshirjen e personave, të cilët apostrofohen në nenin 5.2 të rregullave zgjedhore 13/2013, në vazhdim të përgjigjes lidhur me rastin konkret subjekti në fjalë thekson se bëhet fjalë për prezencën e familjarëve për deputet në listën zgjedhore të koalicionit z. E.SH, përkatësisht fëmijës se tij, E.SH, me të cilën do ta dëshmojnë duke ofruar argumentet për vërtetimin e rastit.

Më tutje theksohet se ka qenë një fotografi e rastit se absolutisht nuk kanë pasur për qëllim ekspozimin për çështje të fushatës zgjedhore.

Subjekti politik X.X, në përgjigjen e tij njofton se pas pranimit të ankesës në fjalë, menjëherë ka njoftuar kandidatin për deputet z. E.SH, dhe kanë larguar fotografinë nga faqja zyrtare në Facebook dhe janë siguruar se kjo fotografi nuk është ekspozuar X.X, kërkon nga PZAP-i që të merr në konsideratë përgjigjen e subjektit të tyre dhe të hedhe poshtë ankesën të bërë nga N.N.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se: Ankesa është e bazuar **Ankesa është e bazuar**

## Shënim

*Paneli nga fotot e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, e cila gjendet në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë, ka konstatuar se kandidati E.SH, nga radhët e koalicionit X.X, ka përdorur fëmijën në një tubim për fushatë zgjedhore dhe i janë postuar në rrjetin social Facebook nga vetë kandidati në fjalë, veprim ky që është në kundërshtim me zgjedhjet nenin 5.3 e Riformular pika b), c), d), të Rregullës Zgjedhore nr.20/2019 mbi ndryshimin dhe plotësimin e rregullores zgjedhore nr. 13/2013 të KQZ-së , që në rastin konkret, personat nën 18 vjet bartin material promovues gjatë fushatës zgjedhore, ku i njëjti ka veshur bluzën me emrin e kandidatit në fjalë nga radhët e koalicionit X.X.*

*Paneli me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim: Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor, shkallën dhe peshën e shkeljes, nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.*

*Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat për rastin konkret duke pasur parasysh faktin se koalicionit X.X, nuk merr pjesë për herë të parë në zgjedhje dhe se të njëjtit janë të njoftuar me rregullat zgjedhore, po ashtu si rrethanë tjetër PZAP-i, e mori edhe faktin që këtij subjekti, ia dha mundësinë për t'u përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre nuk e kanë pranuar shkeljen e supozuar me arsyetimin e tyre se në foton e bashkangjitur shihet djali i kandidatit nga radhët e koalicionit X.X, i cili ka qenë bashkë me prindin e tij, fëmija nuk kanë qenë i përdorur për fushatë, ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se brenda afatit të caktuar kanë ndërmarrë veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes, ashtu që fotografia e fëmijës është hequr nga faqja zyrtare në Facebook, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi, me këtë gjobë paneli vlerësoi se me gjobën e shqiptuar do të ndikon që mos të përsëriten veprimet e kësaj natyre në të ardhmen.*

## Parashtruesit e çështjes, subjekti politik N.N dhe Organizata A.A kanë paraqitur ankesë kundër koalicionit X.X- Y.Y, për shkak të përfshirjes së pjesëtarëve të uniformuar të Policisë së Kosovës, gjatë fushatës zgjedhore në spotin e tij zgjedhor

[Lidhur me këtë çështje PZAP-i, ka nxjerr Vendimin Anr.108/2019 të datës 30.09.2019](#)

**Faktet e Çështjes-** Subjekti politik N.N dhe Organizata A.A, në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), kanë paraqitur ankesë kundër koalicionit X.X- Y.Y, për shkak të përfshirjes së pjesëtarëve të uniformuar të Policisë së Kosovës, gjatë fushatës zgjedhore në spotin e tij zgjedhor, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura me datë 06.10.2019.

PZAP-i, më datë 27.09.2019, ka pranuar ankesën Anr.108/2019, nga subjekti politik N.N, dhe ankesën Anr.114/2019, nga A.A, të dyja me seli në Prishtinë, të paraqitura kundër koalicionit X.X- Y.Y, me seli në Prishtinë me të cilat pretendohet se kandidati për kryeministër të Kosovës nga radhët e koalicioni X.X- Y.Y, R.H, më datë 26.09.2019, përmes llogarisë së tij në facebook, ka bërë fushatë me Policinë e Kosovës, ashtu që ka shpërndarë një video ku shihen pjesëtarët e uniformuar të Policisë së Kosovës dhe një tekst i cili përçjellë videon e i cili thotë “2000 policë shtesë deri në fund të mandatit”, veprim ky i cili sipas tyre përbën shkelje të Rregullës Zgjedhore “Fushata e Zgjedhjeve dhe Njoftimi për Ngjarjet Politike”.

PZAP-i, duke u mbështetur në dispozitën e nenit 118 par.1 dhe nenit 120 par.1 pika c) të LZP-së, **ankesat e parashtruara i miratoi si të bazuara**, pasi që ka vlerësuar se nga ana e koalicionit X.X- Y.Y, është shkelur Rregulla Zgjedhore Nr.13/2013, për “Fushatën e Zgjedhjeve dhe Njoftimin për Ngjarjet Politike”, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregullën Zgjedhore Nr.20/2019 të datës 26.09.2019, pasi që koalicioni në fjalë, me qëllim të promovimit të programit të subjektit të tyre politik, gjatë fushatës zgjedhore, në spotin e tij zgjedhor ka përfshirë pjesëtarë të uniformuar të Policisë së Kosovës, veprim ky i cili bie në kundërshtim me dispozitën e nenit 5 par. 2, pika c).

### Arsyetimi i Panelit – PZAP



Paneli, në bazë të nenit 13 paragraf 2, të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka vendosur të bashkon ankesat e lartcekura dhe ti trajton si një ankesë, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve, dhe për të gjitha të vendos me një vendim për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

PZAP-i, në kuptim të nenit 7 paragrafi 1, të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e ka njoftuar koalicionin X.X- Y.Y, për ankesat që janë bërë ndaj tij dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesave në fjalë deri më datë 28.09.2019, në ora 16:00. Koalicioni X.X- Y.Y, në përgjigjen në ankesë të datës 28.09.2019, theksoi se është i vërtetë fakti se në spotin reklamues të këtij subjekti politik janë përfshirë zyrtarë policor, por sipas tyre kjo ka ndodhur si pasojë e një gabimi të paqëllimshëm nga ana e kompanisë së kontraktuar, e cila ka realizuar këtë reklamë, sepse janë munduar ta mbulojnë me



sekuenca filmike planin e koalicionit në fushën e sigurisë për mandatin e ardhshëm qeverisës. Më tej ka shtuar se me të marrë njoftimin për paraqitjen e ankesave kundër tyre, koalicioni X.X- Y.Y, ka kontaktuar kompaninë në fjalë dhe ka kërkuar nga ta që të shkëpus nga spoti sekuencën e cila bie ndesh me rregullën zgjedhore. Në fund ka kërkuar nga PZAP-i, që të shqiptojë një dënim të arsyeshëm dhe gjatë matjes së dënimit të marrë parasysh veprimet e koalicionit X.X- Y.Y, për evitimin e shkeljes dhe respektimin e rregullave zgjedhore.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 paragraf 2, të LZP-së, gjeti se: **Ankesat janë të bazuara**, për këto arsye:

## Shënim

*Paneli, pas shikimit të shkresave të lëndës si CD-në, e ofruar si provë materiale, e cila është publikuar në llogarinë e facebook-ut, të kandidatit për kryeministër të Kosovës, R.H, përgjigjes në ankesë të koalicionit X.X- Y.Y, dhe shkresave tjera të lëndës, ka vlerësuar se nga ana e koalicionit X.X- Y.Y, është shkelur Rregulla Zgjedhore Nr.13/2013, për “Fushatën e Zgjedhjeve dhe Njoftimin për Ngjarjet Politike”, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregullën Zgjedhore Nr.20/2019 të datës 26.09.2019, pasi që koalicioni në fjalë, me qëllim të promovimit të programit të subjektit të tyre politik, gjatë fushatës zgjedhore, në spotin e tij zgjedhor ka përfshirë pjesëtarë të uniformuar të Policisë së Kosovës, veprim ky i cili bie në kundërshtim me dispozitën e nenit 5 par. 2, pika c), të rregullës zgjedhore të lartpërmendur, ku ndër të tjera parashihet se: “Në fushatën e zgjedhjeve të asnjë subjekti politik të certifikuar nuk mund të përfshihen kategoritë: ...; c) pjesëtarët e uniformuar të Policisë së Kosovës dhe personeli i tyre, përveç kur janë të angazhuar sipas detyrës zyrtare”.*

*Paneli me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim: natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor, shkallën dhe peshën e shkeljes, nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë; si dhe shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.*

*Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret, se dy subjektet e koalicionit në fjalë, subjekti politik X.X, dhe Y.Y, kanë marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se janë njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe përkundër këtij fakti gjatë fushatës zgjedhore, në spotin e tyre zgjedhor kanë përfshirë pjesëtarë të uniformuar të Policisë së Kosovës, veprim ky i sanksionuar me dispozitat e lartcekura të rregullave zgjedhore.*

*Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që koalicionit në fjalë, i'u dha mundësia për tu përgjigjur në ankesë dhe ta përmirësojë shkeljen e bërë, mirëpo subjekti politik megjithëse e ka pranuar shkeljen e bërë, nuk ka ofruar asnjë dëshmi lidhur me atë se është bërë përmirësimi i shkeljes siç kërkohet me nenin 120 paragrafi 1 pika a) e LPZ-së, veprime këto të cilat kanë ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar, në kuptim të nenit 35 paragrafi 2, nenit 120 paragrafi 1 pika c) të LZP-së dhe nenit 5 paragrafi 2 i Rregullës Nr. 01/2012, Për Kategorizimin e Sanksioneve dhe Gjobave të PZAP-it.*

## Parashtruesi çështjes, subjekti politik N.N, ka paraqitur ankesë kundër koalicionit X.X- Y.Y, për shkak të vendosjes së materialit zgjedhor në hapësira publike

Lidhur me këtë çështje PZAP-i, ka nxjerr Vendimin Anr.124/2019 të datës 30.09.2019

**Faktet e Çështjes-** Subjekti politik N.N, në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ka paraqitur ankesë kundër koalicionit X.X- Y.Y, për shkak të vendosjes së materialit zgjedhor në hapësira publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura me datë 06.10.2019.

Me datë 28.09.2019, N.N, ka paraqitur ankesë në PZAP, në të cilën pretendon se me datë 28.09.2019, rreth orës 14:00, aktivistet e N.N, qendra në Gjilan, në sheshin “Rexhep Mala”, në Gjilan, kanë vërejtur se aktivistet e koalicionit X.X - Y.Y, kanë vendosur tendë dhe një lloj tavoline me material propagandues, veprime këto sipas paraqitësit të ankesës, të sanksionuara me dispozitën e nenit 33 pika b) të LZP-së, dhe Rregullën Zgjedhore Nr.13/2013 të KQZ-së.

PZAP-i, duke u mbështetur në dispozitën e nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, ankesën e parashtruar e miratoi si të bazuar, për arsye se nga dëshmitë e ofruara, paneli në mënyrë të sigurt ka vërtetuar se nga ana e koalicionit X.X - Y.Y, me seli në Prishtinë, janë bërë shkeljet e Kodit të Mirësjelljes për Subjekte Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, nga fakti se, tendat dhe tavolinat e vendosura në hapësirat publike, paraqesin veprime të sanksionuara me dispozitën e nenit 33 pika b) e LZP-së.

### Arsyetimi i Panelit – PZAP



Në përgjigjet në ankesë koalicioni X.X - Y.Y, lidhur me pretendimet e paraqitësit të ankesës thekson se vendosja e tendave nuk përbën shkelje të kodit zgjedhor dhe para së gjithash, tenda është vendosur aty me leje të Drejtorisë së Shërbimeve Publike të Komunës së Gjilanit. Më tej ka propozuar që PZAP-i, të marrë parasysh njoftimet e këtij subjekti politik për anëtarët dhe simpatizantët e tij për respektimin e rregullave zgjedhore, duke kërkuar në fund që ankesa në fjalë të refuzohet si e pabazuar. Në mbështetje të pretendimeve, paraqitësi i përgjigjes në ankesë, ka bashkangjitur disa njoftime që koalicioni X.X - Y.Y, i ka bërë në rrjete sociale për anëtarët dhe simpatizantët e tij për respektimin e rregullave zgjedhore.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën dhe vlerësimin të shkresave në lëndë vlerësoi se **ankesa është e bazuar**, për këto arsye:

### Shënim

*Paneli nga fotot e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, të cilat gjendet në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë, ka konstatuar se tendat me materiale zgjedhore të koalicionit X.X - Y.Y, janë të vendosura në hapësirat publike në sheshin “Rexhep Mala”, në Gjilan.*

Nga dëshmitë e sipërcituara paneli në mënyrë të sigurt ka vërtetuar se nga ana e koalicionit X.X - Y.Y, me seli në Prishtinë, janë bërë shkeljet e Kodit të Mirësjelljes për Subjekte Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, nga fakti se, tendat dhe tavolinat e vendosura në hapësirat publike, paraqesin veprime të sanksionuara me dispozitën e nenit 33 pika b) e LZP-së, e cila përcakton “Vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe postereve, ose përndryshe, vendosja e emrave të tyre ose e sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugë publike, në shenjat publike të trafikut, brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose, ndryshe, që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare, ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronarëve ose shfrytëzuesve”.

Paneli, vendimin e tij e ka mbështet në dëshmi të qarta dhe bindëse siç përcaktohet me nenin 117 par. 3 të LZP-së, prandaj pretendimet në përgjigje në ankesë nuk u cilësuan me ndikim në meritat e lëndës.

Parashtrimet në përgjigje në ankesë, se veprimet e koalicionit X.X - Y.Y, nuk mund të sanksionohen si shkelje të LZP-së, për arsye se vendosja e tendës në shesh dhe shfrytëzimin e hapësirës publike, është bërë me pëlqimin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike të Komunës së Gjilanit. Paneli pretendimet e tilla i vlerësoj si të pa bazuara dhe si të tilla i refuzoj pasi që, me këto prova nuk justifikon veprimet që janë të ndaluara dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore të Nenit 33 pika b) i LZP-së, si dhe neni 5 paragrafi 1 pika d) e Rregullës Zgjedhore Nr.13/2013, ku parashihet se subjektet e certifikuar politike aktivitetet e tyre zgjedhore duhet t'i bëjnë në pajtueshmëri me Rregullat zgjedhore të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ). Ky përfundim ka të bëjë me faktin se Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politik të jenë në një atmosferë të tolerancës demokracisë, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalët, shkallën dhe peshën e shkeljes, pjesëmarrjen e subjekti politik në zgjedhjet e mëparshme që konsiston në faktin se koalicioni X.X - Y.Y, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, shkeljet e Ligjeve zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje dhe në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë që do të thotë se i njëjti është i njoftuar me rregullat zgjedhore si dhe shumën e fondeve që ka marrë subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve lidhur me fushatën zgjedhore. Po ashtu si rrethanë PZAP-i, mori edhe faktin që këtij subjekti, i'a dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjet e tij ka mohuar shkeljet e supozuara. Mos ndërmarrja e masave përmirësuese ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli konform nenit 120.1 pika a) të LZP-së urdhëroi koalicionin X.X - Y.Y, që të marrë masa dhe të përmirësoj shkeljet në afatin prej 24 orëve dhe nëse i njëjti nuk vepron sipas urdhrit të panelit do të sanksionohet me dënim shtesë nga PZAP-i, në pajtim me nenin 120.2 të LZP-së.

## Parashtruesi çështjes, subjekti politik N.N, ka paraqitur ankesë kundër koalicionit A.A - X.X- Y.Y, për shkak të shpërndarjes së materialit ushqimor

[Lidhur me këtë çështje PZAP-i, ka nxjerr Vendimin Anr.127/2019 të datës 02.10.2019](#)

**Faktet e Çështjes-** Subjekti politik N.N, në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ka paraqitur ankesë kundër koalicionit A.A - X.X - Y.Y, për shkak të shpërndarjes së materialit ushqimor, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura me datë 06.10.2019.

Me datën 29.09.2019 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik, N.N, me të cilën pretendon se me datën 28.09.2019, rreth orës 15:30, kanë vërejtur blerje të votës nga aktivistët e koalicionit A.A -X.X - Y.Y, në kundërshtim me legjislacionin zgjedhor, duke konsumuar vepër penale sipas nenit 210 dhe 212 të Kodit Penal të Kosovës.

Paraqitësi i ankesës pretendon se koalicioni A.A -X.X - Y.Y, ka cenuar përcaktimin e lirë të votuesve i cili veprim është në kundërshtim në nenin 33 par.6 pika b), të LZP-së. Këto pretendime janë të materializuara me prova materiale, videot edhe në fotografitë të cilat janë bashkangjitur ankesës. Në ankesë pohon se nga provat e parashtruara shihet qartë se si aktivistët e koalicionit të lartë shënuar kanë dhënë gjëra ushqimore për qytetarë në lokacionin e caktuar, si dhe dy fletëvotime me qëllim që në ditën e votimit të votohet numri 122, numri i përcaktuar në fletëvotim për koalicionin A.A -X.X - Y.Y, si dhe deputetet me numër 10,16,32,36, dhe 74. Sipas paraqitësit të ankesës veprimi i tillë i subjektit politik X.X, është i sanksionuar me legjislacionin në fuqi dhe Kodit penal të Kosovës.

PZAP-i, duke u mbështetur në dispozitën e nenit 118 par.1 të LZP-së, ankesën e parashtruar e refuzoi si të pabazuar, për arsye se pas shqyrtimit dhe e hetimit të gjitha dëshmive relevante në kuptim të nenit 117 të LZP-së, konstatoi se ankesa e parashtruar nga subjekti politik N.N, nuk mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse për tu miratuar, kjo për faktin se nga raporti i policisë e as nga shkresat e lëndës nuk është arritur që të vërtetohet pretendimet e paraqitësit të ankesës.

### Arsyetimi i Panelit – PZAP



Koalicioni A.A -X.X - Y.Y, në përgjigjen në ankesë e kundërshtojnë në tërësi ankesën e paraqitur nga subjekti politik N.N, si të pa bazë, të pa argumentuar me fakte dhe tendencioze. Në vazhdim të përgjigjes theksojnë se nga provat materiale të parashtruara nga ankuesi nuk mundë të vërtetohet se aktivistët e koalicionit A.A -X.X - Y.Y, kanë shpërndarë gjëra ushqimore për qytetarë në lokacionin e caktuar, me qëllim që në ditën e votimit të votohet numri 122, numri i përcaktuar në fletëvotim për koalicionin A.A -X.X - Y.Y.

Po ashtu pohojnë se në portalin “sinjali” por edhe “koha” kandidati për deputet i N.N, V.A, me numër të kandidatit 59, ka qenë nga të parët i cili në rrjetin social Facebook e kishte bërë postimin e këtij incizimi akuzues me qëllim që ti kundërvihet subjektit të tyre politik. Për më tepër koalicioni A.A -X.X - Y.Y, shprehin indinjatën e tyre për këtë veprim denigrues që po ju bëhet subjektit të tyre në kohë të fushatës zgjedhore, përkundër faktit se subjekti i tyre politik po zhvillon fushatën në përputhje të plotë me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme(LZP), dhe Rregullën zgjedhore Nr.11-2013.

PZAP-i, lidhur me këtë rast i është drejtuar Policisë së Kosovës me qëllim që të hetohet rasti. Në Raportin policor të datës 01.10.2019 NJEHP-Prishtinë, theksohet se pas hetimeve të bëra lidhur me këtë rast është identifikuar se lokacioni gjendet në rrugën Imzot Nikprela, lagjja Ulpianë D-9 Hy-5 Prishtinë, ku gjendet lokali të cilin e shfrytëzon shoqata “Nëna dhe Fëmijët e Lumtur”. Po ashtu në raportin policor theksohet se me datën 01.10.2019, është intervistuar Rina Shala aktiviste-vullnetare në këtë shoqatë, e cila ka deklaruar se kjo është një shoqatë bamirëse që ju ndihmon familjeve në nevojë dhe donatorët janë të ndryshëm, si dhe e njëjta e ka konfirmuar se kjo Shoqatë ka bërë shpërndarje të ndihmave-pako ushqimore, familjeve në nevojë, dhe në video incizim shihet se pakot në video incizim është e shoqatës së tyre. Lidhur me këtë rast në bashkëpunim me Prokurorinë e shtetit janë duke ndërmarr veprime hetimore me qëllim të identifikimit të personave të implikuar në këtë rast.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se: **Ankesa është e pazuar**

## Shënim

*Paneli pas vlerësimit të ankesës dhe provave të bashkangjitura në ankesë vërtetoi se nga provat që gjinden në lëndë nuk mund të vërtetohet se koalicioni A.A -X.X - Y.Y, kanë bërë shkelje të nenit 33 pika b), të LZP-së, gjegjësisht se aktivistët e koalicionit në fjalë kanë shpërndarë gjëra ushqimore për qytetarë në lokacionin e caktuar, me qëllim që në datën e votimit të votohet numri 122.*

*Ndërsa nga Raporti policor të NJEHP-Prishtinë, (dërguar në PZAP me email me datë 01.01.2019), rezulton se pas hetimeve të bëra dhe lidhur me këtë rast kanë identifikuar se lokacioni ku është bërë video incizimi gjendet në rrugën Imzot Nikprela, lagjia Ulpiane D-9 Hy-5 Prishtinë, në të cilin lokacion gjendet lokali të cilin e shfrytëzon Shoqata “Nëna dhe Fëmijët e Lumtur”. Po ashtu në Raportin policor theksohet se me datën 01.10.2019, është intervistuar Rina Shala aktiviste-vullnetare në këtë Shoqatë, e cila ka deklaruar se kjo është një shoqatë bamirëse që ju ndihmon familjeve në nevojë dhe donatorët janë të ndryshëm. E njëjta e ka konfirmuar se kjo Shoqatë ka bërë shpërndarje të ndihmave-pako ushqimore familjeve në nevojë dhe nga video incizim shihet se këto janë pako të shpërndara nga shoqata e tyre.*

*Paneli pas i shqyrtoj dhe e hetoj të gjitha dëshmitë relevante në kuptim të nenit 117 të LZP-së, konstatoi se ankesa e parashtruar nga subjekti politik N.N, nuk mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse për tu miratuar. Kjo për faktin se, nga Raporti i policisë e as nga shkresat e lëndës nuk është arritur që të vërtetohet pretendimet e paraqitësit të ankesës.*

## Parashtruesi çështjes, subjekti politik N.N, ka paraqitur ankesë kundër subjektit politik X.X, për shkak të përdorimit të gjuhës denigruese, fyese, nxitëse dhe ofenduese gjatë fushatës zgjedhore.

[Lidhur me këtë çështje PZAP-i, ka nxjerr Vendimin Anr.148/2019 të datës 02.10.2019](#)

**Faktet e Çështjes-** Subjekti politik N.N, në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ka paraqitur ankesë kundër subjektit politik X.X, për shkak të përdorimit të gjuhës denigruese, fyese, nxitëse dhe ofenduese, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura me datë 06.10.2019.

Me datë 30.09.2019 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik N.N, me seli në Prishtinë, dega në Pejë, me të cilën pretendon se më datë 29.09.2019, rreth orës 19:00, në Gjakovë, përkatësisht në Rr."Ali Pashë Tepelena", në një lokal afarist është mbajtur një tubim parazgjedhor, nga ana e subjektit politik X.X, ku përveç pjesëmarrjes së anëtarëve të kryesisë dhe kandidatëve për deputet në Kuvendin e Kosovës, nga radhët e këtij subjekti politik, prezent ishte edhe z.L.Q, - Udhëheqës i Sektorit për Komunitete dhe Kthim, pranë zyrës së kryetarit të Komunës së Rahovecit, në rolin e mbështetësit të X.X, dhe njëherësh edhe moderatorit të këtij takimi, i cili gjatë fjalimit të tij ka pohuar se "sidomos femrat është dashtë me pas një guxim, sepse para se me kandidu ne kemi mendu mirë përfshirjen e tyre, Jo vajza që kandidohen vetëm si me i marrë me qira në parti, por vajza që kanë guxim dhe mendojnë me ndryshua gjendjen ...", veprim ky i cili sipas paraqitësit të ankesës, shprehë fyerje të rëndë për femrat e komunitetit egjiptian, për kandidatet femra që janë pjesë e listës për Kuvendin e Republikës së Kosovës, nga radhët e subjektit politik N.N, dhe për të gjitha femrat në përgjithësi, i cili bie në kundërshtim me Rregullën Zgjedhore Nr.01/2012, "Për Kategorizimin e Sanksioneve dhe Gjobjave" dhe atë dispozitën e nenit 3 par.11 dhe nenin 5 par.2, të kësaj rregulle.

Ky takim sipas këtij subjekti politik është transmetuar edhe nga një faqe e Facebook-ut, me emrin "Mahalla Sefes". Më tej paraqitësi i ankesës, ka pretenduar se z. Q, me këto veprime ka keqpërdorur detyrën e tij zyrtare, duke mbështetur publikisht dhe duke u kyçur publikisht në veprimtari politike tek subjekti politik X.X, ku sipas të njëjtit këto veprime përbëjnë elemente të veprës penale, andaj edhe ky rast duhet të dërgohet në Prokurori për procedim të mëtejshëm. Në fund ka shtuar se z. Q, përderisa ushtron pozitën e punës si Udhëheqës i Sektorit për Komunitete dhe Kthim, pranë zyrës së kryetarit të Komunës së Rahovecit, në të njëjtën kohë udhëheq emisionin "Fokusi Ynë", i cili program transmetohet në kuadër të Radio Prosperiteti Chanel, që menaxhohet nga vet z. Q.

PZAP-i, duke u mbështetur në dispozitën e nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, **ankesën e parashtruar e miratoi si të bazuar**, pasi që nga fotografitë e ofruara si provë dhe shkresat e tjera të lëndës, shihet qartë se nga ana e subjektit politik X.X, është shkelur dispozita e nenit 33 pika l), e LZP-së, për faktin se në tubimin

parazgjedhor të këtij subjekti politik, nga ana e mbështetësit të këtij subjekti politik, z. L.Q është përdorur gjuhë denigruese, fyese dhe ofenduese ndaj kandidateve femra që janë pjesë e listës për Kuvendin e Republikës së Kosovës, nga radhët e subjektit politik N.N.

## Arsyetimi i Panelit – PZAP



Në përgjigjen në ankesë të datës 01.10.2019, z. L.Q, i ka kundërshtuar pretendimet e paraqitësit të ankesës, me arsyetimin se me prononcimet e tij, ai nuk ka ofenduar askënd, por përkundrazi është munduar të fuqizoj, motivoj, rreth rëndësisë së angazhimit të vajzave dhe grave në vendimmarrje, nga radhët e komunitetit jo shumicë. Sipas tij në atë tubim kanë marrë pjesë edhe përfaqësues ndërkombëtar nga OSCE, dhe vendor nga Demokracia në Veprim, e të cilët nuk kanë vlerësuar apo raportuar për një incident të ngjashëm. Sa i përket pretendimit për shkelje të detyrës zyrtare, i njëjti ka theksuar se edhe ky pretendim nuk qëndron, për faktin se ai nuk mban asnjë pozitë zyrtare në asnjë subjekt politik, dhe asnjëherë nuk ka kandiduar në radhën e ndonjë subjekti politik, se duke i'u referuar lirive dhe të drejtave të njeriut, secili individ, ka të drejtë të ketë një simpati apo të jetë në ndonjë subjekt politik (duke u nënkuptuar asnjëherë mos keqpërdorimin e autoritetit publik). Më tej ka shtuar se sa i përket rolit dhe rëndësisë së përgjegjësisë së tij, në cilësinë e udhëheqësit të një emisioni radio-televiziv për komunitetet jo shumicë në Gjakovë, “Fokusi Ynë”, kjo nuk e ndalon dhe nuk e fuqizon asnjë subjekt politik, kur ata ftohen në emisione për të promovuar, debatuar dhe diskutuar për gjendjen e komuniteteve, konform rregullave në fuqi kur ata kanë qenë të ftuar por asnjëherë nuk i janë përgjigjur ftesës, duke përfunduar se përmendja e emrit të tij mund të cilësohet puro si inat ndaj personalitetit të tij.

Në përgjigjen në ankesë të datës 02.10.2019, subjekti politik X.X, ka konsideruar se pretendimet e paraqitësit të ankesës janë të pabazuara, duke theksuar se prononcimi i z. L.Q, gjatë tubimit parazgjedhor të X.X, nuk paraqet fyerje për femrat e komunitetit egjiptian, sepse fjalët e thëna në atë tubim, nuk i referohen subjektit politik N.N, e as komunitetit egjiptian, por vetëm lavdëron kualitetin e femrave të përfshira në listën e kandidateve të X.X, si dhe përmes këtyre fjalëve janë vënë në pah vështirësitë e subjekteve politike për përmbushjen e kuotës gjinore në listat zgjedhore. Sa i përket pretendimit se z. Q ka keqpërdorur pozitën e tij zyrtare, duke mbështetur publikisht dhe duke u kyçur në veprimtari politike tek subjekti politik X.X, paraqitësi i përgjigjes në ankesë – X.X, thekson se të njëjtat nuk qëndrojnë, sepse z. Q, nuk mban asnjë pozitë udhëheqëse në strukturat e X.X, dhe as nuk është anëtar i këtij subjekti politik, se qëndrimet e z. Q, në cilësinë e moderatorit, janë qëndrime të X.X dhe jo qëndrime të tij personale, dhe se moderimi i tubimit parazgjedhor është bërë gjatë vikendit, pra jashtë orarit të tij të punës në Komunën e Rahovecit. Në fund ka kërkuar nga PZAP-i, që ankesa të hudhet poshtë.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se: **Ankesa është e bazuar**

## Shënim

Nga CD-ja, fotografitë e ofruara si provë dhe shkresat e tjera të lëndës, shihet qartë se nga ana e subjektit politik X.X, është shkelur dispozita e nenit 33 pika l), e LZP-së, e cila ndër të tjera përcakton se; 'Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: ... l) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve", për faktin se në tubimin parazgjedhor të këtij subjekti politik, nga ana e mbështetësit të këtij subjekti politik, z. L.Q, është përdorur gjuhë denigruese, fyese dhe ofenduese ndaj kandidateve femra për deputete në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Lidhur me këto prononcime të z. Q, subjekti politik X.X, në përgjigjen e tij në ankesë, edhe vetë ka pranuar se qëndrimet e z. Q, në cilësinë e moderatorit, janë qëndrime të X.X, dhe jo qëndrime të tij personale.

Sa i përket pretendimit të paraqitësit të ankesës se nga ana e z. Q është bërë keqpërdorim i detyrës zyrtare, për çka edhe rasti duhet të procedohet në Prokurori, paneli vlerësoi se me veprimet e z. Q, nuk janë përmbushur të gjitha elementet e veprës penale, keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar, ashtu siç parashihet me Kodin Penal të Republikës së Kosovës, andaj edhe nuk ka bazë që ky rast të përcillet për procedim të mëtejshëm në Prokurori e Shtetit.

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e subjektit politik X.X, është shkelur dispozita e lartcekur e LZP-së, si dhe neni 5 paragrafi 1 pika d) i Rregullës Zgjedhore Nr.13/2013, ku parashihet se subjektet e certifikuara politike aktivitetet e tyre zgjedhore duhet t'i bëjnë në pajtueshmëri me Rregullat zgjedhore të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ). Ky përfundim ka të bëjë me faktin se Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politik të jenë në një atmosferë të tolerancës demokracisë, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit .

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalët, shkallën dhe peshën e shkeljes, pjesëmarrjen e subjekti politik në zgjedhjet e mëparshme që konsiston në faktin se subjekti politik X.X, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, shkeljet e Ligjeve zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje dhe në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë që do të thotë se i njëjti është i njoftuar me rregullat zgjedhore si dhe shumën e fondeve që ka marrë subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve lidhur me fushatën zgjedhore. Po ashtu si rrethanë PZAP-i, mori edhe faktin që këtij subjekti, i'a dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjet e tij ka mohuar shkeljet e supozuara.



*Mos ndërmarrja e masave përmirësuese ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi .*

*Paneli konform nenit 120.1 pika a) të LZP-së, urdhëroi subjektin politik X.X, që të marrë masa dhe të përmirësoj shkeljet në afatin prej 24 orëve dhe nëse i njëjti nuk vepron sipas urdhrorit të panelit do të sanksionohet me dënim shtesë nga PZAP-i , në pajtim me nenin 120.2 të LZP-së.*

*Vendimi i PZAP-it, Anr.148/2019, ishte apeluar nga subjekti politik X.X, në Gjykatën Supreme të Kosovës, me ç 'rast Gjykata e ka hudhur poshtë si të palejuar me aktvendimin numër A.A.nr.9/2019 dhe ka vërtetuar Vendimin e PZAP-it.*

## Parashtruesi çështjes, organizata N.N, ka paraqitur ankesë kundër subjektit politik X.X, për shkak të përfshirjes së fëmijëve të mitur në fushatë zgjedhore

[Lidhur me këtë çështje PZAP-i, ka nxjerr Vendimin Anr.169/2019 të datës 04.10.2019](#)

**Faktet e Çështjes-** Organizata N.N, në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ka paraqitur ankesë kundër subjektit politik X.X, për shkak të përfshirjes së fëmijëve të mitur gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura me datë 06.10.2019.

Me datën 01.10.2019, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga N.N, me seli në Prishtinë, me të cilën pretendon se me datën 01.10.2019, rreth orës 14:52, kemi vërejtur se kandidati për deputet nga radhët e X.X, U.I, në rrjetin e tij social në instagram, me datë 25.09.2019, në ditën kur zyrtarisht ka filluar fushata për zgjedhjet e 6 tetorit, ka shpërndarë një video në të cilën shfaqet një vogëlushe 13 vjeçare, duke e falënderuar për listën e barnave esenciale. Kandidati në fjalë me rastin e publikimit të kësaj video ka shënuar edhe numrin e tij në këto zgjedhje, si dëshmi për këtë në ankesë gjenden të bashkangjitura edhe fotografitë dhe video. Me anë të kësaj video vlerësojmë se kandidati për deputet është munduar që të përfitojë vota emocionale, ku në fund të postimit shkruan “Bashkë ndreqim”, kështu duke vepruar në kundërshtim me rregulloren 13/2013 e plotësuar me rregulloren 20/2019 për Fushatën e Zgjedhjeve dhe Njoftimi për Ngjarjet, përkatësisht nenin 5 paragrafi 3 pikën d).

PZAP-i, duke u mbështetur në dispozitën e nenit 118 paragrafi 1 i LZP-së, ankesën e parashtruar e ka refuzuar si të pabazuar, për arsye se prej dy fotografive dhe CD-video-së, që gjendet në shkresat e lëndës, dhe nga shikimi në profilin e instagramit të U.I, e njëjta video është publikuar para se të filloj fushata zgjedhore për zgjedhjet e përkohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, nuk mund të konstatohet ndonjë material promovues me karakter politik të fushatës zgjedhore, me qëllim të përfitimit të votave në mënyrë emocionale, siç është pretenduar në ankesë.

PZAP-i, duke u mbështetur në dispozitën e nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, **ankesën e parashtruar e miratoi si të bazuar**, pasi që nga fotografitë e ofruara si provë dhe shkresat e tjera të lëndës, shihet qartë se nga ana e subjektit politik X.X, është shkelur dispozita e nenit 33 pika l), e LZP-së, për faktin se në tubimin

## Arsyetimi i Panelit – PZAP



Subjekti politik X.X, në përgjigje në ankesë të datës 02.10.2019, konsideron se nuk është shkelur Rregulla Zgjedhore Nr. 13/2013, e plotësuar me Rregulloren Nr. 20/2019, për Fushatën e Zgjedhjeve dhe Njoftimi për Ngjarjet, përkatësisht nenin 5 par. 3 pikën d), duke theksuar se kjo video ka të bëjë me aktivitetet e U.I, si Ministër i Shëndetësisë, jashtë fushatës zgjedhore, e jo me fushatën zgjedhore të X.X, dhe as me U.I, si kandidat, sepse ajo është publikuar me datë 23.09.2019 në profilin “facebook dhe instagram” të U.I, kjo dëshmohet me fotografitë të cilat i kemi bashkangjitur në përgjigje.


PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se: **Ankesa është e pabazuar.**

### Shënim

*PZAP-i, vendimet e tij e bazon në dëshmi të qarta dhe bindëse siç është përcaktuar me nenin 117 paragrafi 3, i LZP-së, e që në rastin konkret dy fotografit dhe CD-video, të prezantuara si prova materiale nga pala ankuese, për shkeljen e pretenduar nga kandidati për deputet U.I, nga radhët e subjektit politik X.X, se i njëjti ka thyer kodin e mirësjelljes me rastin e publikimit të videos lëndore.*

*Paneli pasi ka shikuar videon e publikuar ka vërtetuar faktin se kjo video nuk përmban material promovues për fushatën zgjedhore, nga shikimi në profilin e instagramit të U.I, e njëjta video është publikuar para se të filloj fushata zgjedhore për zgjedhjet e përkohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, andaj ankesa nuk është e bazuar, ngase prej dy fotografive dhe CD-video-së, që gjendet në shkresat e lëndës nuk mund të konstatohet ndonjë material promovues me karakter politik të fushatës zgjedhore, me qëllim të përfitimit të votave në mënyrë emocionale, siç është pretenduar në ankesë.*

*Andaj paneli erdhi në përfundim se janë të paqëndrueshme përshkrimet në ankesë, se është thyer Kodi i Mirësjelljes sipas Rregullës Zgjedhore Nr. 13/2013, e plotësuar me Rregulloren Nr. 20/2019, për Fushatën e Zgjedhjeve dhe Njoftimi për Ngjarjet, përkatësisht nenin 5 paragrafi 3 pika d), nga subjekti politik X.X.*



Në këtë pjesë janë përzgjedhur vendimet të cilat i referohen procesit të heshtjes zgjedhore për zgjedhjet e parakohshme të vitit 2019 të mbajtura për Kuvendin e Republikës së Kosovës

## Parashtruesi i çështjes, Organizata Jo Qeveritare N.N ka paraqitur ankesë kundër subjektit politik A.A me të cilën pretendon se kandidati B. S. nga radhët e subjektit politik A.A, ka vazhduar sponsorimin e fushatës zgjedhore përmes SMS-ve, duke dërguar mesazhe telefonike edhe në ditën e heshtjes zgjedhore

Lidhur me këtë çështje PZAP-i, ka nxjerr Vendimin Anr.329/2019 të datës 07.10.2019

**Faktet e Çështjes-** Paraqitësi i ankesës, N.N, me seli në Prishtinë, me datën 06.10.2019, ka paraqit ankesë në PZAP, me të cilën pretendohet se gjatë ditës së heshtjes zgjedhore, kandidati B.S nga radhët e subjektit politik A.A, ka vazhduar sponsorimin e fushatës zgjedhore në Telefon, përmes SMS-ve, edhe në ditën e heshtjes zgjedhore. Më këtë rast pretendohet se është bërë thyerja e heshtjes zgjedhore, të përcaktuar me LZP. Me propozim për PZAP-in, që ankesa të miratohet e bazuar.

Në përgjigjen në ankesë, të datës 07.10.2019, subjekti politik, A.A, thekson se ankesa e bërë nga organizata jo qeveritare N.N është e pabazuar për faktin se ankesa bazohet mbi një komunikim privat, jo publik për kandidatin në fjalë. Më tutje theksojnë se një gjë e tillë nuk ka ndodhur përmes ndonjë rrjeti të autorizuar për shpërndarje masive të mesazheve, por thjesht është një mesazh privat.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se: **Ankesa është e bazuar**

### Arsyetimi i Panelit – PZAP



Nga provat e ofruara nga parashtruesi i ankesës shihet qartë se nga numri telefoni +38349... ka arritur sms përmes të cilit është bërë thirrje për të votuar, numri i subjektit politik “135 dhe kandidatit me numër 65” veprime këto të ndaluara sipas nenit 36 paragrafi 1 të LPZ-së, i cili përcakton se: “Njëzetekatër (24) orë para hapjes së qendrave të votimit për hedhjen e votës, e deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndalohet secili prej veprimeve si më poshtë:

- **a)** Shpërndarja ose shfaqja në mënyrë tjetër ndonjërin nga qendrat e votimit ose 100 metra brenda hapësirës së të njëjtës, e çfarëdo lloje materiali me qëllim ndikimi tek votuesit;
- **b)** Bërja e fushatës në çfarëdo mënyre”.

Sa i për ketë pretendimeve të subjektit politik A.A në përgjigjen në ankesë i cili thekson se , ankesa e bërë nga N.N është e pabazuar për faktin se ankesa bazohet mbi një komunikim privat, jo publik për kandidatin në fjalë, një gjë e tillë nuk ka ndodhur përmes ndonjë rrjeti të autorizuar për shpërndarje masive të mesazheve, por thjesht është një mesazh privat, Paneli pretendimet e tilla i vlerësoj të pa bazuara dhe si të tilla i refuzoj pasi që, me këto thënie nuk justifikon veprimet që janë të ndaluara dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore të Nenit 36 par.1 pika a) dhe b) i LZP-së

## Shënim

---

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e subjektit politik A.A, është shkelur neni 36 paragrafi 1 të LPZ-së , pasi që në provat e ofruara në fotografi shihet qartë numri i telefonit, mesazhi i dërguar dhe personi që e ka dërguar.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret, se subjekti politik A.A, ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se është njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe përkundër këtij fakti nga ana e këtij subjekti është thyer heshtja zgjedhore ku përmes mjetit të komunikimit viber ka kërkuar votën për vete dhe për A.A, gjë e cila është në kundërshtim me dispozitat e lartë cekura ligjore.

Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që subjektit politik në fjalë, iu dha mundësia për tu përgjigjur në ankesë, mirëpo subjekti politik nëpërmes përgjigjes në ankesë shihet qartë se nuk e ka pranuar shkeljen dhe për më tepër ka deklaruar se ky veprim i tyre nuk është në kundërshtim me dispozitat ligjore, veprime këto të cilat kanë ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

## Parashtruesi i çështjes, Subjektet politike N.N. gjatë ditës së heshtjes zgjedhore ka paraqitur ankesa kundër subjektit politik X.X me të cilën pretendonin se subjekti politik në fjalë përmes SMS-ve, ka bërë sponsorimin e fushatës zgjedhore edhe në ditën e heshtjes zgjedhore.

### Lidhur me këtë çështje PZAP-i, ka nxjerr Vendimin Anr.332/2019 të datës 07.10.2019

**Faktet e Çështjes-** Me datë 06.10.2019, subjekti politik N.N, me seli në Prishtinë, ka paraqitur në PZAP, ankesën Anr.332/2019, kundër subjektit politik X.X me seli në Prishtinë, me të cilën ka pretenduar, se nga ana e subjektit politik X.X, janë dërguar SMS, me thirrje për votim, në ditën e zgjedhjeve, dy orë pas mbylljes së vendvotimeve, veprim ky i cili sipas paraqitësit të ankesës bie në kundërshtim me nenin 36 par.1, pika b) të LZP-së, nenin 7 të Rregullës Zgjedhore Nr.11/2013, dhe nenin 8 të Rregullës Zgjedhore Nr.13/2013, duke propozuar që këto veprime të sanksionohen sipas legjislacionit zgjedhor. Paraqitësi i ankesës, si dëshmi për të vërtetuar pretendimet e tij, ankesës i ka bashkangjitur një fotografi të printuar, në cilësi të provës materiale.

Subjekti politik X.X me seli në Prishtinë, në përgjigje në ankesë, të datës 07.10.2019, ka theksuar se pretendimet e ankuesit janë të pabazuara, për arsye se fotoja që paraqitësi i ankesës i ka bashkangjitur ankesës, është e paqartë dhe nuk përmban argumente se nga kush është dërguar si dhe kush e ka pranuar sms-in, duke propozuar që PZAP-i, ta hudhë **ankesën si të pabazuar**.

### Arsyetimi i Panelit – PZAP



PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të bazueshmërisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, ankesën e parashtruar e ka refuzuar si të pabazuar, pasi që ka vlerësuar se pohimet e ankuesit janë të pa argumentuara dhe të pa dëshmuara me asnjë provë relevante, për faktin se se paraqitësi i ankesës, ankesës nuk i ka bashkangjitur dëshmi të qarta dhe bindëse për të argumentuar pretendimet e tij.

Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin. Në rastin konkret, Paneli nuk mundi të konstatoj se nga ana e subjektit politik X.X, është shkelur dispozita ligjore e LZP-së, ashtu siç pretendon paraqitësi i ankesës, për faktin se paraqitësi i ankesës, ankesës nuk i ka bashkangjitur dëshmi të qarta dhe bindëse për të argumentuar pretendimet e tija, se nga ana e subjektit politik X.X janë shkelur dispozitat e LZP-së dhe rregullave zgjedhore.

## Shënim

---

*Nga fotografia e bashkangjitur si provë nga paraqitësi i ankesës, e cila gjendet në shkresat e lëndës, nuk mund të konstatohet data, koha dhe as vendi i shkeljes së supozuar, ashtu siç edhe nuk mund të konstatohet se kush është dërguesi e kush është pranuesi i sms-it, koha e dërgimit. Andaj, Paneli vlerësoi se ankesa e parashtruar nga subjekti politik N.N, nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk rezultoi se në këtë rast ka ndodhur shkelje e dispozitave ligjore të LZP-së, e as e rregullave zgjedhore, dhe për rrjedhojë nuk ka bazë ligjore që ndaj subjektit politik X.X, të shqiptohet gjobë në kuptim 120 par 1 pika c) të LZP-së.*

*Neni 117 par.3, të LZP-së përcakton qarte se për tu aprovuar një ankesë si e bazuar e njëjta duhet të jetë e argumentuara me prova konkrete dhe bindëse andaj PZAP-i nga ky konstatim ka gjetur se në ankesën e paraqitur nga pala ankuese nuk është paraqitur data, koha dhe vendi i shkeljes së supozuar si kundër që pala ankues nuk ka arritur që të argumentoj se kush është dërguesi e kush është pranuesi i sms-it.*



## Parashtruesi i çështjes, Organizata Jo Qeveritare N.N ka paraqitur ankesë kundër subjektit politik X.X., me të cilën pretendonin se në ditën e votimit, në afërsi me pak se 100 metra afër Qendrës së Vendvotimit, subjekti politik X.X, ka vendosur posterin e kandidatit për deputet G.H.

Lidhur me këtë çështje PZAP-i, ka nxjerr Vendimin Anr.326/2019 të datës 07.10.2019

**Faktet e Çështjes-** Parashtruesi i ankesës, N.N, me seli në Prishtinë, me datën 06.10.2019, ka paraqitur ankesë në PZAP, me të cilën pretendohet se në ditën e votimit m datë 6 Tetor 2019, në afërsi me pak se 100 metra afër Qendrës së Vendvotimit, Shkollës Fillore “Resim Kiçina”, kanë vendosur mund të posterin e kandidatit për deputet G.H, nga radhët e subjektit politik X.X. Më këtë rast pretendohet se një gjë e tillë bie ndesh me Rregullën Zgjedhore nr.13/2013 neni 3 pika 3.4.

Në përgjigjen në ankesë subjekti politik, X.X konsideron se ankesa e N.N është e pabazuar, për faktin se ka ushtruar ankesë me një fotografi të vetme me arsyen se është afër një shkolle por në anën tjetër nuk tregojnë saktë dhe në mënyrë të besueshme se cila është distancë e kësaj fotoje nga shkolla. Sipas subjektit politik X.X, në përgjigjen e tij thekson se distanca e fotos nga shkolla është më e madhe se 300 metra ku shihet mire se aty është parku i qytetit. Më tutje thekson se në bazë të provave-fotografisë nuk shifin institucionet publike

### Arsyetimi i Panelit – PZAP



PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të besueshmërisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore si dhe provave materiale-fotografia, e bashkangjitur, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenin 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se **Ankesa është e bazuar**

Paneli, në këtë çështje juridike me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike shqyrtoi pretendimet e palëve në procedurë dhe provat, si në vijim: shikoj një fotografi të printuar në formatin A4.

Nga fotografitë e ofruara si provë nga paraqitësi i ankesës dhe pala tjetër me anë të përgjigjes në ankesë, shihet qartë se posterin e kandidatit për deputet G.H, nga radhët e subjektit politik X.X, ka qenë i vendosur në një perimetër apo distancë më të afërt se 100 metra nga objekti - Shkolla Fillore “Resim Kiçina” në Drenas, njëherit QV, për ditë të votimit, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 36 par.1, pika a) dhe b), të LZP-së, e cila përcakton se: “ Njëzetekatër (24) orë para hapjes së qendrave të votimit për hedhjen e votës, e deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndalohet secili prej veprimeve si më poshtë:


- a) Shpërndarja ose shfaqja në mënyrë tjetër në ndonjërin nga qendrat e votimit ose 100 metra brenda hapësirës së të njëjtës, e çfarëdo lloj materiali me qëllim ndikimi tek votuesit;
- b) Bërja e fushatës në çfarëdo mënyre “si dhe nenit 85.1 të LZP-së, parashihet që 24 orë para fillimit të votimit të gjitha subjektet politike të cilat nuk kanë larguar materialet e fushatave të tyre zgjedhore të vendosura brenda dhe rreth cilido vendvotim ose qendre të votimit në rreze prej 100 metra, duhet të largohen nga anëtarët e KKV-ve, ose Menaxheri i QV-së, dhe se subjektet politike të cilat nuk i kanë larguar ose janë gjetur duke postuar do të raportohen në PZAP për shkelje të këtij ligji.

## Shënim

*Pasi që paneli, bëri vlerësimin e secilës provë ,duke u mbështetur në dispozitat e nenit 117 par. 3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP), nga të njëjtat vërtetoj faktin e pretenduar si në parashtrimet e ankesës se posteri i kandidatit për deputet G. H, nga radhët e subjektit politik X.X, ka qenë i vendosur në afër shkollës fillore 'Resim Kiçina' në Drenas, njëherit QV, për ditë të votimit, ky fakt është vërtetuar nga fotografitë të cilat gjenden ne shkresat e lëndës, andaj e **pranoj si të bazuar ankesën** dhe vendosi si në dispozitiv duke marr parasysh arsyet në vijim për shqiptimin e lartësisë së gjobës.*

*Neni 85.1 të LZP-së, përcakton se 24 orë para fillimit të votimit duhet të largohen materialet e fushatave të tyre zgjedhore të vendosura brenda dhe rreth cilido vendvotim ose qendre të votimit në rreze prej 100 metra, dhe se subjektet politike të cilat nuk i kanë larguar ose janë gjetur duke postuar do të raportohen në PZAP për shkelje të këtij ligji. Andaj ne rastin e tille nga ana e subjektit politik ndaj te cilit është paraqitur ankesa nuk ka ndërmarr një veprim i tille dhe për këtë arsye e njëjta është gjobitur nga PZAP-i*

*Ndaj këtij vendimi pala e pakënaqur ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme të Kosovës, dhe i njëjti vendim është vërtetuar edhe nga Gjykata Supreme e Kosovës me vendimin e tij A.A.nr.30/2019.*



Në këtë pjesë janë për zgjedhur vendimet të cilat i referohen procesit zgjedhore në ditën e votimit për zgjedhjet e parakohshme të vitit 2019 të mbajtura për Kuvendin e Republikës së Kosovës

## **Parashtruesi i çështjes, Subjektet politike nga koalicioni N.N. kanë paraqitur ankesë kundër kryesuesve dhe anëtarëve të Vendvotimit me numër 2114B/01R,02R,03R,04D, në Skenderaj, me të cilën pretendon se në këto vendvotime kanë humbur disa fletëvotimeve**

### Lidhur me këtë çështje PZAP-i, ka nxjerr Vendimin Anr.344/2019 të datës 10.10.2019

**Faktet e Çështjes-** Me datë 07.10.2019, PZAP-i ka pranuar ankesat Anr.344/2019 dhe Anr.354/2019 të paraqitura nga koalicioni N.N, me seli në Prishtinë, kundër kryesuesve dhe anëtarëve të QV 2114B, Vendvotimet me numër 2114B/01R,02R,03R,04D, shkolla "Shotë Galica, në fshatin Runik, komuna Skenderaj, me të cilën kanë pretenduar se në vendvotimet e cekura në ankesë kanë humbur disa fletëvotime, sipas tyre janë vjedhur dhe është dëmtuar rëndë procesi dhe administrimi i votimit dhe numrit të votave në këtë Vendvotim. Sipas pretendimeve në ankesën Anr.354 theksohet se rreth orës 17:00 nga QV e cekur më lartë janë nxjerrë jashtë qendrës rreth 600 fletëvotime të paplotësuara. Më tutje është theksuar se lidhur me këtë rast është përfshirë policia dhe Prokuroria e Kosovës, me ç'rast kanë marrë në pyetje anëtarët e KVV-ve dhe trupat udhëheqëse të Vendvotimit.

Kërkon nga PZAP-i, që ankesën e tyre ta aprovojnë dhe të autorizohet KQZ-ja, përkatësisht QNR-në që të bëjë rinumërimin e kutive të vendvotimit të cekur më lartë.

PZAP-i ankesën e parashtruar e ka pranuar si të bazuar, pasi që nga raporti i policisë është vërtetuar se kryesuesi i Vendvotimit A.Sh ka njoftuar policinë lidhur me parregullsinë gjatë procesit zgjedhor-humbja e fletëvotimeve dhe se ky rast është hetuar edhe nga policia në bazë të njoftimit të bërë nga kryesuesi i këtij vendvotimi, dhe nga hetimet e bëra është konstatuar se fletëvotimet e humbura janë gjetur të plotësuara në të njëjtën QV në katin e epërm të atij vendvotimi.

Ndërsa në pjesën tjetër ku e ka hedhur si të palejuar ankesën lidhur me kërkesën që i referohet kërkesës për rinumërim nga QNR lidhur në VV e cekura në ankesë Paneli e ka hedhur si të palejuar pasi që kjo kërkesë është dashur që të parashtrohet me rastin e shpalljes së rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja, e jo më herë pasi që në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk ishte marrë vendimi përfundimtar mbi shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj Paneli vendosi që një pjesë të ankesës ta hedhë si të parakohshme.

## Arsyetimi i Panelit – PZAP



Lidhur me rastin në fjalë PZAP-i e njoftoi edhe Policinë e Kosovës dhe kërkoi nga ata që të ndërmarrin veprime konkrete.

Në raportin e policisë të datës 08.10.2019, theksohet se lidhur me rastin në fjalë më datën 06.10.2019 në QV 2114B në shkollën “Shotë Galica”, me të cilin ishin katër VV me numër 2114B/01R,02R,03R,04D, në fshatin Runik, komuna Skenderaj, rreth orës 18:40 nga policët e caktuar në këtë QV ishte lajmëruar një ankesë. Ankesa në fjalë kishte të bëjë me marrjen e disa fletëvotimeve të zbrazëta. Pas pranimit të ankesës, njësia e hetimeve në ora 19:20 ka shkuar në këtë QV dhe ka takuar menaxherin e asaj qendre dhe ankuesin i cili ishte kryesues në VV nr. 2114B/01R A.Sh. Këta persona e kanë njoftuar njësitin hetimor se nga ky VV ishin marrë dhe nxjerrë jashtë vendvotimit nëntë (9) blloka me 450 fletëvotime të zbrazëta (një bllok i kishte 50 copë fletëvotime). Sipas kryesuesit të këtij VV, në këtë VV i ka pranuar 750 fletëvotime, votues kishin qenë 889 veta, kishin votuar 299 votues dhe ishin vjedhur 450 fletëvotime. Kryesuesi i këtij VV, A.Sh kishte deklaruar se vjedhjen e fletëvotimeve e ka vërejtur rreth orës 18:00. Në këtë VV të angazhuar në procesin zgjedhor kanë qenë, A.Sh Kryesues, anëtarët: D.H, B.T, A.B, A.Ç, vëzhguesit: A.N, A.D, E.Sh, F. M, A.Ç, V.H, Sh.M, A.Ç dhe P.R. Pas intervistimit të këtyre personave, të gjithë janë deklaruar se fletëvotimet mungojnë por asnjëri nuk ka ofruar informata se kush apo mënyrën se si janë nxjerrë këto fletëvotime jashtë atij VV, dhe se kanë deklaruar gojarisht se mungesën e fletëvotimeve e kanë kuptuar pasi e ka alarmuar rastin kryesuesi i këtij VV njëherit edhe ankuesi i këtij rasti A.Sh. Sipas raportit policor, kryesuesi i këtij VV, A.Sh, me të cilën e ka paraqitur rastin, pas marrjes në pyetje nga njësia e hetimit kishte deklaruar se nuk ka ndonjë informatë se kush i ka marrë fletëvotimet, dhe e ka përjashtuar mundësinë që dikush nga anëtarët e atij komisioni zgjedhor të ketë qenë i përfshirë në marrjen e fletëvotimeve. Ai ka deklaruar se në një moment për pak minuta kishte dal nga VV për ta përshëndetur dikë në korridor të shkollës dhe në atë moment ka vërejtur një person i panjohur për të kishte hyrë dhe i kishte marrë fletëvotimet, por që sipas tij nuk është anëtar i komisionit. Në raportin policor është cekur se nga fletëvotimet e humbura vetëm 100 nuk janë gjetur ndërsa të tjerët kanë qenë të plotësuar, të mbushura. Njësia hetuese fletëvotimet e gjetura i ka marr për ekzaminim si dhe DVD nga kamera e shkollës për të vërtetuar a kanë funksionuar kamerat, pasi që menaxheri i këtij QV, njëherit drejtor i kësaj shkolle, kishte deklaruar se nuk kanë qenë në funksion kamerat. Deklarata e dytë e kryesuesit të këtij VV është dhënë më datë 07.10.2019, A.Sh, i cili ka deklaruar se i dyshuari për marrjen e fletëvotimeve është një person që nuk ka qenë i angazhuar në procesin zgjedhor, por që deklaroi se nuk e ka njohur më parë.

Paneli, paraprakisht ka vlerësuar se ankesat: Anr.344/2019 dhe Anr.354/2019, të datës 07.10.2019, janë për nga përmbajtja të njëjta, për nga natyra e shkeljes së pretenduar janë të njëjta, janë paraqitur nga e njëjta palë ankuese kundër subjektit të njëjtit politik, prandaj paneli bazuar në nenin 8 paragrafi 3 i Rregullave dhe Procedurave Nr.02/2015, të PZAP-it, në të cilën përcaktohet se: Me qëllim të lehtësimit të shqyrtimit të ankesave kryesuesi i panelit vend marres mund të vendos ta bëjë bashkimin e ankesave që përmbajnë në vete çështje të ngjashme dhe se ato ankesa të trajtohen me

një vendim”, andaj paneli bëri bashkimin e ankesave dhe për të njëjtat vendosi me një vendim, si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli, pasi që shqyrtoj pretendimet e palëve ne procedure dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se ankesat janë pjesërisht të **bazuara** për këto arsye: Neni 94 i LZP-së përcakton qartë se kryesuesi, anëtarët e KVV-së dhe vëzhguesit e akredituar të pranishëm lejohen të bëjnë shënime apo vërejtje në librin e votimit (librin e shënimeve në vendvotim) në të cilën shënohen ngjarjet që ndodhin në vendvotim.

Paneli, vlerëson se pretendimi i parashtruesit të ankesës lidhur me mos evidentimin e personave apo personit i cili ka bërë nxjerrjen e fletëvotimeve nga QV 2114B e përkatësisht nga VV nr. 2114B/01R, është i qëndrueshëm sepse nga raporti i policisë i datës 08.10.2019 shihet se kryesuesi i Vendvotimit A.Sh ka njoftuar policinë lidhur me parregullsinë gjatë procesit zgjedhor-humbja e fletëvotimeve. Ky rast është hetuar edhe nga policia në bazë të njoftimit të bërë nga kryesuesi i këtij vendvotimi, dhe nga hetimet e bëra është konstatuar se fletëvotimet e humbura janë gjetur të plotësuar në të njëjtën QV në katin e epërm të atij vendvotimi, si dhe në këtë raport janë shënuar emrat e personave të angazhuar në procesin zgjedhor në këtë vendvotim, ndaj të cilëve paneli, i ka shqiptuar dënim si në dispozitiv të këtij vendimi

Lidhur pjesën e dispozitivit të këtij vendimi që ju është ndaluar komisionereve dhe vëzhgueseve në vendvotimin Nr. 2114B/01R, pjesëmarrja në zgjedhje në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vite, si kandidat dhe si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor, të menaxhuara nën autoritetin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), vendimi nga PZAP është marrë në bazë të nenit 120 par.3, pika d), në të cilin parashihet së “Në rast se ka ndodhur një shkelje e këtij ligji ose rregullave zgjedhore e cila e minon integritetin e zgjedhjeve PZAP-i mundet. d) Ndalojë një individ të marr pjesë në zgjedhjet e mbajtura nën autoritetin e KQZ-së, si kandidat apo edhe si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor, për një periudhë kohore që nuk u kalon gjashtë (6) vite”, pasi që PZAP-i, ka konstatuar se asnjëri nga komisioneret duke e përfshirë edhe kryesin e 2114B, nuk e kanë ndërmarr asnjë veprim në ditën e votimit të datës 06.10.2019, lidhur me evitimin e shkeljeve, siç është pretenduar në ankesë.

## Shënim

*Paneli nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me kërkesën për rinumërim nga QNR lidhur në vendvotimet e cekura në ankesë, me numër 2114B/01R,02R,03R,04D, pasi që kjo kërkesë duhet të parashtrohet me rastin e shpalljes së rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procesit zgjedhor. Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi përfundimtar mbi shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj Paneli vendosi që në pjesën e dytë të dispozitivit ta hedhë si të parakohshme ankesën e ankuesit.*

*Ndaj vendimit të PZAP-it subjektet politike nga koalicioni N.N kanë paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme të Kosovës, por e njëjta gjykatë me vendimin e saj e ka refuzuar ankesën si të pabazuar dhe ka vërtetuar vendimin e PZAP-it duke e lënë të njëjtin në fuqi.*

*Ky vendim është vërtetuar nga Gjykata Supreme e Kosovës me vendimin e tij A.A.nr.18/2019*

**Parashtruesi i çështjes, S.N nga subjekti politik N.N. në ditën e votimit ka paraqitur ankesë kundër Kryesuesit B.G dhe anëtarit të Këshillit të vendvotimit A.G në fshatin Kishnicë komuna e Graçanicës me të cilën pretendon se gjatë procesit zgjedhor - gjatë ditës së votimit në vendvotim, përveç flamurit të Republikës së Kosovës, si simbol i një shteti, ka qenë i vendosur edhe flamuri i shtetit të huaj, respektivisht ai i Republikës së Shqipërisë**

Lidhur me këtë çështje PZAP-i, ka nxjerr Vendimin Anr.346/2019, të datës 10.10.2019

**Faktet e Çështjes-** Me datë 07.10.2019, S.J, nga radhët e subjektit politik N.N, me seli në Graçanicë, ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën pretendon se më datë 06.10.2019, në vendvotimin me nr.3415D, në Shtëpinë e Kulturës në Kishnicë, ka ardhur deri te një parregullsi gjatë votimit, ashtu që gjatë procesit zgjedhor, përveç flamurit të Republikës së Kosovës, si simbol i një shteti, ka qenë i vendosur edhe flamuri i shtetit të huaj, respektivisht ai i Republikës së Shqipërisë, gjë kjo e cila sipas paraqitësës së ankesës ka shkaktuar nxitjen e urrejtjes etnike ndërmjet votuesve. Më tej ka shtuar se lidhur me këtë parregullsi nuk kanë reaguar as kryesuesi i KVV-së dhe as menaxheri i Qendrës së Votimit, të cilët në bazë të Kodit të Mirësjelljes dhe Rregullës Zgjedhore Nr.11/2013, kanë qenë të obliguar të reagojnë. Sipas paraqitësës së ankesës, vendosja e simboleve të shtetit të huaj në vendvotime, ka shkaktuar një nxitje më të madhe të publikut, kur ka dalë lajmi edhe në media. Andaj ka kërkuar nga PZAP-i, që ta miratoj ankesën dhe në bazë të përgjegjësisë objektive të i dënoj subjektet, kryesuesin A.G dhe menaxherin B.G, për shkak të mos largimit dhe mos reagimit ndaj situatës kontestuese. Paraqitësja e ankesës, si dëshmi për të argumentuar pretendimet e saj, ankesës i ka bashkangjitur disa fotografi të printuara, dhe një kopje të lajmit të publikuar për situatën kontestuese, në cilësi të provave materiale.

## Arsyetimi i Panelit – PZAP



Në përgjigje në ankesë të datës 08.10.2019, A.G, nga fshati Kishnicë, Komuna Graçanicë, lidhur me pretendimet ankimore, nuk e mohon faktin se ditën e zgjedhjeve ka qenë prezent në vendvotimin 3415E/01D, në Shtëpinë e Kulturës në Kishnicë, por i mohon pretendimet ankimore lidhur me nxitjen e urrejtjes etnike ndërmjet votuesve, me arsyetimin se objekti në të cilin është kryer procesi zgjedhor, është vend ku i kryen aktivitetet Shoqëria Kulturore Artistike “Minatori i Ri”, Kishnicë, dhe ato simbole janë të vendosura aty shumë kohë më parë, periudhë kohore kjo për të cilën as ai vet nuk është në dijeni, dhe as ai që i ka vendosur më herët, koreografi S.Th, ka qenë trajnues i këtyre zgjedhjeve, dhe trajnimet janë mbajtur në po këtë objekt. Më tej ka shtuar se ndihet shumë keq për atë që ka ndodhur, duke theksuar se gjatë gjithë procesit kanë pasur anëtarë – komisionerë të dy nacionaliteteve, shqiptar dhe serb, me të cilët kanë

kaluar shumë mirë, dhe se ai personalisht nuk ndjen urrejtje për askënd. Në fund ka shtuar se kërkon falje nga PZAP-i, N.N dhe çdo person tjetër që është prekur nga ky rast, për këtë lëshim që është bërë, duke theksuar se nuk është bërë me vetëdije, se ai ka hallet e tij, pasi që ka një djalë të palëvizshëm dhe nuk ka pasur për qëllim të dëmtoj askënd. Për këtë lëshim i njëjti ka deklaruar se është i gatshëm të kërkoj falje në mënyrë publike.

Në përgjigje në ankesë të datës 08.10.2019, I.Ć, Zyrtar i Lartë Komunal Zgjedhor, ka theksuar se për shkeljen e pretenduar në ankesë, është njoftuar nga paraqitësja e ankesës, përmes telefonit, në ditën e votimit, më datë 06.10.2019 në ora 18:45, të cilën ai e ka njoftuar që nëse mendon se ka pasur ndonjë shkelje t'i drejtohet PZAP-it, përmes ankesës. Më tej ka shtuar se, lidhur me shkeljen e pretenduar, përgjegjësinë për planifikimin dhe organizimin e të gjitha aktiviteteve teknike, brenda dhe jashtë Qendrës së Votimit, në diametrin prej 25 metër nga hyrja në objekt e mban menaxheri i Qendrës së Votimit, ashtu siç përcaktohet me Rregullën Zgjedhore Nr.09/2013 të KQZ-së, respektivisht nenin 6 par.2, dhe nenin 8 par.8, të kësaj Rregulle i cili përcakton se lidhur me përgatitjet teknike në vendvotime, përgjegjësinë për përgatitjen dhe rregullimin e vendvotimit e mbajnë të gjithë anëtarët e Këshillit të Vendvotimit, dhe me Udhëzuesin për procedurat e votimit dhe numërimit, të lëshuar nga Sekretariati i KQZ-së,

Në përgjigje në ankesë të datës 08.10.2019, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), ka theksuar se pretendimet e palës ankuese janë të paqëndrueshme, sepse neni 33 pika 1 e LZP-së dhe Rregulla Zgjedhore Nr.11/2013, i specifikon veprimet e ndaluara të subjekteve politike, gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, dhe jo veprimet e ndaluara për ditën e zgjedhjeve në vendvotim, andaj në bazë të dispozitave ligjore të lartcekura, ankesa është e pabazuar dhe si e tillë duhet të refuzohet.

Në përgjigje në ankesë, të dhënë përmes email-it, më datë 09.10.2019, A.Th, ka theksuar se ajo ka qenë komisionere në Kishnicë, dhe i ka kryer detyrat e saj, ndërsa përgjegjës i sallës ka qenë dikush tjetër, duke shtuar se vendvotimi ka qenë Shtëpi e Kulturës dhe si çdo objekt tjetër i cili karakterizohet me diçka, edhe ajo i ka pas karakteristikat e veta, kështu që nuk ka pas asnjë arsye për më shfaq urrejtje etnike me serb, sepse në Graçanicë dhe Kishnicë kanë raporte shumë të mira me ta.

Në deklaratën e V.S, të dhënë në PZAP, më datë 09.10.2019, i njëjti ka theksuar se më datë 06.10.2019, ai ka qenë anëtar i këshillit të vendvotimit, në vendvotimin 3415E/01D në Kishnicë, në të cilin vendvotim ka qenë i vendosur flamuri i Kosovës dhe afër tij edhe flamuri i Republikës së Shqipërisë, dhe se ai si anëtar i KVV-së, nuk e ka ditur se nuk do të duhej që aty të jetë i vendosur flamuri i një shteti tjetër, por ka menduar se kjo ka qenë detyrë e kryesuesit të KVV-së dhe menaxherit të Qendrës së Votimit.

Në përgjigje në ankesë, të datës 09.10.2019, B.G, ka theksuar se në zgjedhjet e datës 06.10.2019, i njëjti ka qenë në pozitën e menaxherit në Qendrën e Votimit, në Shtëpinë e Kulturës në Kishnicë, Komuna Graçanicë, duke mohuar prezencën e paraqitëses së ankesës në atë vendvotim si komisioner. Sa i përket pretendimeve ankimore lidhur me çështjen e flamujve, i njëjti ka theksuar se këto pretendime janë të pavërteta, pasi që



në atë vendvotim nuk ka pasur flamuj, duke shtuar se aty është Shtëpia e Kulturës e ansamblit vokal – instrumental “Minatori i Ri”, Kishnicë, ku ka disa fotografi të ngjitura në mur, në mesin e të cilave janë edhe fotografitë e flamujve në fjalë, pra janë fotografi me flamuj dhe jo flamuj të varur, fotografi këto të cilat ka rreth 5-6 vite që janë vendosur aty, dhe nuk ka pasur asnjëherë ankesa lidhur me vendosjen e tyre në atë vend, edhe pse edhe më herët në atë vend janë mbajtur zgjedhje, po ashtu aty janë mbajtur edhe trajnimet për vëzhgues e komisioner, dhe askush nuk ka kërkuar që ato foto të largohen nga aty. Në fund edhe një herë ka mohuar se paraqitësja e ankesës ka qenë në detyrë në atë vendvotim, por sipas të njëjtit nga informatat të cilat ai i ka marrë nga një komisioner nga N.N, me emrin Z, ka rezultuar se derisa një votuese ka votuar, të afërmit e saj e kanë fotografuar dhe tel aparati i ka zënë edhe fotot e ansamblit dhe kjo votuese e ka paraqitur ankesën. Sipas të njëjtit, atë ditë, edhe pse kanë qenë të pranishëm vëzhgues ndërkombëtar nga OSCE, monitorues të zgjedhjeve nga KQZ, askush nuk kanë dhënë vërejtje për ndonjë parregullsi, duke kërkuar nga organet kompetente që të shkojnë në vend shikim në këtë vendvotim, dhe të verifikojnë fotografitë që janë aty.

Në përgjigje në ankesë, të datës 09.10.2019, S. B, ka theksuar se fotoja me flamuj e vendosur në Shtëpinë e Kulturës në Kishnicë, aty nuk është vendosur atë ditë, por ka qenë edhe më herët.

Në konstatimet zyrtare të datës 09.10.2019, të nxjerra nga zyrtarët e PZAP-it, theksohet se përkundër përpjekjeve të tyre për të marrë në kontakt anëtarët e Këshillit të vendvotimit 3415e/01D M.Ž dhe Xh. K, nëpërmes telefonit, nuk kanë arritur të bien në kontakt me personat në fjalë, pasi që nuk kishte qasje në telefonat e tyre.

Në përgjigje në ankesë të datës 10.10.2019, subjekti politik X.X, ka theksuar në bazë të nenit 33 pika 1 e LZP-së, nuk mban përgjegjësi, por në një rast të tillë në përgjegjësi duhet të merret organizatori i zgjedhjeve, duke shtuar se meqenëse vend i vendvotimeve janë shkollat publike, duhet të merret parasysht fakti se në secilin objekt shkollor kemi vendosje të flamujve, dhe si e tillë nuk mund të përmbajë nxitje apo provokim ndaj ndonjë mase të caktuar.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj pretendimet e palëve në procedurë dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se: **Ankesa është e pa bazuar.**

## Shënim

Ankuesja në ankesë pretendon se nga ana e menaxherit të Qendrës së Votimit me numër 3415E/01D B.G, dhe kryesuesit të njëjtit, A.G, me rastin e Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, është bërë shkelje e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP) dhe Rregullës Zgjedhore Nr.11/2013 – Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, për faktin se në ditën e zgjedhjeve të 6 Tetorit 2019, në vendvotimin me numër 3415E/01D, në Kishnicë, Komuna Graçanicë, brenda vendvotimit, në mur është vendosur një pano, në të cilën ndër të tjera gjenden edhe dy flamuj, respektivisht flamuri i Republikës së Kosovës dhe ai i Republikës së Shqipërisë, e që sipas paraqitëse së ankesës, prania e një materiali të tillë, në një vendvotim, në ditën e zgjedhjeve, ka shkaktuar nxitjen e urrejtjes etnike ndërmjet votuesve.

Paneli, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore të paraqitëses së ankesës, përgjigjeve në ankesë dhe shkresave tjera të lëndës, vlerësoj se pretendimet në ankesë nuk qëndrojnë, për faktin se me dispozitën ligjore të LZP-së, respektivisht nenin 33 par.1, pika l), dhe nenin 4 par.1, pika k) të Rregullës Zgjedhore Nr. 11/2013, në të cilat dispozita përcaktohen veprimet e ndaluara të subjekteve politike, ndër të tjera ndalohen edhe veprimet të cilat mund të nxisin urrejtje kundër të tjerëve, por këto dispozita vlejnë vetëm për periudhën gjatë fushatës zgjedhore dhe jo edhe për veprimet në ditën e zgjedhjeve.

Neni 33 par.1, pika l), dhe nenin 4 par.1, pika k) të Rregullës Zgjedhore Nr. 11/2013, specifikojnë veprimet e ndaluara të subjekteve politike, gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, dhe jo veprimet e ndaluara për ditën e zgjedhjeve në një vendvotim, ndërsa pala ankuese ka paraqitur ankese për veprimet e ndodhura gjatë e ditës së votimit ndaj menaxherit, kryesuesit apo anëtarëve të Këshillit të vendvotimit.

**Parashtruesi i çështjes, Subjekti politik N.N. ka paraqitur ankesë kundër Kryesuesve dhe anëtarëve të disa këshillave të vendvotimeve në Komunën e Leposaviqit me pretendimin se gjatë ditës së votimit ka pasur shkelje dhe parregullsi, si votimi i dyfishtë, votim me letërnjoftime të skaduar të UNMIK-ut, si dhe votim me dokumente personale të Serbisë**

[Lidhur me këtë çështje PZAP-i, ka nxjerr Vendimin Anr.366/2019 të datës 10.10.2019](#)

**Faktet e Çështjes-** PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 08.10.2019, parashtruar nga subjekti politik N.N, dega në Leposaviq, për shkak të parregullsive gjatë procesit të votimit me datë 06.10.2019, në ankesë theksojnë se në vendvotimet “1203b Vracevo, 1207b/01D Joshanica, 1202 b/01r Socanica, në Komunën e Leposaviqit ka pasur shkelje gjatë procesit zgjedhor, si votimi i dyfishtë, votim me letërnjoftime të skaduar të UNMIK-ut, si dhe votim me dokumente personale të Serbisë. Ne vendvotimin e cekur “1203b Vracevo” kryesuesja e këtij vendvotimi ka qenë M.S, nga subjekti politik X.X, e cila gjatë gjithë kohës së procesit zgjedhor është sjellë në mënyrë agresive, me anëtarët e KVV-së si dhe me vëzhguesit e subjektit politik N.N.

Ne vendvotimin 1207b/01D, kryesuesi i këtij vendvotimi M.M, nga subjekti politik N.N, është fyer dhe kërcënuar nga persona të subjektit politik X.X, për shkak se kryesuesi i këtij VV i ka parandaluar të votojnë me dokumente jo valide.

Ne vendvotimin ku kryesues ka qenë D.V, nga subjekti politik N.N, janë shkelur rregullat zgjedhore ashtu qe me vetëdije të plote ka lejuar disa persona të votojnë dy here ndërsa anëtarit të KVV-së nga subjekti politik Z.Z nuk i ka lejuar qe situatën e cekur ta evidentoj në librin e ankesave.

Ne vendvotimin 1201/02R shkolla e mesme në Leposaviq, ku kryesuese ishte J.J, po ashtu kanë ndodhur parregullsi, ku të gjitha këto nga kanë qenë nga N.N ndaj subjektit politik X.X. Këto parregullsi sipas parashtruesit të ankesës, i kanë paraqitur në staciononin policor në Komunën e Leposaviqit.

Parashtruesi i ankesës ka kërkuar që në VV ku janë identifikuar vjedhjet e votave dhe janë bërë parregullsitë gjatë procesit zgjedhor të përsëriten votimet. Lidhur me parregullsitë e lartcekura parashtruesi i ankesës ka propozuar që si provë të merren ankesat të cilat janë bërë në Dhomën Operative të KQZ-së.

## Arsyetimi i Panelit – PZAP



PZAP-i, pasi që shqyrtoi afatshmërinë e ankesës gjeti se: **Ankesa është e pasafatshme**


Për të gjitha parregullsitë që mund të paraqiten në ditën e votimit, ankesa mund të paraqitet në PZAP, brenda 24 orëve nga momenti i mbylljes së Qendrës së Votimit dhe se e njëjta është paraqitur pas afatit ligjor të përcaktuar me dispozitën ligjore të nenit 119 paragrafi 1 i LZP-së ku përcaktohet se "Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-it, ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket procesit zgjedhor të rregulluar sipas këtij ligji ose rregullave zgjedhore, mund të paraqesë ankesë PZAP-it brenda 24 orëve nga momenti i mbylljes së qendrës së votimit, dhe PZAP-i, do të vendosë për ankesën brenda 72 orëve nga koha kur është pranuar ankesa", si dhe neni 5 paragrafi 3 i Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Rregullën Nr. 02/2015, ku përcaktohet: "Ankesat në lidhje me procesin zgjedhor për ditën e votimit parashtrohen pranë PZAP-it, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i mbylljes së qendrës së votimit".

Nga kjo rezulton se ankesa e lartpërmendur është dorëzuar në PZAP, pasi që ka kaluar afati ligjor për të paraqitur ankesë në PZAP, për parregullsitë në ditën e votimit sipas dispozitës së lartcekur ligjore, kjo nga fakti se afati për paraqitjen e ankesës ka qenë me datën 07.10.2019 deri në ora 19:00, ndërkaq ankuesi ankesën e tij e ka paraqitur në PZAP me datë 08.10.2019, që do të thotë se ankesa është paraqitur pas afatit ligjor të përcaktuar me dispozitën ligjore të nenit 5.3 të Rregullores Nr. 02/2015, lidhur me nenin 6 par.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.02/2015.

## Shënim

*Në rastin konkret ankesa është dorëzuar në PZAP, nga parashtruesi i ankesës me datë 08.10.2019, dhe se nga përmbajtja e ankesës rezulton se të gjitha pretendimet ankimore të paraqitura nga ankuesi ndërlidhen me procesin e votimit, në ditën e votimit me datë 06.10.2019.*

*Duke u nisur nga dispozitat e nenit 118 dhe 119 të LZP-së dhe nenin 6 par.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.02/2015, paneli vendosi që kjo ankesë të hedhet si e pasafatshme pasi që këto nene përcaktojnë ankesat për rastet të tilla duhet të paraqiten brenda brenda 24 orëve nga momenti i mbylljes së qendrës së votimit.*



Në këtë pjesë janë përzgjedhur vendimet të cilat i referohen procesit zgjedhor, të rezultatit preliminar për zgjedhjet e parakohshme të mbajtura për Kuvendin e Republikës së Kosovës të mbajtura në vitin 2019

## Parashtruesi i çështjes, Subjekti politik XX, ka parashtruar apel lidhur me numërimin e pakove në QNR, me fletëvotime të arritura me postë nga votuesit jashtë Kosovë.

[Lidhur me këtë çështje PZAP-i, ka nxjerr Vendimin Anr.375/2019 të datës 19.10.2019, si të palejuar dhe Vendimin Anr.375-2/2019 të datës 28.10.2019, si të pabazuar](#)

**Faktet e Çështjes-** Subjekti politik XX, ka paraqitur në PZAP, apelin Anr.375/2019, kundër QNR-KQZ, me të cilën theksohet se me datë 16.10.2019, rreth orës 23:00 ka përfunduar numërimi i fletëvotimeve me postë, nga qytetarët të cilën jetojnë jashtë vendit, me të cilën janë numëruar gjithsej, 13,491 fletëvotime të ardhura me 11,922 dërgesa postare. Subjekti politik, XX, pretendon se nga vëzhguesit e tyre janë informuar se edhe 4639 pako me fletëvotime të ardhura me postë nga qytetarët të cilën jetojnë jashtë Kosovës, e të cilat ende nuk kanë ardhur dhe numëruar në QNR. Më tutje ky subjekt thekson se pakot prej 4639, fletëvotimeve janë të domosdoshme të numërohen për faktin se përmes këtij numërimi realizohet vullneti i qytetareve të cilët jetojnë jashtë vendit dhe ndikon në shtimin e numrit të mandateve, të cilat do të përfaqësojnë interesat ligjore dhe Kushtetuese të më shumë qytetarëve të Republikës së Kosovës, pavarësisht se cilit subjekt politik i takojnë ato vota.

Andaj ka propozuar që PZAP, të urdhëroj KQZ, ti bartë në QNR, 4639 pako me fletëvotime për numërim, të cilat janë të dërguara me postë nga qytetarët që jetojnë jashtë Kosovës.

### Arsyetimi i Panelit – PZAP



Paneli, konstaton se pretendimet ankimore për mos numërimin e 4639 pako me fletëvotime të ardhura me postë nga qytetarët të cilën jetojnë jashtë Kosovës, e të cilat ende nuk kanë ardhur dhe numëruar në QNR, nuk mund të jetë objekt i vlerësimit në këtë fazë të procesit zgjedhor, për faktin se, KQZ-ja ende nuk ka marrë vendim lidhur me numërimin e këtyre fletëvotimeve të votuesve jashtë Kosovës, ashtu siç del edhe nga vet përgjigja në ankesë e KQZ-së e parashtruar më datën 19.10.2019. Raporti i prezantuar nga departamenti i operacioneve zgjedhore-Divizioni i shërbimit votues, lidhur me pranimin e pakove me fletëvotime nga votuesit jashtë Kosovës, ka qenë raport informues në mbledhjen e KQZ-së të datës 12.10.2019, nr.50/2019 dhe në këtë mbledhje nuk është marrë vendim nga KQZ-ja por nga departamenti i operacioneve zgjedhore- Divizioni i Shërbimeve Votues, në lidhje me rastin në fjalë, është propozuar ta zbatojë nenin 96.2 të LQP-së dhe nenit 4.4 të rregullës 03/2013.

Me qenë se në rastin konkret nga ana e KQZ-së, nuk është marrë vendim lidhur me këtë çështje juridike, prandaj paneli vlerëson se nuk është nën juridiksionin e këtij institucioni që në këtë fazë të procesit të vendosë, ngase sipas nenit 122 par.1 pikat a), b), c), d), e) dhe f) të LQP-së, PZAP-i, vendos vetëm për vendime të KQZ-së, të cilat përfshihen shprehimisht në dispozitën e sipërshtënëuar.

Në këtë rast, nga ana e KQZ-së nuk është marrë vendimi lidhur me numërimin apo refuzimin për rinumërim të 4639 pako me fletëvotime të ardhura nga votuesit jashtë vendit, andaj Paneli, vendosi të **hudhë apelin si të palejuar**.

Hudhja e apelit në këtë fazë të procedurës, mbi këtë bazë nuk cenon të drejtën e ankuesit që pas shpalljes së rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja, ta paraqes sërish apelin, nëse konsideron se i është cenuar e drejta e pretenduar, edhe pas shpalljes së rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja.

## Arsyetimi i Panelit – PZAP



Paneli, në **rishqyrtim të vendimit** pasi vlerësoi pretendimet e palëve në procedurë, provat që gjenden me shkresat e lëndës, vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna si në arsyetimin e vendimit A.A.-U.Zh.nr.19/2019, i datës 25.10.2019 të Gjykatës Supreme, sa i përket aplikimit të nenit 127 të LPK-së, por se në këtë rast Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP), është ligj special (lex specialis) në raport me Ligjin Procedurës Kontestimore, krejt kjo duke u bazuar në parimin: “Lex specialis derogat lex gjenerali” apo Ligji i veçantë e derogon ligjin e përgjithshëm, që e rregullon vetëm procesin zgjedhore, mirëpo nëse dy ligje rregullojnë situatën e njëjtë faktike, ligji që rregullon fushën specifike siç është LZP-ja, mbizotëron ndaj ligjit që rregullon vetëm çështje gjenerale (lex generalis).

Paneli në këtë rast gjeti se LZP, është ligj material juridik dhe procedural i cili në mënyrë shprehimore dhe të qartë, ka përcaktuar afatin se kur fletëvotimet duhet të arrijnë në KQZ, për t'u trajtuar si të vlefshme (ky afat është 24 orë, para ditës së zgjedhjeve siç përcaktohet me nenin 96 paragrafi 2 të LZP-së dhe neni 4 paragrafi 4 i Rregullës Zgjedhore Nr. 03/2013), dhe se në këtë rast nuk kemi të bëjmë me situata të pa përcaktuara më LZP-në dhe me Rregulla Zgjedhore, që mund të gjenin përshatshmërisht zbatim dispozitat e LPK-së.

Po ashtu në këtë rast nuk kemi të bëjmë as me parashtresa që dërgohen në një procedurë gjyqësore apo që i dërgohen gjykatës, në atë mënyrë që të gjenin zbatim dispozitat e LPK-së, por kemi të bëjmë me material të ndjeshëm, siç janë fletëvotimet që përcaktohet me Doracakun e Procedurave të Votimit dhe Numërimit për Zgjedhjet e Kuvendit të Republikës së Kosovës 2019. Prandaj në këtë rast edhe afati për pranimin e këtyre pakove me fletëvotime, është specifik në krahasim me dorëzimin e parashtresave që iu drejtohen gjykatave, për arsye se me nenin 96 paragrafi 2 i LZP-së, dhe neni 4 paragrafi 4 i Rregullës Zgjedhore Nr.3/2013, të KQZ-së, në këtë fazë të procesin zgjedhor nuk e përcaktojnë se të merret parasysh koha e dorëzimit në postë të fletëvotimit nga vendi dërgues, por e përcaktojnë se fletëvotimet duhet të arrijnë në KQZ, para zgjedhjeve, e më se largu 24 orë, para ditës së votimit.

**Andaj Apeli është i pabazuar**-kontestuese në këtë rast mbetet vetëm çështja e vlefshmërisë së këtyre pakove me fletëvotimeve, si të rregullta pasi që në KQZ, të njëjtat janë pranuar pas afatit të paraparë ligjor, për pranimin e pakove me fletëvotime nga votuesit jashtë Kosovë.

## Shënim

Paneli duke u mbështetur në disipozitat e nenit 122 par.1 pikat a), b), c), d), e) dhe f) të LZP-së, PZAP-i vendos, vetëm për vendime të KQZ-së, të cilat përfshihen shprehimisht në dispozitën e sipërhënuar, kishte konsideruar se pretendimet ankimore për mosnumërim të pakove nuk mund të ishin objekt i vlerësimit në atë fazë të procesit zgjedhor, për arsye se KQZ, nuk kishte marrë vendim, dhe për këtë arsye kishte hudhur si të palejuar apelin duke precizuar se në këtë fazë të procedurës, mbi këtë bazë nuk cenon të drejtën e ankuesit që pas shpalljes së rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja, ta paraqes sërish apelin, nëse konsideron se i është cenuar e drejta e pretenduar, edhe pas shpalljes së rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja.

Ky Vendim i PZAP-it, me numër Anr.375-2019 i datës 19.10.2019 ishte apeluar në Gjykatën Supreme të Kosovës, e cili me Aktgjykimin me nr. A.A.-U.ZH.nr.19/2019 të datës 25.10.2019 kishte Aprovuar si të bazuar apelin e subjektit XX, dhe kishte anuluar vendimin e PZAP-it, duke ia kthyer lëndën Panelit në rishqyrtim dhe rivendosje Në rishikimin e vendimit Anr.375-2/2019 i datës 28.10.2019, PZAP-i, kishte refuzuar apelin e subjektit politik XX, e pasi që pakot me fletëvotime në KQZ, ishin pranuar pas afatit të paraparë ligjor.

Ndaj këtij vendimi të PZAP-it, me numër Anr.375-2/2019, i datës 28.10.2019, subjekti politik XX, kishte parashtruar përsëri apel në Gjykatën Supreme të Kosovës, e cila me Aktgjykimin nr. A.A.-U.ZH.nr.20/2019 të datës 30.10.2019, kishte aprovuar si të bazuar apelin e subjektit XX dhe kishte ndryshuar vendimin e PZAP-it Anr.375-2/2019 të datës 28.10.2019, duke urdhëruar kështu KQZ-në që të bëjë rinumërimin e 4,639 pakove të fletëvotimeve të ardhura me postë nga qytetarët të cilët jetojnë jashtë Kosovës, si dhe të njëjtat të përfshihen në rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve.

Lidhur me vendimet e Gjykatës Supreme A.A.UZH nr.20/2019 dhe A.A.U.ZH.nr.21/2019, Koalicioni XXYY dhe ZZ, më datë 25 nëntor 2019 ka paraqitur Kërkesë në Gjykatën Kushtetuese me numër KI207/19, për Vlerësim të kushtetutshmërisë së këtyre aktvendimeve.

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës me kërkesën KI207/19, të parashtruar nga Koalicioni XX,YY dhe ZZ, **ka kontestuar** të dy Aktgjykimet e Gjykatës Supreme të Kosovës **AA-UZH nr. 20/2019 të datës 30.10.2019 dhe AA-UZH nr. 21/2019 të datës 05.11.2019.**

**Ndërsa lidhur me** vendimet e PZAP-it, Anr.375-2/2019 dhe Anr.381/2019, kishte konstatuar se janë në përputhshmëri me nenin 3 të Protokollit nr.1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në lidhje me nenin 45 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.



## Parashtruesi i çështjes, Koalicioni XX-YY-ZZ, ka parashtruar apel lidhur me numërimin e pakove me fletëvotime me vota të dorëzuara nga dy persona të pautorizuar

### Lidhur me këtë çështje PZAP-i, ka nxjerr Vendimin Anr.428/2019 të datës 10.11.2019

**Faktet e Çështjes-** Koalicioni XX-YY-ZZ, kishte paraqitur apel kundër vendimit të KQZ-së, me nr.1659-2019 të datës 07.11.2019, në të cilin thuhet se vendimi në fjalë ishte në kundërshtim me nenin 97 par. 1 dhe 2 të LZP-së, lidhur me nenet 4.3 dhe 4.4, të Rregullës Zgjedhore Nr.03/2013, sa i përket mënyrës së pranimin të Pakove të Fletëvotimeve përmes postës nga votuesit me të drejtë vote e të cilët jetojnë jashtë Kosovës, të cilat ishin dorëzuar nga dy persona të paautorizuar, në fahun postal të Kosovës, e që ato pako të fletëvotimeve **nuk posedonin vulë dhe as pullë postare të postës së origjinës.**

Kontestues është fakti i vlefshmërisë së këtyre pakove të fletëvotimeve sidomos nga aspekti i dërgimit apo pranimin të te njëjtave, përderisa në një të anën KQZ-ja, i konsideron të vlefshme, pasi thirret se ato janë dorëzuar në “fahun” e veçantë të hapur për pranimin e pakove me fletëvotime nga votuesit jashtë Kosovës, dhe janë në përputhje me praktikën e KQZ-së, që nga viti 2013, pranimi i pakove me fletëvotime në këtë mënyrë të dërguara nga Serbia. Në anën tjetër ankuesi pretendon se me rastin e pranimin të këtyre pakove me fletëvotime në këtë mënyrë nga ana e KQZ-së, është shkelur Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenin 97 paragrafi 1, pika a) dhe Rregullës Zgjedhore Nr. 03/2013 neni 4 paragrafi 3.

Pala ankuese i kishte propozuar PZAP-it, që t'i shpallte të parregullta/pavlefshme 3.782 zarfe të ardhura/bartura nga Serbia, duke kërkuar që i njëjti t'i largojë ato fletëvotime nga rezultati përfundimtar i shpallur me datë 07.11.2019.

### Arsyetimi i Panelit – PZAP



Me nenin 3 të LZP-së, janë dhënë përkufizimet për emërtimet e përdora në këtë ligj, ku votuesin jashtë Kosovës e përkufizon: “do të thotë aplikuesi i suksesshëm nga jashtë Kosovës që përdor një nga mënyrat e votimit jashtë territorit të Kosovës, siç është e saktësuar në rregullat e KQZ-së”.

Rregulla Zgjedhor Nr. 03/2013 në nenin 4 paragrafi 2, përcakton: “Pas plotësimit të fletëvotimit(eve) votuesi duhet të vendos fletëvotimit(et) në një zarf të pa shënuar e të mbyllur të vendosur brenda zarfit të jashtëm/ për dërgim. Në zarfin e dërgimit votuesi gjithashtu vendosë një fotokopje të dokumentit të tij ose saj të vlefshëm të identifikimit dhe një shënim që përmban të dhënat personale të tij ose saj, dhe që përmban së paku emrin, mbiemrin, emrin e babait dhe datën e lindjes së tij ose saj”. Ndërsa me nenin 4 paragrafi 3, i të njëjtës rregull zgjedhore përcaktohet: “Pas plotësimit të fletëvotimit për votim jashtë Kosovës votuesi duhet ta dërgoj atë me postë në një të anën nga kutitë postare që ngrihen dhe shpallen publikisht nga KQZ-ja, deri në datën që përcaktohet nga KQZ-ja”.

**Apeli është i bazuar**, Paneli, konstatoi se për tu trajtuar vlefshëm një fletëvotim nga jashtë duhet të plotësohen disa kushte: plotësimi i formularit me të dhënat e kërkuara pas shkarkimit të te njëjtit, dërgimi i të njëjtit me të dhënat e dërguara në adresën postare të “fahut postal” të shpallur publikisht nga KQZ-ja. Në rastin konkret për shkak të kontestimit të mënyrës së dërgimit, Paneli nuk do të lëshohet në aspektin e mënyrës së plotësimit apo aspekteve tjera. Pakot e fletëvotimeve nga Serbia, janë dorëzuar fizikisht drejtpërdrejt në “fahun postal” nga persona të caktuar, pra nuk kemi dërgim por dorëzim, gjë që në rastin konkret nuk është plotësuar kushti i dërgimit, pasi nuk kemi postën dërguese por vetëm atë pranuese. Duke marrë për bazë që pakot me fletëvotime kanë arritur në postën pranuese fizikisht, pa vulë të postës dërguese dhe pa pullë postare, të njëjta nuk mund të kategorizohen si fletëvotime nga jashtë dhe rrjedhimisht të tillat në bazë të rregullave në fuqi konsiderohen të pa vlefshme dhe se votimi përmes të autorizuarve apo personave të tretë në legjislacionin tonë nuk është paraparë si mundësi ligjore.

## Shënim

*Paneli, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat në këtë rast, mënyrën se si janë grumbulluar pakot me fletëvotime, mënyra e dorëzimit të tyre direkt në fahun postal të KQZ-së, nga persona të pa autorizuar, më shumë i ngjason votimit kolektiv, i cili cenon dhe minon rënd integritetin e procesit zgjedhor, e që është në kundërshtim me dispozitat ligjore, si dhe rekomandimet e Komisionit Evropian për Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecias) Kodi i Praktikës së Mirë në çështjet zgjedhore i miratuar me datë: 18-19 tetor 2002, të cilat parashohin: “Votimi me postë mund të lejohet vetëm në qoftë se shërbimi postar është i sigurt, nuk ka ndërhyrje të qëllimshme- dhe i besueshëm, në kuptimin që funksionon siç duhet, ndërsa votimi me anë të tretëve është i lejueshëm vetëm në qoftë se i nënshtrohet rregullave stërkite, përsëri me qëllim që të parandalohet mashtrimi, numri i prokurave që mund të ketë një zgjedhës duhet të jetë i kufizuar”, që do të thotë se pranimi i këtyre pakove dhe i fletëvotimeve si të rregullta nuk është as konform këtyre rekomandimeve, ndërsa votimi përmes të autorizuarve apo personave të tretë në legjislacionin tonë nuk është paraparë si mundësi ligjore.*

*Vendimi i lartcekur i PZAP-it, ishte apeluar në Gjykatën Supreme të Kosovës, nga kandidatët e subjektit politik SS për arsye se PZAP-I, kishte miratuar ankesën e Koalicionit XX-YY-ZZ, për shkak të shpalljes së pavlefshme të 3782 të pakove të fletëvotimeve të ardhura nga Serbia.*

*Gjykata Supreme e Kosovës me Aktgjykimin e saj A.A 27/2019 të datës 13.11.2019, kishte vërtetuar vendimin e PZAP-it, ku kishte refuzuar ankesën e kandidateve nga subjekti politik SS, me arsyetimin se të njëjtëve nuk ju është cenuar ndonjë e drejte ligjore dhe kushtetuese. Ndaj po të njëjtit vendim, ishte paraqitur ankesë edhe nga ana e subjektit politik XX, ku Gjykata Supreme e Kosovës me Aktvendimin A.A 29/2019 të datës 13.11.2019 ankesën e paraqitur, e kishte hedhur si të palejuar, për shkak të mungesës së interesit ligjor të palës e cila ka paraqitur ankesë, me arsyen se të njëjtës nuk ju është shkelur ndonjë e drejtë themelore, ose ndonjë e drejtë tjetër sa i përket procesit zgjedhor.*



**ZGJEDHJET E PARAKOHSHME PËR  
KUVENDIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
TË MBAJTURA NË VITIN  
2021**

Në këtë pjesë janë përzgjedhur vendimet të cilat i referohen para fushatës zgjedhore për zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të vitit 2021

**Parashtruesi i çështjes, Subjekti politik X.X, si dhe organizata joqeveritare “Y.Y”, apel kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me nr. 42-2021 i datës 11.01.2021, që ka të bëjë me Verifikimin e Aplikacioneve për Regjistrim për Periudhën e Aplikimit për Regjistrim të Votuesve Jashtë Kosove**

Lidhur me këtë çështje PZAP-i, ka nxjerr Vendimin Anr.1/2021 të datës 13.01.2021

**Faktet e Çështjes-** Subjekti politik X.X., me seli në Prishtinë, si dhe organizata joqeveritare “Y.Y” në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), kanë parashtruar apel me datën 12.01.2021 kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me nr. 42-2021 i datës 11.01.2021, që ka të bëjë me Verifikimin e Aplikacioneve për Regjistrim për Periudhën e Aplikimit për Regjistrim të Votuesve Jashtë Kosove.

PZAP-i, me datë 12.01.2021, ka pranuar apelet: Anr.1/2021 i ushtruar nga subjekti politik X.X dhe apelin Anr.2/2021, i ushtruar nga Organizata joqeveritare “Y.Y”, të cilat apele janë paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me Nr. 42-2021 i datës 11.01.2021, në të cilat pretendohet se KQZ-ja, me rastin e marrjes së vendimit të apeluar konkretisht pika 4, e vendimit të lartcekur, përcakton se “Nëse aplikuesi nuk lajmërohet në telefon, atëherë aplikacioni i tij refuzohet”. Sipas parashtruesve të apeleve, kjo mënyrë e verifikimit të aplikuesve nuk është kriter ligjor dhe vështirëson në masë të madhe procedurat ligjore deri te arritja e fletëvotimeve në Kosovë. Ky kriter shtesë nuk është në përputhje me nenin 5 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP), lidhur me nenet 22, 45, 53, 55 të Kushtetues së Republikës së Kosovës, konkretisht me të drejtën aktive të zgjedhjes, e të cilat kritere janë kundër kushtetuese dhe kundërligjore. Si të tilla nuk duhet të merren parasysh sepse cenojnë liritë dhe të drejtat themelore të shtetasve të Republikës së Kosovës. Me propozim për panelin, që apelet të pranohen si të bazuara dhe të anulohet vendimi i apeluar.

PZAP-i, apelet e parashtruara i ka hedhur si të pa lejuara për arsye se, vendimi i apeluar i KQZ-së, nuk hynë në kategorinë e vendimeve të cilat mund të apelohehen e të cilat janë të përcaktuara në mënyrë taksative në nenin 122 paragrafi 1 pikat a), b) c), d), e) dhe f), për arsye se vendimi i apeluar hynë në kategorinë e vendimeve të karakterit teknik menaxhues të KQZ-së, e i cili vendim është nxjerrë në pajtim të plotë me nenin 64 të LZP-së, e i cili vendim nuk prek apo cenon një të drejtë themelore të votuesve. Meqenëse vendimi i apeluar siç u cek më lartë hynë në kuadër të vendimeve teknike organizative, Paneli nuk u lëshua në vlerësimin meritor të çështjes, pasi vlerësoi se ky vendim nuk mund të apelohehet për arsyet e cekura më lartë dhe në pajtim me nenin 118 të LZP-së, dhe nenin 11 paragrafi 5 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.02/2015, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

## Arsyetimi i Panelit – PZAP



KQZ-ja, përmes përgjigjeve në apele, ka theksuar se me vendimin e apeluar nuk është bërë përfshirja ose largimi i një personi për të marrë pjesë në programin për votim brenda dhe jashtë Kosovës, në kuptim të nenit 122 paragrafi 1 i LZP-së, siç pretendojnë apeluesit. Me propozim për panelin, që apelet të hedhen si të palejuara.

Paneli, në kuptim të nenit 3 paragrafi 8 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ankesën Anr.2/2021 e datës 12.01.2021, vendosi ta trajtojë si apel, duke e vlerësuar se në këtë rast, trajtimi i tillë është më adekuat, ndërsa në bazë të nenit 8 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, paneli më qëllim të ekonomizimit të procedurës, ka bashkuar apelet Anr.1/2021 dhe Anr.2/2021 të datës 12.01.2021, dhe janë trajtuar si një apel, andaj procedimi i këtyre apeleve tani e tutje evidentohen, me shenjë e përbashkët Anr.1/2021, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të apeluesve.

Paneli, pasi që shqyrtoi lejueshmërinë e apeleve, gjeti se: **Apelet janë të palejueshme**

### Shënim

*Me nenin 63 paragrafi 3 i LZP-së, përcaktohet se: “Vendimi i Komisionit nuk i nënshtrohet ankesës, përveç nëse nuk parashihet qartë me këtë ligj”.*

*Me nenin 64 paragrafi 2 pika a) i LZP-së, përcaktohet se: “KQZ-ja i përgatitë dhe shpall rregullat, format dhe procedurat zgjedhore që kanë të bëjnë me zbatimin e këtij ligji dhe me çdo çështje tjetër që ka të bëjë me drejtimin e zgjedhjeve në kuadër të kompetencës së saj”, ndërsa me pikën b) të këtij neni përcaktohet se: “KQZ-ja, i publikon të gjitha rregullat e miratuara, udhëzimet dhe procedurat zgjedhore dhe i bënë ato të arritshme për opinionin”.*

*Apelimet zgjedhore ndaj vendimeve të KQZ-së, në PZAP, janë përcaktuar me nenin 122 paragrafi 1 pikat: a) b) c) d) e) dhe f) të LZP-së, në të cilat përcaktohet se: a) Përfshirjen ose largimin e një personi për të marrë pjesë në programin votues brenda dhe jashtë Kosovës; b) Certifikimin ose kundërshtimin për të certifikuar një subjekt politik ose kandidat për të marrë pjesë në zgjedhje; c) Kandidati i cili pas certifikimit nuk dëshiron të marrë pjesë në zgjedhje; d) akreditimin ose refuzimin për akreditim të një vëzhguesi zgjedhor; e) vendosjen e një gjobe administrative ndaj një subjekti politik sipas nenit 42 të këtij ligji dhe f) Refuzimin për të regjistruar një parti politike brenda Zyrës.*

*Nga interpretimi i dispozitave të lartcekura rezulton se vendimet e KQZ-së, nuk janë të apelueshme përveç nëse parashihen qartë më ligj. Në këtë rast vendimi i apeluar i KQZ-së, nuk hynë në kategorinë e vendimeve të cilat mund të apelojnë e të cilat janë të përcaktuara në mënyrë taksative në nenin 122 paragrafi 1 pikat a), b) c), d), e) dhe f), për arsye se vendimi i apeluar hynë në kategorinë e vendimeve të karakterit teknik menaxhues të KQZ-së, e i cili vendim është nxjerrë në pajtim të plotë me nenin 64 të LZP-së, e i cili vendim nuk prek apo cenon një të drejtë themelore të votuesve.*

*Ky Vendim i PZAP-it, me numër Anr.1-2021 i datës 13.01.2021 ishte apeluar në Gjykatën Supreme të Kosovës, e cili me Aktvendimin me nr.A.A.nr.1/2021 të datës 18.01.2021 kishte Hudhur poshtë si e palejuar apelin e Organizatës Joqeveritare “Y.Y” dhe ka vërtetuar vendimin e PZAP-it, Anr.1-2021.*

## Parashtruesi i çështjes, Votuesi A.R, me vendbanim nga Anglia, apel kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), nr.419-2021 i datës 02.02.2021 lidhur me mos përfshirjen në listën përfundimtare të votuesve jashtë Kosovës, për përfshirjen e Votuesve të Aprovuar në listën përfundimtare të votuesve jashtë Kosove, me të cilin është refuzuar aplikacioni i tij që të përfshihet në këtë listë

[Lidhur me këtë çështje PZAP-i, ka nxjerr Vendimin Anr.19/2021 të datës 05.02.2021](#)

**Faktet e Çështjes-** Votuesi A.R, me vendbanim nga Anglia, në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), ka parashtruar apel kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve(KQZ), me nr.419-2021 i datës 02.02.2021 lidhur me mos përfshirjen në listën përfundimtare të votuesve jashtë Kosovës, për përfshirjen e Votuesve të Aprovuar në listën përfundimtare të votuesve jashtë Kosove, me të cilin është refuzuar aplikacioni i tij që të përfshihet në këtë listë, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të mbajtura më datë 14 Shkurt 2021.

Më PZAP-i, ka pranuar një apel nga A.R kundër vendimit të KQZ-së Nr. 419-2021 i datës 02.02.2021 për Përfshirjen e Votuesve të Aprovuar në Listën Përfundimtare të Votuesve Jashtë Vendi për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës 2021, me të cilin është refuzuar aplikacioni i tij që të përfshihet në Listën e Votuesve Jashtë Kosovë.

PZAP-i, apelin e parashtruar nga votuesi A.R, me vendbanim në Angli e aprovoi si të bazuar, dhe i njëjti konstatoi se provat e bashkangjitura nga parashtruesi i apelit janë dëshmi të mjaftueshme për të vërtetuar se i njëjti në kuptim të nenit 5.1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme/Lokale (LZP), i plotëson kushtet për tu regjistruar në Listën e Votuesve Jashtë Kosovës, andaj në bazë të nenit 118.1 të LZP-së lidhur me nenin 10.7 të Rregullës Zgjedhore nr. 2/2015, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### Arsyetimi i Panelit – PZAP



Paneli pasi që shqyrtoi apelin konstatoi: **Apeli është i bazuar**

### Shënim

*Paneli, konstatoi se provat e bashkangjitura nga parashtruesi i apelit janë dëshmi të mjaftueshme për të vërtetuar se i njëjti në kuptim të nenit 5.1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme/Lokale (LZP), i plotëson kushtet për tu regjistruar në Listën e Votuesve Jashtë Kosovës, prandaj në bazë të nenit 118.1 të LZP-së lidhur me nenin 10.7 të Rregullës Zgjedhore nr. 2/2015, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.*

## Parashtruesi i çështjes, Subjekti politik X.X, e përfaqësuar nga D.B, me seli në Prizren, apel kundër vendimit të KQZ, me nr.225/2021 të datës 22.01.2021 për certifikimin e kandidatit E.N në listën e kandidatit të subjektit Y.Y, me seli në Prizren

### Lidhur me këtë çështje PZAP-i, ka nxjerr Vendimin Anr.14/2021 të datës 23.01.2021

**Faktet e Çështjes-** Subjekti politik X.X. e përfaqësuar nga D.B, me seli në Prizren, ka parashtruar apel në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), kundër vendimit të KQZ-së, me nr.225/2021 të datës 22.01.2021 për certifikimin e kandidatit E.N në listën e kandidatit të subjektit Y.Y, me seli në Prizren, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 14 shkurt 2021.

PZAP-i, apelin e parashtruar e aprovoi si pjesërisht të bazuar, dhe i njëjti ka konstatuar se nuk është në harmoni të plotë me nenin 111 par.1 të LQP-së, me të cilën përcaktohet se vendet në Kuvend ndahen sipas sistemit të përfaqësimit të caktuar nga neni 64 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, prandaj paneli ka vlerësuar se në momentin kur një subjekt politik që garon për zgjedhje për vendet e rezervuara, për përfaqësim të komuniteteve në Kuvendin e Kosovës, fillimisht specifikohet se cilit komunitet i takon subjekti politik që garon në zgjedhje dhe se subjekti në fjalë, ka qenë i njoftuar me procedurën, sepse rrjedhimisht kandidatët në listën e subjektit politik do të duhej të deklarohen me rastin e aplikimit për certifikim se garojnë për vendet e garantuar dhe duhet të jetë nga komuniteti jo shqiptar. Mbi këtë bazë paneli ka vlerësuar se KQZ- me vendimin Nr.225/2021 të dt.22.01.2021, nuk ka vepruar drejt se rastin e certifikimit të listës së subjektit politik Y.Y, në mesin e të cilit është edhe kandidati E.N, me numër .. i cili ka kandiduar në kuadër të këtij subjekti politik Y.Y, për Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 14.02.2021, për vendet e garantuar, të cilat vendet si me nenin 64 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ashtu edhe me nenin 111 par. 1 të LQP-së, janë vende ekskluzivisht të garantuara për komunitet në Republikën e Kosovës, jo për komunitetin shqiptar, për këtë arsye dhe bazuar në dispozitat e lartcekura ligjore, nga arsyet e lart cekura konform nenit 118 par.1 dhe nenit 122 të LPZ-së, u vendos si në dispozitivin të këtij vendimi.

### Arsyetimi i Panelit – PZAP



PZAP-i më datën 23.01.2021 i ka dërguar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) kërkesën për përgjigje në ankesë. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka dërguar përgjigjen në ankesë më datën 24.01.2021, në të cilën theksohet se sipas LQP-së, në nenet 15, 25 dhe 26, Rregullës zgjedhore Nr. 08/2013 Certifikimi i subjekteve politike dhe kandidatëve të tyre, në nenet 3, 4 dhe 5 si dhe Rregullës zgjedhore Nr. 15/2013 për zgjedhjet e jashtëzakonshme dhe zgjedhjet e parakohshme në nenin 3, si dhe planit operacional të miratuar nga KQZ për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më 14 shkurt 2021, subjektet politike duhet plotësuar kushtet e parapara. Pas kontrollimit të dokumentacionit në kuadër të obligimeve ligjore,

Zyra ka bërë verifikimin e dokumentacionit sipas listës së mësipërme (Përveç përkatësisë etnike të kandidatëve nga pamundësia e krahasimit të tyre me data bazën e regjistrimit civil pasi që përkatësia etnike nuk ceket në asnjë dokument) si dhe kualifikimin sipas nenit 29 të LZP-së. Pas verifikimeve të nevojshme Zyra rekomandoi certifikimin e të gjithë kandidatëve të subjektit politik Y.Y sipas listës së bashkangjitur si Shtojca 1 e kësaj përgjigjeje. Më tutje në përgjigjeje në ankesë thuhet se jemi njoftuar nga subjekti politik X.X që një kandidat i certifikuar i listës së kandidatëve të subjektit politik Y.Y gjegjësisht E. N më numër rendor 12 në listën e kandidateve të Y.Y edhe pse garon për ulëset e garantuara të komunitetit boshnjak ai gjithmonë është deklaruar si pjesëtar i komunitetit shumicë shqiptar. Zyra ka orientuar X.X që ankesat për kandidatet e certifikuar shqyrtohen nga PZAP. Në përgjigjeje në ankesë të KQZ-së, theksohet se verifikimi i përkatësisë etnike të listës së kandidatëve për deputet të subjekteve politike që garojnë për ulëse të garantuara në Kuvendin e Republikës së Kosovës nuk është kërkesë e specifikuar as në LZP e as në rregullat zgjedhore të KQZ-së, pra përkatësia etnike bazohet në deklarinimin e subjektit politik në formularin e aplikimit i cili në këtë rast përputhet me të dhënat me rastin e regjistrimit si parti politike. Zyra nuk ka njohuri për ndonjë data bazë të shtetasve të Kosovës e cila do të përmbante edhe përkatësin etnike të qytetarëve dhe për ekzistencën e ndonjë institucioni të Kosovës i cili do të mund të lëshoj ndonjë certifikate të përkatësisë etnike.

Paneli pas shqyrtimit të shkresave të lendes gjeti se: **Apeli është pjesërisht i bazuar**

## Shënim

Paneli i PZAP-it, vlerëson ligjshmërinë e vendimit të KQZ-së, Nr. 225/2021 të datës 22.01.2021, dhe konstaton se i njëjti nuk është në harmoni të plotë me nenin 111 par.1 të LZP-së, në të cilin përcaktohet se: “Vendet në Kuvend ndahen sipas sistemit të përfaqësimit të caktuar nga neni 64 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke ndarë:

a) njëqind (100) vende midis të gjitha subjekteve politike të certifikuara në raport me numrin e votave të vlefshme që kanë marrë ato; dhe

b) njëzet (20) vende janë të garantuara për përfaqësimin e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë, si vijon:

(i) partitë, koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët e pavarur, të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetin serb, do të kenë numrin e vendeve në Kuvend të fituar në zgjedhjet e hapura, me minimumin dhjetë (10) vende të garantuara, në rast se numri i vendeve të fituara është më i vogël se dhjetë (10); (ii) partitë, koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët e pavarur, të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetet e tjera, në Kuvend do të kenë numrin e vendeve të fituara në zgjedhjet e hapura me minimumin e vendeve të garantuara si në vijim: komuniteti rom një (1) vend; komuniteti ashkali një (1) vend; komuniteti egjiptian një (1) vend; dhe një (1) vend shtesë i jepet komunitetit rom, ashkali, ose egjiptian, që ka numrin më të madh të votave të përgjithshme; komuniteti boshnjak tri (3) vende, komuniteti turk dy (2) vende dhe komuniteti goran një (1) vend, nëse numri i vendeve të fituara nga secili komunitet është më i vogël se numri i vendeve të garantuara”.



Prandaj paneli vlerëson se në momentin kur një subjekt politik që garon në zgjedhje, për vendet e rezervuara, për përfaqësim të komuniteteve në Kuvendin e Kosovës, fillimisht specifikohet se cilit komunitet i takon subjekti politik që garon në zgjedhje dhe nëse subjekti politik dëshiron të garoj për vendet e garantuara në Kuvendin e Kosovës, është i njoftuar paraprakisht, me dispozitën e lart cituar ligjore dhe po ashtu në këtë rast është njoftuar nga KQZ-ja, me procedurën e aplikimit për regjistrim-certifikim, e cila potencohet edhe në përgjigjen e KQZ-së, se subjekti Y.Y, ka qenë i njoftuar me procedurën, sepse rrjedhimisht kandidatët në listën e subjektit politik do të duhej të deklarohen me rastin e aplikimit për certifikim se garojnë për vendet e garantuar dhe duhet të jenë nga komuniteti jo shqiptar, pasi që në rastin konkret kemi të bëjmë me subjektin politik Y.Y, që garon në zgjedhjet e datës 14.02.2021, për vendet e garantuara, për komunitetet jo shumicë në Kosovë.

Mbi këtë bazë paneli vlerësoi se KQZ me vendimin Nr. 225/2021 të datës 22.01.2021, nuk ka vepruar drejt me rastin e certifikimit të listës së subjektit politik Y.Y, në mesin e të cilës është edhe kandidati E.N, me numër 12 i cili garon në kuadër të subjektit politik Y.Y, për Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 14.02.2021, për vendet e garantuar, të cilat vendet si me nenin 64 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ashtu edhe me nenin 111 par. 1 të LZP-së, janë vende ekskluzivisht të garantuara për komunitet në Republikën e Kosovës, jo për komunitetin shqiptar, për këtë arsye dhe bazuar në dispozitat e lartcekura ligjore, të gjitha subjektet politike që garojnë në zgjedhje për Kuvend të Republikës së Kosovës, për vendet e garantuara do të duhej që në listat e tyre për kandidat, për deputet të jenë vetëm nga komuniteti që i përket subjekti politik me arsyen se kandidatet nga komunitet më për se drejti i përfaqësoj interesat e bashkëkombësve të tyre sepse shumë me mirë i njohin problematikën e komunitetit, pjesëtare të së cilës janë edhe ata vetë e jo nga komuniteti shqiptar, që në rastin konkret subjekti politik Y.Y, nuk ka vepruar konform dispozitave të lart theksuar dhe procedurave për aplikim të një subjekti politik që garon në zgjedhje për vendet e garantuar në Kuvend të Republikës së Kosovës, ku në mesin e kandidatëve për deputet ka propozuar për certifikim në KQZ, edhe kandidat për deputet nga komunitetit shumicë-shqiptar në vend.

Ky Vendim i PZAP-it, me numër Anr.14-2021 i datës 25.01.2021 ishte apeluar në Gjykatën Supreme të Kosovës, e cili me Aktgjykimin me nr.A.A.nr.6/2021 të datës 28.01.2021 kishte Refuzuar si të pabazuar apelin e subjektit XX, përfaqësuar nga E.N dhe ka vërtetuar vendimin e PZAP-it, Anr.6-2021.

## Parashtruesi i çështjes, Subjekti politik X.X, apelet Anr.5/2021, Anr.6/2021 dhe Anr7/2021 kundër vendimit të KQZ-së, me numër 241-2021 i datës 22.01.2021 për shkak të mos certifikimit të listës së kandidatëve

### Lidhur me këtë çështje PZAP-i, ka nxjerr Vendimin Anr.5/2021, të datës 25.01.2021

**Faktet e Çështjes-** Subjekti politik X.X., me seli në Lipjan, në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), ka parashtruar apelet Anr.5/2021, Anr.6/2021 dhe Anr7/2021 kundër vendimit të KQZ-së, me numër 241-2021 i datës 22.01.2021 për shkak të mos certifikimit të listës së kandidatëve për të garuar në Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 14 shkurt 2021.

Apelet e parashtruara nga subjekti politik X.X, me seli në Lipjan dhe nga dy kandidatët për deputet në Kuvendin e Kosovës, A.A dhe Q. Rr , paneli i refuzoi pjesërisht, dhe i njëjti sipas vlerësimit ka konstatuar se vendimi i apeluar i KQZ-së, është në kundërshtim me nenin 29 par 1 pika q) të LQP-së.

Andaj kjo rrjedhë se asnjëri nga këta kandidat nuk është i përshtatshëm konform nenit 29 par.1 germa q) të LQP-së, dhe rrjedhimisht kjo përbën ndalesë për certifikim të këtyre kandidatëve, andaj për këto rrethana është vendosur si në pikën I, të dispozitivit të këtij vendimi dhe kandidatët në fjalë me të cilën nuk certifikohen si në pikën I të këtij dispozitivi nuk ka kaluar afatin trevjeçar siç është përcaktuar me nenin 29 paragrafi 1 pika q) e LQP-së. Paneli, vendosi si në pikën II, të dispozitivit të këtij vendimi për arsye se pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, rezultoi se kandidatët për deputet sipas listës së propozuar nga parashtruesi i apelit për certifikim, i plotësojnë të gjitha kushtet ligjore dhe janë të përshtatshëm për certifikim pasi që të njëjtit nuk kanë ndalesa ligjore për certifikim siç përcaktohet me nenin 29 të LQP-së dhe me aktgjykimin e lartcekur të Gjykatës Kushtetuese, andaj nga arsyet e theksuara më lart si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 117 par.3, 118 par.1, 122 par.1 pika b) të LQP-së, si dhe nenit 11 par.6 të Rregullës Nr.02/15 të PZAP-it, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### Arsyetimi i Panelit – PZAP



Paneli, në bazë të nenit 8 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ka bashkuar apelet Anr.5/2021, Anr.6/2021 dhe Anr.7/2021 të datës 23.01.2021, dhe janë trajtuar si një apel, andaj procedimi i këtyre apeleve tani e tutje evidentohen, me shenjë e përbashkët Anr.5/2021, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të apeluesve.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve dhe vlerësimit të provave veç e veç në kuptim të nenit 117.3 të LQP-së, gjeti se: **Apelet janë pjesërisht të bazuara**

## Shënim

Sipas vlerësimit të PZAP-së, vendimi i apeluar i KQZ-së, është në kundërshtim me nenin 29 par. 1 pika q) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë, i cili përcakton: “Cili do person, emri i të cilit paraqitet në Listën e Votuesve, është i aftë për certifikim, përveç nëse personi është shpallur fajtor për vepër penale me një vendim përfundimtar të gjykatës në tri (3) vitet e fundit”, për shkak se shumica dërmuese e kandidatëve në listën e refuzuar të KQZ-së, nuk hyjnë në kategorinë e personave të pa përshtatshëm sipas nenit 29 të LZP-së.

Paneli, vlerëson se rekomandimi i ZRPPC-së, ka qenë në kundërshtim me nenin 29 të LZP-së, dhe po ashtu në kundërshtim me shkresat e lëndës me rastin e verifikimit të kandidatëve veç e veç, për shkak se nga shkresat mbi verifikimin e kandidatëve, shumica e kandidatëve, nuk kanë pasur ndonjë pengesë në kuptim të dispozitës së lartcekur për certifikim.

Përkundër verifikimit nga ana e KGJK-së bazuar në kërkesën e ZRPPC-së dhe gjetjeve si ne përgjigjen e KGJK-se, ZRPPC-ja hedh dyshime në saktësinë e të dhënave të përfshira në këtë përgjigje, e qe kjo bie në kundërshtim me nenin 329 paragrafi 1 i LPK-se, me të cilin përcaktohet: “Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të.”

Rekomandimi i ZRPPC-së, po ashtu ka qenë në kundërshtim me pikën -II-, të dispozitivit të Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Veprimet verifikuese dhe hetuese të ZRPPC-së, kanë qenë në përputhje me nenin 26 të LZP-së, mirëpo rekomandimi nuk ka qenë në përputhje me dispozitat ligjore të LZP-së, për arsye se:

Me nenin 26 paragrafi 1 i LZP-së, përcaktohet se: “Zyra i bën një rekomandim të shkruar KQZ-së për ose kundër certifikimit të secilës listë të kandidatëve të pranuar jo më vonë se pesë (5) ditë pune pas afatit për dorëzim të listave”.

Me nenin 26 paragrafi 3 i LZP-së, përcaktohet se: “Nëse Zyra vendos që lista e kandidatëve nuk përmbush dispozitën e mësipërme, në atë rast e njofton subjektin politik në fjalë që të korrigjojë listën e kandidatëve në periudhën brenda pesë (5) ditëve të punës, duke dhënë arsyetimin/et/se përse lista e tyre duhet korrigjuar”.

Pretendimet ankimore të parashtruesit të apelit, se me rastin e marrjes së vendimit të apeluar, lidhur me mos certifikimin e listës së kandidatëve për deputet të parashtruesit të apelit për zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës, është shkelur e drejta e garantuar me Kushtetutë. Paneli, vlerëson se pretendimet e parashtruesit të apelit janë të paqëndrueshme dhe të pabazuara në ligj, sepse neni 29 par.1 pika q) i LZP-së, përcakton se: “Cili do person, emri i të cilit paraqitet në Listën e Votuesve, është i përshtatshëm për certifikim, përveç nëse personi është shpallur fajtor për vepër penale me një vendim përfundimtar të gjykatës në tri (3) vitet e fundit”, siç edhe është në rastin konkret andaj është vendosur si në pikën -I-, të dispozitivit të këtij vendimi, duke u mbështetur edhe në aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së

Kosovës KO95/2020 i datës 06.01.2021, në të cilin në pikën -II-, të dispozitivit është vendosur që në bazë të nenit 71.1 të Kushtetutës, në ndërlidhje me nenin 29.1 germa q) të LZP-së, personi i dënuar për vepër penale me një vendim gjyqësor të formës së prerë në tri vitet e fundit nuk mund të jetë kandidatë për deputet, e as të fitoj mandat të vlefshëm në Kuvendin e Republikës së Kosovës, i cili aktgjykim është i detyrueshëm për zbatim, për të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës, siç përcaktohet me nenin 116.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Lidhur me pretendimet se kandidatët si në pikën -I-, të dispozitivit të këtij vendimi, nuk u është shqiptuar dënim që krijon pasoja sipas dispozitave të Kodit Penal, Paneli vlerëson se dispozita nga neni 29 par. 1 pika q) të LZP-së, nuk kërkon që të ketë pasoj juridike në raport me llojin e sanksionit penal. Në këtë kontekst edhe rrethanat tjera të nenit 29 të LZP-së, mundësojnë kufizimin e certifikimit madje jo vetëm kur kandidati ka një vendim penal të formës së prerë, mbi dënimin e tij, por edhe kur ekziston nën akuzë nga tribunali, siç është pika n), të nenit 29 të LZP-së, çka rezulton se qëllimi i kësaj dispozite ligjore nuk është për pasojat juridike që mund të ketë natyra e sanksionit penal të shqiptuar për vepër penale, por përfshin një mori situatash kur një kandidat për deputet nuk është i përshtatshëm për certifikim.

Paneli, i vlerësoi se në këtë rast Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP), është ligj special (lex specialis) në raport me Kodin Penal, krejt kjo duke u bazuar në parimin: "Lex specialis derogat lex generali" apo Ligji i veçantë e derogon ligjin e përgjithshëm, që e rregullon vetëm procesin zgjedhor, mirëpo nëse dy ligje rregullojnë situatën e njëjtë faktike, ligji që rregullon fushën specifike siç është LZP-ja, mbizotëron ndaj ligjit që rregullon vetëm çështje gjenerale (lex generalis). Në kuptim të kësaj Paneli, vlerëson se në këtë rast Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, është ligj material juridik dhe procedural i cili në mënyrë shprehimore dhe të qartë në nenin 29 paragrafi 1 pikat a), b), c), d), e), f), g), h), i), j), k), l), m), n), o), p), q), r) dhe pika s) përcaktojnë përshtatshmërinë/aftësinë e kandidatëve për tu certifikuar, në këtë rast kandidatët e cekur si në pikën -I-, të dispozitivit të këtij vendimi siç u arsyetua edhe më lart, nuk janë të përshtatshëm për tu certifikuar si kandidatë për deputet për shkak se janë në kundërshtim me pikën q) të dispozitës së lartcekur dhe me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës KO95/2020 i datës 06.01.2021.

Siç rezulton nga shkresat e lëndës, nga verifikimet e bëra nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, kandidatët e propozuar në listën e subjektit politik X.X, A. A me aktgjykimin P.nr.3814/2016 i dt. 22.01.2018 i cili ka marr formën e prerë më datën 22 Janar 2018, është shpallur penalisht fajtor, Q. Rr. sipas Aktgjykimit të plotfuqishëm PKR.nr 333/2017 të datës 09.11.2018 dhe PKR 140/2016 të datës 27.04.2018 është shpallur fajtor, më tutje, F. B është i shpallur fajtor për vepër penale më Aktgjykim të plotfuqishëm P.nr.1564/2017 të datës 26.01.2018 dhe F. P është i shpallur fajtor më Aktgjykim të plotfuqishëm nr.205/2018 i datës 13.12.2018, të gjithë këta të dënuar nga gjykatat e vendit. Nga kjo rrjedhë se asnjëri nga këta kandidat nuk është i përshtatshëm konform nenit 29 par. 1 germa q) të LZP-së, dhe rrjedhimisht kjo përben ndalesë për certifikim të këtyre kandidatëve, andaj për këto rrethana edhe është vendosur si në pikën -I-, të dispozitivit të këtij vendimi. Ndërsa afati tre vjeçar siç është përcaktuar me nenin 29 paragrafi 1 pika q) i LZP-së, në këtë rast është llogaritur duke ju

referuar datës së aktgjykimit penal të formës së prerë për secilin kandidat veç e veç e deri në ditën e shpalljes së zgjedhjeve me datë 06.01.2021, si ditë përfundimtare për të vlerësuar afatin tre vjeçar, për përshtatshmërinë e kandidatëve në kuptim të dispozitës të lart cekur. Në këtë rast të gjithë kandidatët e mos certifikuar si në pikën - I-, të dispozitivit të këtij vendimi nuk kanë kaluar afatin e lartpërmendur tre vjeçar, siç përcaktohet me dispozitën e lartcekur.


Paneli, vendosi si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi për arsye se nga shqyrtimi i shkresave të lëndës, rezulton se kandidatët për deputet sipas listës së propozuar nga parashtruesi i apelit për certifikim, i plotësojnë të gjitha kushtet ligjore dhe janë të përshtatshëm për certifikim, pasi që te njëjtit nuk kanë ndalesa ligjore për certifikim siç përcaktohet me nenin 29 të LZP-së dhe me aktgjykimin e lartcekur të Gjykatës Kushtetuese.

Përveç tjerash Paneli, vlerëson se dispozita ligjore e nenit 29 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme me vendimin e Gjykatës Kushtetuese është fuqizuar në atë masë sa që tani një dispozitë e tillë rangohet në normë kushtetuese apo standard kushtetues, e cila dispozitë mbizotëron në raport me të gjitha dispozitat tjera që i referohen përshtatshmërisë apo pengesave në certifikim të kandidatëve për deputet.

Paneli, vendosi si në pikën -III-, të dispozitivit të këtij vendimi, ngase mundësinë për zëvendësimin e kandidatëve brenda listës që nuk ishin të përshtatshëm me nenin 29 par. 1 pika q) të LZP-së, parashtruesi i apelit nuk e kishte shfrytëzuar edhe pse nuk është kontestuese për Panelin dhe palët në procedurë, se kjo mundësi iu ka dhënë parashtruesit të apelit sipas parashtrësës së dërguar me postë elektronike me datë 20.01.2021, mirëpo nuk i ka bërë zëvendësimet brenda afatit të caktuar nga ZRPPC, -ja, i cili afat për zëvendësim ishte deri me datë 21.01.2021 në ora 13:00.

Paneli, me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet sipas apelit mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ky Vendim i PZAP-it, me numër Anr.5-2021 i datës 25.01.2021 ishte apeluar në Gjykatën Supreme të Kosovës, e cili me Aktgjykimin me nr.A.A.2/2021 të datës 28.01.2021 kishte Refuzuar si të pabazuar apelin e subjektit XX, përfaqësuar nga Q. Rr dhe ka vërtetuar vendimin e PZAP-it, Anr.5-2021.



Në këtë pjesë janë përzgjedhur vendimet të cilat i referohen fushatës zgjedhore për zgjedhjet e parakohshme të vitit 2021 të mbajtura për Kuvendin e Republikës së Kosovës

## Parashtruesi, A.A ka paraqitur ankesë kundër subjektit politik N.N, për shkak të përdorimit të gjuhës denigruese dhe nxitëse ndaj kandidatëve të subjekteve tjera politike

Lidhur me këtë çështje PZAP-i, ka nxjerr Vendimin Anr.351/2021 të datës 11.02.2021

**Faktet e Çështjes-** A.A, në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), ka paraqitur ankesë kundër subjektit politik N.N për shkak të përdorimit të gjuhës denigruese dhe nxitëse ndaj kandidatëve të subjekteve tjera politike, me qëllim të përfutimit elektoral, në fushatë zgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura me datë 14.02.2021.

Me datë 08.02.2021 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga A.A, me seli në Prishtinë, me të cilën pretendon se nga fillimi i fushatës zgjedhore në Kosovë me data të ndryshme është transmetuar në televizionet kombëtare një spot publicitar nga N.N, në të cilin spot është paraqitur gjuhë të urrejtjes për një kandidat për deputet nga një subjekt tjetër politik, veprime këto të cilat sipas parashtruesit të ankesës janë në kundërshtim me nenin 33 paragrafi 1 pika l, te Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Rregullës Zgjedhore nr. 11/2013 neni 4 paragrafi 1 pika k). Parashtruesi i ankesës pretendon se me këto veprime përmes video spotit publicitar subjekti politik N.N, ka nxitur urrejtje për një kandidat duke e kualifikuar atë si antikombëtar dhe person që ka fyer viktimat e luftës se fundit me qëllim të denigrimit të imazhit të tij në këto zgjedhje. Andaj sipas parashtruesit të ankesës paraqitja e një spoti të tillë me gjuhë të urrejtjes duke përmendur edhe viktimat e luftës mund të ndikoj drejtpërdrejt në provokimin e dhunës kundrejt kandidatit për deputet, e ndërsa qëllimi i këtij ligji dhe kodit të mirësjelljes se subjekteve politike është krijimi i kushteve në të cilat populli i Kosovës mund të zgjedhë përfaqësuesit e tij përmes zgjedhjeve të lira, të drejta dhe të mirë informuara në një atmosferë të tolerancës demokratike, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit. Andaj bazuar në atë që u theksua me sipër i njëjti konsideron se subjekti politik në fjalë ka bërë shkelje të dispozitave ligjore në fuqi dhe si dëshmi për pretendimet e tij, ankesës i ka bashkangjitur një CD.

PZAP-i, duke u mbështetur në dispozitën e nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së **ankesën e parashtruar e miratoi si të bazuar**, sepse nga provat e ofruara dhe shkresat e tjera të lëndës, shihet qartë se nga ana e subjektit politik N.N, është shkelur dispozita e nenit 33 pika l), e LZP-së, ngase gjuha e përdorur në videon e dërguar si provë nga ankuesi është gjuhë linquese, denigruese dhe fyese, përmes së cilës haptas bëhet thirrje për mos votim të subjektit politik X.X, dhe kandidatit të saj E.H, apo bojkotim të këtij subjekti, por njëkohësisht mesazhi i shprehur përmes kësaj gjuhe, cenon rëndë klimën demokratike të procesit zgjedhor gjatë fushatës zgjedhore dhe një linqim i tillë cenon edhe sigurinë e personit ndaj të cilit adresohet, përveç kësaj një veprim i tillë sanksionohet edhe me nenin 5 paragrafi 1 pika d) i Rregullës Zgjedhore Nr.13/2013, ku parashihet se subjektet e certifikuara politike aktivitetet e tyre zgjedhore duhet t'i bëjnë në pajtueshmëri me Rregullat zgjedhore të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ).

## Arsyetimi i Panelit – PZAP



Në përgjigjen në ankesë të datës 02.10.2021, subjekti politik N.N, thekson se sa i përket pretendimeve të parashtruesit të ankesës konstaton se me përgjegjësi të plotë se nuk e ka bërë emetimin edhe as nuk ka kërkuar emetimin e kësaj video ashtu siç pretendohen nga A.A, në asnjë televizion kombëtar, media online apo TV tjera nuk ka kërkuar nga to një veprim të tillë të transmetimit të kësaj video. Te njëjtit theksojnë se kjo video e bashkangjitur si prove nga A.A, nuk është transmetuar asnjëherë si spot elektorale në hapësirat reklamuese në mediat kombëtare nga ana e subjektit politik N.N. Ndërsa lidhur me pretendimet e ankuesit për shkeljen e nenit 33 të LZP-së, dhe të Rregullës Zgjedhore 11/2013 i njëjti në përgjigjen e tij thekson se subjekti politik N.N, nuk ka pasur e as qe ka për qëllim të nxisë tjetrin apo të provokoj dhune ndaj dikujt sa i përket fushatës zgjedhore.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se: [Ankesa është e bazuar](#)

### Shënim

*Paneli, pas shikimit të bërë të CD-së, nga përmbajtja e të njëjtës pa mëdyshje vërtetohet se incizimi është bërë në emër të subjektit politik N.N, dhe kundër subjektit politik X.X, respektivisht kandidatit për kryeministër nga ky subjekt E.H.*

*Gjuha e përdorur në videon e dërguar si provë nga ankuesi është gjuhë linçuese, denigruese dhe fyese, përmes së cilës haptas bëhet thirrje për mos votim të subjektit politik X.X, dhe kandidatit të saj E.H, apo bojkotim të këtij subjekti, por njëkohësisht mesazhi i shprehur përmes kësaj gjuhe, cenon rëndë klimën demokratike të procesit zgjedhor gjatë fushatës zgjedhore dhe një linçim i tillë cenon edhe sigurinë e personit ndaj të cilit adresohet.*

*Legjislacioni aktual zgjedhor në mënyrë shprehimore ka ndaluar të bërit fushatë përmes gjuhës e cila nxit urrejtje ndaj të tjerëve nga cilado bazë, etnike, ideologjike, fetare, armiqësore etj. Tendenca për të shfaqur elemente patriotike duke sulmuar figura politike dhe duke aluduar në krahasimet e mendimeve të tyre shkencore me qëndrime të personaliteteve kontroverze, përveç që fare s'ka të bëjë me aspekt të fushatës zgjedhore, cenon rëndë klimën demokratike të garës elektorale, gjë që do të duhej të bëhej në suaza të garës programore.*

*Paneli, në kuptim të te lartcekurave nuk merret me vlerësime të qëndrimeve të personaliteteve të shprehura në aspekte shkencore, pasi kjo nuk bie në mandatin e tij të shqyrtimit, për arsye se ekzistojnë organe kompetente të cilat merren me vlerësime të gjuhës së shprehur shkencore qoftë në libra, televizione, radio apo forma tjera të të shprehurit në aspekt shkencor, mirëpo PZAP-i, në mandatin e tij sigurohet në garantimin e integriteti zgjedhor.*



Përdorimi i një gjuhe të tillë është në kundërshtim me nenin 33 pika l), e LZP-së, me të cilën përcaktohet: “Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: ... l) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve”.

Përveç kësaj një veprim i tillë sanksionohet edhe me nenin 5 paragrafi 1 pika d) i Rregullës Zgjedhore Nr.13/2013, ku përcaktohet se “subjektet e certifikuara politike aktivitetet e tyre zgjedhore duhet t'i bëjnë në pajtueshmëri me Rregullat zgjedhore të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ)”. Ky përfundim ka të bëjë me faktin se Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politik të jenë në një atmosferë të tolerancës demokracisë, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit.

Nga CD-ja, fotografitë e ofruara si provë dhe shkresat e tjera të lëndës, shihet qartë se nga ana e subjektit politik N.N, është shkëlur dispozita e nenit 33 pika l), e LZP-së, e cila ndër të tjera përcakton se; “Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: ... l) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve”, për faktin se në video spotin publicitar të subjektit politik N.N, theksohet se “kandidati për kryeministër nga subjekti politik X.X, E.H, e mohon se ka pasur gjenocid në Kosovë, ndërsa gjenocidin që e ka kryer Serbia e cilëson si përpjekje për gjenocid, ndërsa theksojnë se saktësimin e këtij pohimi mund ta vërtetojnë tek libri i E.H, me titull Ndërtimi i shtetit politika e jashtme botimi 2017 faqe 198 dhe faqe 206, ndërsa në po të njëjtin video spot bëjnë thirrje që E.H, nuk e meriton votën e qytetarit pasi që kandidati në fjalë gjenocidin ndaj shqiptareve e konsideron si përpjekje për gjenocid”.

Andaj sipas vlerësimit të Panelit, si dhe duke u nisur nga gjendja faktike, subjekti politik N.N me këtë rast ka përdorur gjuhë e cila nxitë ose provokon akte të dhunës dhe e cila mund të ketë ndikim të tillë denigrues kundër kandidatit për deputet nga subjekti politik X.X, E.H, veprime këto që janë në kundërshtim me Kodin e Mirësjelljes të Subjekteve Politike.

Lidhur me përgjigjen e subjektit politik N.N, ku thekson se ky subjekt politik nuk e ka bërë emetimin dhe nuk ka autorizuar asnjë medium që të publikojë këtë spot publicitar, Paneli vlerësoi se me këtë përgjigje subjekti politik N.N, nuk e mohon se e ka realizuar një spot të tillë publicitar por se e njëjta thekson se për spotin në fjalë nuk e ka autorizuar asnjë medium kombëtar në TV, apo në mediumet online për emetimin e këtij.

Paneli, vlerëson se në rastin konkret nuk është relevante se ku është shfaqur apo publikuar videoja apo spoti në fjalë, por fakti se ky incizim ka qenë i qasshëm për subjektin ankues dhe me asnjë provë të vetme nuk e ka mohuar faktin se spoti si i tillë ekziston.

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e subjektit politik N.N, është shkelur dispozita e lartcekur e LZP-së, si dhe neni 5 paragrafi 1 pika d) i Rregullës Zgjedhore Nr.13/2013, ku parashihet se subjektet e certifikuara politike aktivitetet e tyre zgjedhore duhet t'i bëjnë në pajtueshmëri me Rregullat zgjedhore të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ). Ky përfundim ka të bëjë me faktin se Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politik të jenë në një atmosferë të tolerancës demokracisë, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit.

Paneli, me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalët, shkallën dhe peshën e shkeljes, pjesëmarrjen e subjekti politik në zgjedhjet e mëparshme që konsiston në faktin se subjekti politik N.N, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, shkeljet e Ligjeve zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje dhe në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë që do të thotë se i njëjti është i njoftuar me rregullat zgjedhore si dhe shumën e fondeve që ka marrë subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve lidhur me fushatën zgjedhore. Po ashtu si rrethanë Paneli, mori edhe faktin që këtij subjekti, ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjet e tij e njëjta e ka mohuar shkeljen e tillë. Mos ndërmarrja e masave përmirësuese ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli, konform nenit 120.1 pika a) të LZP-së urdhëroi subjektin politik N.N, që të marrë masa dhe të përmirësoj shkeljet në afatin prej 24 orëve dhe nëse i njëjti nuk vepron sipas urdhrit të panelit do të sanksionohet me dënim shtesë nga PZAP-i, në pajtim me nenin 120.2 të LZP-së.

Vendimi i PZAP-it, Anr.351/2021, i datës 11.02.2021, ishte apeluar nga subjekti politik N.N, në Gjykatën Supreme të Kosovës, me ç'rast Gjykata e ka refuzuar si të pabazuar me aktgjykim numër A.A.nr.16/2021, dt.15.02.2021), dhe ka vërtetuar Vendimin e PZAP-it.

## Parashtruesit e çështjes, A.A dhe subjekti politik N.N, kanë paraqitur ankesë kundër subjektit politik X.X, për shkak të përdorimit të gjuhës së urrejtjes

### Lidhur me këtë çështje PZAP-i, ka nxjerr Vendimin Anr.352/2021 të datës 11.02.2021

**Faktet e Çështjes-** A.A, dhe subjekti politik N.N, në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), kanë paraqitur ankesë kundër subjektit politik X.X, për shkak të përdorimit të gjuhës së urrejtjes, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura me datë 14.02.2021.

PZAP-i, me datë 09.02.2021, ka pranuar ankesat: Anr.352/2021 e ushtruar nga A.A, me seli në Prishtinë dhe ankesa Anr.358/2021, e ushtruar nga subjekti politik N.N, të cilat ankesa janë paraqitur kundër subjektit politik X.X, në të cilat pretendohet se gjatë monitorimit të fushatës zgjedhore për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës, nga fillimi i fushatës zgjedhore në Kosovë, me data të ndryshme, nga aktivistët e N.N, është vërejtur publikimi i kësaj CD, përmes një portali "Lajme në Kosovë", më datë 08.02.2021 videon me përmbajtje " Cilin do të votonte V. për president? Nëse V. (Presidenti i Serbisë) do të ishte para kutisë së votimit midis R. dhe V. cilin mendonin do ta votojë? Me president të dobët ai e ka më lehtë. Me V. si presidente V. përdor çdo moment dobësi për ta kërcënuar Kosovën dhe për të bllokuar vendit tonë. Por jo me R.. R është vetmi që mund të dal kundër V.. Ai është Presidenti që nuk do të bëjë kompromis për territorin dhe dinjitetin tonë. R. e ka bërë të qartë njohjen e plotë për Kosovën ose bashkimin me Shqipërinë. R. është forca e Kosovës, forca e sovranitetit tonë, forca për të ardhmen e Kosovës. R. President, voto 135".

Parashtruesit e ankesave pretendojnë se në këtë spot nga subjekti politik X.X, është përdorur gjuhë e urrejtjes dhe nxitjes të urrejtjes për kandidaten për deputete nga radhët e subjektit politik N.N, V.O.

Sipas parashtruesve të ankesave, subjekti politik X.X, ka cenuar rëndë Nenin 33 paragrafi 1 shkronja L, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme Ligji Nr.03/L-073 dhe rregullës zgjedhore numër 11/2013 neni 4 paragrafi 1 shkronja k, duke përdorur gjuhë të urrejtjes përmes video spotit publicitar kundër një kandidate tjetër në baza gjinore dhe e ka paraqitur atë si person të preferuar për një president të një republike tjetër, duke e kualifikuar si "të dobët" dhe duke përdorur situata hipotetike me qëllim të denigrimit të imazhit të saj.

PZAP-i, duke u mbështetur në dispozitën e nenit 32 par.2, nenit 118 par.1 dhe nenit 120 par.1 pika (c) të LZP-së, **ankesat e parashtruara i miratoi si të bazuara**, për arsye se subjekti politik i lartpërmendur ka bërë shkelje të Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika l), e LZP-së.

## Arsyetimi i Panelit – PZAP



Në përgjigjen e subjektit politik X.X, me të cilën pretendohet se ankesat janë të pas afatshme pasi që siç deklarohet në ankesën e paraqitur nga A.A, se në spot kinse është paraqitur gjuhë e urrejtjes për kandidaten për deputete nga një subjekt tjetër dhe është publikuar në data të ndryshme si dhe në ankesë e N.N, i cili është ankuar për të njëjtin rast dhe ka pretenduar se në publikimin e kësaj CD, e kanë vërejtur më datë 08.02.2021 në portalin " Lajme në Kosovë " nuk qëndron sepse shkelja e pretenduar është publikuar më datë 06.02.2021.

Me tutje në përgjigjet në ankesë pretendohet se këto ankesa janë të pasafatshme sipas nenit 5 par.5.5 i Rregullës 02/2015, i cili parasheh afatin për ankesë dhe ankesat e dorëzuara nga A.A, dhe N.N, janë dorëzuar më datë 09.02.2021. Lidhur me pretendimet në ankesa që në publikimin e spotit në fjalë është përdorur gjuhë dhe nxitje e urrejtjes për kandidaten për deputete nga radhët e subjektit politik N.N, V.O, subjekti politik X.X, në përgjigjet e tyre pretendon se në spotin e publikuar më datë 06.02.2021, nuk është paraqitur gjuhë e urrejtjes. Në vazhdim pretendojnë se në spotin publicitar të datës 06.02.2021, nuk është paraqitur aspak gjuhë dhe nxitje e urrejtjes por vetëm janë përshkruar aftësitë e dy kundër kandidatëve për president të Kosovës. Lidhur me përdorimin e fjalës i/e dobët për kundërshtarit dhe kundër kandidatin politik sipas subjektit politik X.X, nuk përbën gjuhë të urrejtjes. Në vazhdim të përgjigjes pretendohet se kandidatja për presidente znj.V.O, në vazhdimësi është duke përdorur gjuhë fyese ndaj kryetarit të subjektit të tyre z.R.H.

Subjekti politik X.X, në përgjigjet e tyre pretendon se në spotin publicitar të datës 06.02.2021, asnjëherë dhe asnjë moment nuk dëgjohet përdorimi i ndonjë shprehje e cila ka për qëllim nxitjen e urrejtjes dhe konsiderojnë se X.X, nuk ka ndërmarr veprime që janë në kundërshtim me nenin 33 pika (l) të LZP-së, dhe nenin 4 paragrafi 4 pika k) të Rregullës Zgjedhore dhe sipas tyre në spotin publicitar të datës 06.02.2021, vërtetohet se nuk është përdorur gjuhë që nxit apo provokon një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë. Propozojnë PZAP-in, të hedhë poshtë si të pasafatshme ankesat e paraqitura nga A.A, me seli në Prishtinë dhe nga subjekti politik N.N, nëse PZAP-i, gjen se ankesa është ushtruar brenda afatit propozojnë që të refuzohen si të pabazuara.

Në bazë të nenit 8 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Paneli më qëllim të ekonomizimit të procedurës, ka bashkuar ankesat Anr.352/2021 dhe Anr.358/2021 të datës 09.02.2021, dhe janë trajtuar si një ankesë, andaj procedimi i këtyre ankesave tani e tutje evidentohen, me shenjën e përbashkët Anr.352/2021, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të apeluesve.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se: **Ankesat janë të bazuara**

## Shënim

Paneli, pas shikimit të bërë në CD, nga përmbajtja e të njëjtës pa mëdyshje vërtetohet se incizimi është bërë në emër të subjektit politik X.X, dhe kundër subjektit politik N.N, respektivisht Listës së V.O.

Gjuha e përdorur në videon e dërguar si provë nga ankuesi është gjuhë linquese, denigruese dhe fyese, përmes së cilës bëhet krahasimi i V.O me A.V, ku në të njëjtën video shfaqet A.V, dhe mënyra se si e bënë përshkrimin e personalitetit të V.O, kjo paraqet në vetvete gjuhë urrejtjeje, e cila përçon mesazh te votuesi për bojkotim të votës në drejtim të subjektit të cilit i përket.

Gjuha e tillë e përdorur dhe aludimi se zgjedhja e V.O, i shkon në favor A.V, është mesazh i rëndë për demokracinë dhe integritetin e procesit zgjedhor gjatë fushatës zgjedhore dhe një linqim i tillë cenon edhe sigurinë e personit ndaj të cilit adresohet.

Legjislacioni aktual zgjedhor në mënyrë shprehimore ka ndaluar të berit fushatë përmes gjuhës e cila nxit urrejtje ndaj të tjerëve nga cilado bazë, etnike, ideologjike, fetare, armiqësore etj. Tendenca për të shfaqur elemente patriotike duke sulmuar figura politike dhe duke aluduar në krahasimet e vendosmërisë së tyre publike dhe politike në raport me qëndrimet dhe bisedimet me shtetin e Serbisë dhe udhëheqësit e tyre, përveç që fare s'ka të bëjë me aspekt të fushatës zgjedhore, cenon rëndë demokracinë në procesin zgjedhor gjatë garës elektorale, e cila gjë që do të duhej të bëhej në suaza të garës programore.

Nga CD-ja, spoti publicitar e ofruar si provë materiale e cila është publikuar në portale të ndryshme dhe shkresat e tjera të lëndës, Paneli ka vlerësuar se subjekti politik X.X, me qëllim të promovimit të subjektit të tyre politik dhe kandidatit të propozuar për president R.H, në spotin e tyre zgjedhor, ka nxitur urrejtje ndaj kandidatit të subjektit tjetër politik duke përfshirë në spotin e tyre kandidaten e propozuar për presidente nga N.N, V.O, si e preferuara për tu votuar nga presidenti i Republikës së Serbisë, A.V, si dobësi e kandidatës për ta kërcënuar Kosovën.

Spoti i Subjektit politik, po ashtu ka mesazhe që nxit dhe provokon urrejtjen ndaj subjekteve dhe kandidatëve të subjekteve tjera politike ku thuhet se: “Cilin do të votonte V. për president? Nëse V. (Presidenti i Serbisë) do të ishte para kutisë së votimit midis R. dhe V., cilin mendonin do ta votojë? Me president të dobët ai e ka më lehtë. Me V. si presidente V. përdor çdo moment dobësi për ta kërcënuar Kosovën dhe për të bllokuar vendit tonë” dhe sipas vlerësimit të Panelit, me përdorimin e kësaj gjuhe, në spot nxitet urrejtja kundër të tjerëve.

Në këtë rast Paneli, vlerëson se subjekti politik i lartpërmendur ka bërë shkelje të Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika l), e LZP-së, e cila ndër të tjera përcakton se: “Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: ... l) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve, ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo lloj materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë”.

Paneli, me rastin e shqiptimit të gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi mori parasysh shkeljet e lartpërmendura, dhe shqiptoj gjobën, duke u bazuar në nenin 120 par. 1 pika c) LZP-së, nenin 3 pika 11 Rregullores për Nr.01/2012, për Kategorizimin e Sanksioneve dhe Gjobave të PZAP-it, për arsye se:

Me nenin 120 paragraf 1 pika c) të LZP-së, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin për zgjedhjet e përgjithshme të Republikës së Kosovës, me nr.03/L073 i datës 29 Tetor 2010, nenin 14 përcaktohet se; "nenin 120 në fuqi par 1, b dhe c), të vendos një gjobë një subjekti politik në vlerën deri në 50.000 euro".

Me nenin 3 pika 11, Rregullores për Nr.01/2012, për Kategorizimin e Sanksioneve dhe Gjobave të PZAP-it, përcaktohet se ' Në qoftë se subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: ... l) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve, ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo lloj materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë "...subjekti politik që është i përfaqësuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës dënohet me 10.000 deri në 30.000 euro.

Paneli, pasi shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe duke iu referuar dispozitave ligjore të cekura më lartë e në veçanti duke marrë rrethanat e rastit siç janë: natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor, shkallën dhe peshën e shkeljes, nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Përveç të cekura më lartë Paneli, me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e subjektit politik X.X, në kuadër të pretendimeve të theksuara në përgjigje në ankesë se spoti me të cilën është publikuar nga subjekti i tyre nuk përmban gjuhë të urrejtjes dhe ankesat në fjale janë të pasafatshme sepse publikimi i këtij spoti është bërë më 06.02.2021 dhe ankesat janë dorëzuar në PZAP, më datë 09.02.2021, mirëpo Paneli vlerësoi se të njëjtat ishin të pabazuara pasi që në CD-në, e ofruar shihet qartë përdorimi i gjuhës së urrejtjes dhe sa i përket afatit spotet publicitare të subjekteve politike gjatë fushatës publikohen çdo ditë në portalin e paguar nga subjekti gjatë fushatës zgjedhore dhe si të tilla nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe. Mos ndërmarrja e masave përmirësuese ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi i PZAP-it, Anr.352/2021, i datës 11.02.2021, ishte apeluar nga subjekti politik X.X, në Gjykatën Supreme të Kosovës, me ç'rast Gjykata e ka refuzuar si të pabazuar me aktgjykim numër A.A.nr.15/2021, dt.15.02.2021.

## Parashtruesi i çështjes, D.I e Komunës së Glllogocit, ka paraqitur ankesë kundër subjektit politik N.N, për shkak të vendosjes së shiritave “fijonga” të kuqe në vende publike

### Lidhur me këtë çështje PZAP-i, ka nxjerr Vendimin Anr.365/2021 të datës 12.02.2021

**Faktet e Çështjes-** D.I, e Komunës së Glllogocit, ka paraqitur ankesë kundër subjektit politik N.N, për shkak të vendosjes së shiritave “fijonga” të kuqe në vende publike, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura me datë 14.02.2021.

D.I të Komunës së Glllogocit, ka parashtruar ankesën Anr.365/2021, me datë 10.02.2021, në PZAP, më të cilën pretendon se nga Inspektorët Komunal me datë 08.02.2021, është bërë inspektimi dhe evidentimi i shiritave të kuq “fijonga” në rrugët publike “Shaban Shala” dhe “Bedri Shala” në Glllogoc, të vendosur nga subjekti politik N.N. Me këtë paraqitësi i ankesës ka pretenduar se ky veprim i subjektit politik N.N, është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë, respektivisht nenin 33, pika b), të këtij ligji. Paraqitësi i ankesës në mbështetje të pretendimeve në ankesë, si dëshmi ka bashkangjitur disa fotografi të printuara.

PZAP-i, duke u mbështetur në dispozitën e nenit 118 par.1 të LZP-së, **ankesën e parashtruar e ka refuzuar si të pabazuar**, pasi që erdhi në përfundim se janë të paqëndrueshme pretendimet e paraqitësit të ankesës se këto veprime përbëjnë shkelje të Kodit të Mirësjelljes nga subjekti politik N.N, për shkak se nga fotot e ofruara si dëshmi në ankesë nuk është vërtetuar se të njëjtat janë vendosur nga N.N, dhe në asnjë nga shiritat e kuq “fjonga”, nuk mund të identifikohet ndonjë shenjë që e identifikojnë subjektin politik N.N apo ndonjë subjekt tjetër.

### Arsyetimi i Panelit – PZAP



PZAP-i, më datë 10.02.2021, konform nenit 7, par.1, të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, njoftoi subjektin politik N.N, për ankesën e paraqitur, duke i dhënë kohë për përgjigje deri më datë 11.02.2021 në ora 10:00.

Në përgjigjen në ankesë të datës 11.02.2021, subjekti politik N.N, thekson se parashtruesi i ankesës pretendon se ka parë me datë 08.02.2021, shirita të kuq “fijonga” në dy rrugët përkatëse sipas ankesës. Ndërsa ankesën, siç shihet e ka dorëzuar me datë 10.02.2021. Pra, ankesa është dorëzuar jashtë afatit të përcaktuar me rregullën e PZAP-së 02/2015, konkretisht me nenin, 5 par.5, pika 5. Parashtruesi pretendon se shiritat e kuq ose fjongot janë vendosur në rrugët përkatëse të përcaktuara sipas ankesës nga subjekti politik N.N, në kundërshtim me nenin 33, pika b) të LZP-së.

Më tej thekson se N.N, konkretisht shtabet përkatëse të saj, nuk kanë dhënë asnjë direktivë që ato fjonga të vendosen në rrugët përkatëse. Pra, ato shirita apo fjonga të kuq nuk kanë asgjë të bëjnë me N.N, dhe as nuk i ka vendosur asnjë aktivist i saj. Siç dihet botërisht N.N, ka sloganin e saj për këto zgjedhje “Krejt dhe Drejt”, ka llogon e saj zyrtare të cilat në asnjë rrethanë nuk identifikohen me shiritat e kuq.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se: **Ankesa është e pabazuar**

## Shënim

*Nga shkresat e lëndës vërtetohet se Komuna e Glllogocit, D.I, ka parashtruar ankesë në PZAP A.nr.365/2021 më datë 10.02.2021, me të cilën pretendon se subjekti politik N.N, ka vendosur shirita të kuq “fjonga” në rrugët publike të Komunës së Glllogocit.*

*Subjekti politik N.N me datë 11.02.2021, ka paraqitur përgjigje në ankesë, duke i kundërshtuar në tersi pretendimet e ankuesit të parashtruara në ankesë dhe duke kërkuar që ankesa të refuzohet e pa bazuar, së pari për shkak se ankesa është e pasafatshme dhe se ato shirita apo fjonga të kuq nuk kanë asgjë të bëjnë me N.N, dhe as nuk i ka vendosur asnjë aktivist i saj.*

*Duke u nisur nga arsyet e theksuara me lartë, Paneli konstatoi se nga ana e subjektit politik N.N, nuk është bërë shkelje e nenit 33, pika b) të LZP-së, ku thuhet se “vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe, vendosja e emrave të tyre ose e sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut, brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose, ndryshe, që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare, ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronarëve ose shfrytëzuesve”.*

*Paneli erdhi në përfundim se janë të paqëndrueshme pretendimet e paraqitësit të ankesës se këto veprime përbëjnë shkelje të Kodit të Mirësjelljes nga subjekti politik N.N për shkak se nga fotot e ofruara si dëshmi në ankesë nuk është vërtetuar se të njëjtat janë vendosur nga N.N dhe në asnjë nga shiritat e kuq “fjonga”, nuk mund të identifikohet ndonjë shenjë që e identifikojnë subjektin politik N.N apo ndonjë subjekt tjetër. Për më tepër, vendosja e këtyre shiritave në hapësira publike përderisa nuk identifikohet më ndonjë shenjë të ndonjë subjekti politik gjatë fushatës zgjedhore, vlerësohet nga Paneli, se nuk ka të bëjë me ndalesat që janë përcaktuar me nenin 33, pika b) i LZP-së, nga se kusht për tu konsideruara material propagandistik duhet që materiali i tillë të jete i identifikueshëm me ndonjë subjekt që është pjese e garës zgjedhore. Nëse ankuesi edhe më tej pretendon në shkeljet e paraqitur në ankesë mund të inicioi procedurë në ndonjë institucion tjetër kompetent.*



## Parashtruesi i çështjes, subjekti politik N.N, ka paraqitur ankesë kundër subjektit politik X.X, për shkak të përdorimit të gjuhës denigruese, fyese, nxitëse dhe ofenduese

### Lidhur me këtë çështje PZAP-i, ka nxjerr Vendimin Anr.366/2021 të datës 12.02.2021

**Faktet e Çështjes-** Subjekti politik N.N, me seli në Skenderaj, ka paraqitur ankesë kundër subjektit politik X.X, me seli në Prishtinë, për shkak të përdorimit të gjuhës denigruese, fyese, nxitëse dhe ofenduese, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura me datë 14.02.2021.

Me datë 10.02.2021, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga N.N, me seli në Skenderaj, me të cilën pretendon se nënkryetari i X.X nga radhët e X.X, S.L, në një tubim të organizuar në një odë, duke ju referuar kryetarit të N.N, A.K, thekson se “Nuk jem fajtor na, pse ai nuk ka qenë në luftë në Kosovë. U ardhë në Likoc, e kemi lutë me marrë armen, ska guxu, u ardhë në Prishtinë e kanë burgos sikur një “zagar të vogël” edhe e kanë qu në Beograd”.

Parashtruesit e ankesës si dëshmi lidhur me rastin në fjalë ankesës ia kanë bashkangjitur CD-në.

N.N, pretendon se nënkryetari i X.X nga radhët e X.X, S.L, ka përdorur gjuhë të urrejtjes kundër kryetarit të N.N, A.K. N.N pretendon se subjekti politik X.X, ka cenuar rëndë nenin 33 pika l, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, lidhur me nenin 4.Par.1 pikës k) të Rregullës Zgjedhore të KQZ-së, nr.11/2013, e ndërsa qëllimi i këtij ligji dhe kodit të mirësjelljes se subjekteve politike është krijimi i kushteve në të cilat populli i Kosovës mund të zgjedhë përfaqësuesit e tij përmes zgjedhjeve të lira te drejta dhe të mirë informuara në një atmosfere të tolerancës demokratikë paqes dhe respektit për sundimin e ligjit. Andaj bazuar në atë që u theksua me sipër i njëjti konsideron se subjekti politik në fjalë ka bere shkelje të dispozitave ligjore në fuqi dhe si dëshmi për pretendimet e tij, ankesës i ka bashkangjitur një CD, në cilësi të provës materiale.

PZAP-i, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, **ankesën e parashtruar e ka miratuar si të bazuar**, duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, se nga prova e ofruar shihet qartë se nga ana e nënkryetarit të X.X nga radhët e X.X, S.L, është shkelur dispozita e nenit 33 pika l), e LZP-së, për faktin se në video incizimin e këtij subjekti politik është përdorur gjuhë denigruese, fyese dhe ofenduese kundër kryetarit të subjektit politik N.N, A.K.

## Arsyetimi i Panelit – PZAP



Në përgjigjen në ankesë të datës 11.02.2021, subjekti politik X.X, deklaroi se S.L, nuk është kandidat për deputet nga radhët e X.X, dhe i njëjti në tubimin e cekur nga ankuesi, në vazhdim të fushatës ka debatuar me qytetarë lidhur me diskursin publik të liderit të N.N, karshi partive tjera dhe gjuha e përdorur nuk është gjuhë e urrejtjes, dhe se nuk mund të konstatohet me asnjë shprehje se ka gjuhë të urrejtjes në deklarinë e L. X.X, deklaroi se me datë 02.02.2021, në bazë të nenit 32 paragrafi 32.6 të Ligjit Nr.03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, përmes njoftimit zyrtar në web faqen e partisë kemi kërkuar respektimin në tërësi të legjislacionit dhe kodit të etikës për zgjedhjet.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se: **Ankesa është e bazuar**

### Shënim

*Nga shkresat e lëndës vërtetohet se N.N, me seli në Skenderaj, ka parashtruar ankesë PZAP A.nr 366/2021 më datë 10.02.2021, me të cilën pretendon se nënkryetari i X.X nga radhët e X.X, S.L ka përdorur gjuhë të urrejtjes kundër kryetarit të N.N, A.K. Pas pranimit të ankesës në PZAP, e njëjta i është dërguar subjektit politik X.X për përgjigje në ankesë.*

*Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, Paneli konstaton se nga prova e ofruar shihet qartë se nga ana e nënkryetarit të X.X, nga radhët e X.X, S.L, është shkelur dispozita e nenit 33 pika l), e LZP-së, e cila ndër të tjera përcakton se; 'Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: ... l) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve', për faktin se në video incizimin e këtij subjekti politik është përdorur gjuhë denigruese, fyese dhe ofenduese kundër kryetarit të N.N A.K..*

*Video incizimi i Subjektit politik, po ashtu ka mesazhe që nxit dhe provokon urrejtjen ndaj kryetarit të N.N, A.K, ku thuhet se: "Nuk jem fajtor na, pse ai nuk ka qenë në luftë në Kosovë. U ardhë në Likoc, e kemi lutë me marrë armen, ska guxu, u ardhë në Prishtinë e kanë burgos sikur një "zagar të vogël" edhe e kanë qu në Beograd" dhe sipas vlerësimit të Panelit, me përdorimin e kësaj gjuhe, në incizim nxitet urrejtja kundër të tjerëve.*

*Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalët, shkallën dhe peshën e shkeljes, pjesëmarrjen*

nënkryetarit të X.X, nga subjekti politik X.X në zgjedhjet e mëparshme që konsiston në faktin se subjekti politik X.X, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, shkeljet e ligjeve zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje dhe në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë, që do të thotë se i njëjti është i njoftuar me rregullat zgjedhore si dhe shumën e fondeve që ka marrë subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve lidhur me fushatën zgjedhore.

Po ashtu si rrethanë PZAP-i, mori edhe faktin që këtij subjekti, i'a dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjet e tij ka mohuar shkeljet e supozuara, duke dhënë përgjigje se S.L, nuk është kandidat për deputet nga radhët e X.X, dhe gjuha e përdorur nuk është gjuhë e urrejtjes. Paneli vlerëson se duke u nisur nga fakti se S.L, është nënkryetar i partisë dhe mbështetës i partisë, subjekti politik i lartpërmendur ka bërë shkelje të Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika l), e LZP-së, e cila ndër të tjera përcakton se; 'Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: ... l) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve, ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo lloj materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë ”.

Paneli konform nenit 120.1 pika a) të LZP-së urdhëroi subjektin politik X.X, që të marrë masa dhe të përmirësoj shkeljet në afatin prej 24 orëve dhe nëse i njëjti nuk vepron sipas urdhrit të panelit do të sanksionohet me dënim shtesë nga PZAP-i , në pajtim me nenin 120.2 të LZP-së.

Vendimi i PZAP-it, Anr.366/2021, i datës 12.02.2021, ishte apeluar nga subjekti politik X.X, në Gjykatën Supreme të Kosovës, me ç 'rast Gjykata e ka refuzuar si të pabazuar me aktgjykim numër A.A.nr.18/2021 dt.15.02.2021, dhe ka vërtetuar Vendimin e PZAP-it.

## Parashtruesi i çështjes, Iniciativa Qytetare N.N, ka paraqitur ankesë kundër subjektit politik X.X, Shënimi i grafikëve me përmbajtje zgjedhore në hyrje të oborrit të shkollës

### Lidhur me këtë çështje PZAP-i, ka nxjerr Vendimin Anr.371/2021 të datës 12.02.2022

**Faktet e Çështjes-** Iniciativa Qytetare N.N, me seli në Graçanicë, ka paraqitur ankesë kundër subjektit politik X.X, me seli në Mitrovicën e Veriut dega në Graçanicë, për shkak të shënimit të grafiteve me përmbajtje zgjedhore në rrugë dhe në hyrje të oborrit të shkollës në Graçanicë, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura me datë 14.02.2021.

Më datë 11.02.2021, Iniciativa Qytetare N.N, me seli në Graçanicë, ka paraqitur ankesë në PZAP, në të cilën pretendon se subjekti politik X.X në rrugën kryesore e cila shkon deri te vendvotimi 3401E në Graçanicë, si dhe në hyrje të oborrit të qendrës së votimit me prej të ngjyrosur kanë shkruar grafitë me numra të subjektit të tyre politik. Me këtë rast paraqitësi i ankesës ka pretenduar se me këtë veprim subjekti politik X.X, ka shkelur dispozitat e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë dhe rregullat zgjedhore, e njëjta kërkon nga PZAP-i, që të gjohet subjekti politik X.X dhe të detyrohet që sa më shpejt të hiqen ato grafitë nga aty.

PZAP-i, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, **ankesën e parashtruar e miratoi si të bazuar**, pasi që nga provat e ofruara dhe shkresat e tjera të lëndës shihet qartë se nga ana e subjektit politik X.X, është shkelur dispozita e nenit 33 pika b), e LZP-së, për faktin se në objektin publik gjegjësisht në muret e saj shihen të shënuara grafitet e subjektit politik në fjalë dhe numri i tij.

### Arsyetimi i Panelit – PZAP



Në përgjigjen në ankesë të datës 12.02.2021, subjekti politik X.X, thekson se këto grafitë nuk janë pjesë të aktiviteteve të tyre parazgjedhore dhe dallojnë nga materialet e tyre promovuese, dhe se këto grafitë nuk janë në interesin e subjektit të tyre politik, por se theksojnë se këto grafitë ka mundësi që ti ketë shënuar ndonjë fëmijë pasi që këto grafitë janë shënuar afër shkollës. Të njëjtit theksojnë se subjektit politik X.X, këto veprime më shumë i shkaktojnë dëme se sa dobi dhe të njëjtit me të marrë vesh kanë udhëzuar aktivistët e tyre që ti fshijnë nga muret ato grafitë dhe ta kthejnë murin në gjendjen origjinale ashtu siç ka qenë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se: **Ankesa është e bazuar**

## Shënim

Paneli, pas shikimit të bërë në shkresave të lëndës dhe foto dokumentacionet nga përmbajtja e të njëjtës pa mëdyshje vërtetohet se grafitet janë bërë nga subjekti politik X.X, ku shihet numri i 119 i këtij subjekti politik me të cilin garon në Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Legjislacioni aktual zgjedhor gjegjësisht neni 33 pika b) e LZP-se në mënyrë shprehimore ka ndaluar të që gjatë fushatës zgjedhore subjekteve politike ju ndalohet vendosja e njoftimeve, pllakatave posterave, vendosja e emrave te tyre ose sloganeve ne lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugët publike etj.

Përveç kësaj një veprim i tillë sanksionohet edhe me Kodin e Mirësjelljes i cili i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politik të jenë në një atmosferë të tolerancës demokratike, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit.

Nga fotografitë e ofruara si provë dhe shkresat e tjera të lëndës, shihet qartë se nga ana e subjektit politik X.X, është shkelur dispozita e nenit 33 pika b), e LZP-së, për faktin se ne objektin publik gjegjësisht në muret e saj shihen të shënuara grafitet e subjektit politik në fjalë dhe numri i tij.

Lidhur me përgjigjen e subjektit politik X.X, ku thekson se ky subjekt politik nuk e ka bërë shënimin e këtyre grafitëve dhe si arsyetim të saj thekson se atë kane mundur që ti shënojnë fëmijët, Paneli vlerësoi se me këtë përgjigje subjekti politik X.X, nuk e mohon se e ka pasur të shënuara në mure slogane të saja por se e njëjta si arsyetim thekson se nuk e din se kush i ka shënuar ato, por që në rrethana aktuale të kohës së Fushatës zgjedhore një pohimi të tillë të subjektit politik X.X, Paneli nuk ka mundur ta konsideroj si qëndrueshëm. Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e subjektit politik X.X, është shkelur dispozita e lartcekur e LZP-së, si dhe Kodi i Mirësjelljes ku si përfundim kjo ka të bëjë me faktin se ky Kod i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politik të jenë në një atmosferë të tolerancës demokratike, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit.

Paneli, me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalët, shkallën dhe peshën e shkeljes, pjesëmarrjen e subjektit politik në zgjedhjet e mëparshme që konsiston në faktin se subjekti politik X.X, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, shkeljet e Ligjeve zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje dhe në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë që do të thotë se i njëjti është i njoftuar me rregullat zgjedhore si dhe shumën e fondeve që ka marrë subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve lidhur me fushatën zgjedhore. Po ashtu si rrethanë Paneli, mori edhe faktin që këtij subjekti, ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjet e tij e njëjta i ka shlyer ato grafitë ku kanë qene të shënuara. Marrja e masave përmirësuese ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

## Parashtruesi i çështjes, subjekti politik N.N, ka paraqitur ankesë kundër subjektit politik, X.X, për shkak të mbajtjes së tubimit elektoral në ambient të mbyllur

### Lidhur me këtë çështje PZAP-i, ka nxjerr Vendimin Anr.502/2021 të datës 16.02.2021

**Faktet e Çështjes-** Subjekti politik N.N, ka paraqitur ankesë kundër subjektit politik, X.X, për shkak të mbajtjes së tubimit elektoral në ambient të mbyllur, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura me datë 14.02.2021.

Me datën 15.02.2021, Paneli, ka pranuar ankesën Anr.502/2021, të parashtruar nga subjekti politik N.N, me të cilën pretendon se subjekti politik X.X, ka mbajtur tubim elektoral në ambiente të mbyllur në motel Gjeravica në Junik, në të cilën pretendojnë se kane marre pjese mbi 50 persona ku shihen edhe fotografit të cilat nuk kane as distance si dhe masa mbrojtës (maska) duke i shkelur masat dhe ligjet për pandemi Covid 19. Parashtruesi i ankesës thekson se organet kompetente ishin pjesëmarrës dhe nuk pranuan të ndalin tubimin edhe pse në ligj për pandeminë thuhet se në një tubim në ambient të mbyllur marrin pjese më shumë se 30 persona. Parashtruesi i ankesës thekson se pjesëmarrësit të tubimit ishin R.H, T.H, P.L, SH.D etj.

PZAP-i, në mbështetje të dispozitave të nenit 5.6 të Rregullës Nr.02/2015 për Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, dhe në kuptim të dispozitës së nenit 118.1 të LZP-së, vlerësoj se **ankesa është e parregullt**, sepse ankesa në fjalë nuk është e nënshkruar nga parashtruesi i ankesës dhe si e tillë ankesa nuk i plotëson kërkesat ashtu siç parashihet me nenin 5.6 të Rregullës Nr.02/2015 për Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it

### Arsyetimi i Panelit – PZAP




Paneli, pas shqyrtimit paraprak të lejueshmërisë së ankesës gjeti se: **Ankesa është e parregullt**

### Shënim

*Paneli, nga shkresat e lëndës vlerësoj se ankesa e paraqitur nga subjekti politik N.N, është e parregullt, sepse ankesa në fjalë nuk është e nënshkruar nga parashtruesi i ankesës dhe si e tillë ankesa nuk i plotëson kërkesat ashtu siç parashihet me nenin 5.6 të Rregullës Nr.02/2015 për Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, ku theksohet se: “Ankesat duhet të dorëzohen me shkrim dhe duhet të jenë të nënshkruara nga ankuesi apo në emër të tij nga i autorizuari”. Në rastet kur ankuesi është parti politike, koalicion, iniciativë qytetare ose çfarëdo personi tjetër juridik, ankesa duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi i autorizuar i atij personi juridik siç është përcaktuar, në rastet ku kjo është e mundshme, në çfarëdo dispozite ligjore në fuqi.*

*Prandaj Paneli, nuk u lëshua fare në meritat e ankesës, ngase nuk janë plotësuar kushtet e kërkuara nga dispozita e lartcekur.*



Në këtë pjesë janë përzgjedhur vendimet të cilat i referohen  
heshtjes zgjedhore për zgjedhjet e parakohshme të vitit 2019 të  
mbajtura për Kuvendin e Republikës së Kosovës

**Parashtruesi i çështjes, Subjekti politik N.N ka paraqitur ankesat kundër subjektit politik X.X, me të cilën pretendonte se përmes Facebook-ut, në llogarinë zyrtare të subjektit politik X.X dhe në llogaritë zyrtare në facebook të kandidatëve për deputet dhe përkrahësve nga radhët e këtij subjekti politik, kanë bërë fushatë zgjedhore në rrjetin social Facebook, në ditën e heshtjes zgjedhore dhe në ditën e votimit**

[Lidhur me këtë çështje PZAP-i, ka nxjerr Vendimin Anr.378/2021 të datës 05.02.2021](#)

**Faktet e Çështjes-** Me datë 13.02.2021 dhe 14.02.2021, PZAP-i ka pranuar ankesat e paraqitura: Anr.378/2021, Anr.420/2021, Anr.421/2021, Anr.422/2021, Anr.423/2021, Anr.424/2021, Anr.425/2021, Anr.426/2021, Anr.427/2021, Anr.428/2021, Anr.429/2021, Anr.430/2021, Anr.431/2021, Anr.432/2021, Anr.433/2021, Anr.434/2021, Anr.436/2021, Anr.437/2021 dhe Anr.449/2021, të paraqitura nga subjekti politik N.N, me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik X.X, me seli në Prishtinë, në të cilat pretendohet se përmes Facebook-ut, në llogarinë zyrtare të subjektit politik X.X, dhe në llogaritë zyrtare në facebook të kandidatëve për deputet nga radhët e këtij subjekti politik dhe përkrahësve nga radhët e këtij subjekti politik, respektivisht në llogarinë e G.G, për vajzën e tij kandidaten për deputete M.G, A.Z, I. K, F.S, F.S, F.S, B.D, A.Sh, B.S, B.R, A.T, F.B.K, V.B.R,V.D, A.U, M.S.K, S. F, F.R, R.S për kandidaten për deputete R.S, lidhur me fushatën e bërë në rrjetin social Facebook, në ditën e heshtjes zgjedhore dhe në ditën e votimit. Paraqitësi i ankesës thekson se është bërë shkelje e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme. Parashtruesi i ankesave si provë ka bashkangjitur fotografi të printuara në cilësi të provave materiale.

Në përgjigjet në ankesë të ofruar nga subjekti politik X.X lidhur me ankesën 378/21, konsideron se ankesa e subjektit N.N, është e pabazuar, ngase deklarata apo mesazhi i lëshuar nga G.G është lëshuar nga rrjeti i tij social privat, dhe se i njëjti nuk ka asnjë funksion politik-zyrtar në strukturat e X.X, qoftë degë apo nëndegë.

## Arsyetimi i Panelit – PZAP



Në përgjigjet në ankesë të ofruar nga subjekti politik X.X lidhur me ankesën 378/21, konsideron se ankesa e subjektit N.N, është e pabazuar, ngase deklarata apo mesazhi i lëshuar nga G. G është lëshuar nga rrjeti i tij social privat, dhe se i njëjti nuk ka asnjë funksion politik-zyrtar në strukturat e X.X, qoftë degë apo nëndegë.

Lidhur me ankesën Anr.420/2021, parashtruesi i përgjigjes në ankesë thekson se fotoja dhe videoja e postuar – sponsorizuar nuk kanë qenë aktive në ditën e heshtjes zgjedhore 13 shkurt 2021, dhe për këtë keni të bashkangjitur foto – dëshmitë si provë. Fotoja ka përfunduar së sponsorizuar me 12 shkurt 2021, kurse videoja me 11 shkurt 2021.



Ndërsa lidhur me ankesën Anr.449/2021, parashtruesi i përgjigjes në ankesë thekson se ankesa nuk është e plotë për arsye se postimi i shpërndarë nga R.S nuk nënkupton postim të drejtpërdrejtë nga kandidatja për deputete R.S, madje R.S nuk është anëtar i strukturave të X.X, dhe kontrolli i gjithsecilit votues të subjektit politik është i pamundur.

Ndërsa për ankesat e tjera që janë të bashkuara në këtë vendim, për të gjitha e ka bërë përgjigjen e njëjte subjekti politik X.X, ku deklarojnë se ankesat e subjektit politik N.N nuk janë të bazuara, për arsye se fotot dhe videot e shpërndara – sponsorizuara në rrjetet sociale nga kandidatët për deputet të N.N, nuk janë në kundërshtim me pretendimin ankimor, gjegjësisht shkeljen sipas nenit 8, par.1, pika c) e Rregullës Zgjedhore 13/2013 të KQZ-së shprehimisht thotë “shfrytëzimi i megafonave ose i sistemeve të tjera për t’iu drejtuar publikut kudo qoftë në Kosovë me qëllim të ndikimit në votues, ose organizimi i çfarëdo manifestimi, procesimi ose demonstrate të natyrës publike ose pjesëmarrjes në të”, nuk ka të bëjë fare me rastin dhe nuk qëndron as ligjërisht e as nuk argumentohet juridikisht në asnjë rrethanë.

Parashtruesi i përgjigjes në ankesë si dëshmi për pretendimet e tyre ka bashkangjitur edhe fotografi si prova materiale.

Paneli, paraprakisht ka vlerësuar se ankesat: Anr.378/2021 e datës 13.02.2021, Anr.420/2021, Anr.421/2021, Anr.422/2021, Anr.423/2021, Anr.424/2021, Anr.425/2021, Anr.426/2021, Anr.427/2021, Anr.428/2021, Anr.429/2021, Anr.430/2021, Anr.431/2021, Anr.432/2021, Anr.433/2021, Anr.434/2021, Anr.436/2021, Anr.437/2021 dhe Anr.449/2021, të datës 14.02.2021, janë për nga përmbajtja të njëjta, për nga natyra e shkeljes së pretenduar janë të njëjta, paraqitës i të gjitha ankesave është N.N, me seli në Prishtinë, dhe po ashtu të njëjtat janë paraqitur kundër subjektit të njëjtë politik, X.X, me seli në Prishtinë, prandaj Paneli, bazuar në nenin 8 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave Nr.02/2015, të PZAP-it, në të cilën përcaktohet se: “Me qëllim të lehtësimit të shqyrtimit të ankesave kryesuesi i panelit vendimmarrës mund të vendos ta bëjë bashkimin e ankesave që përmbajnë në vete çështje të ngjashme dhe se ato ankesa të trajtohen me një vendim”, bëri bashkimin e ankesave dhe për të njëjtat vendosi me një vendim, si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të bazueshmerisë së ankesave dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, provave materiale - fotografive të bashkangjitur, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

### **Ankesat janë të bazuara**

Nga shkresat e lëndës shihet se si subjekti politik N.N dhe kandidatët e tyre për deputetet në Kuvendin e Republikës së Kosovës nga radhët e subjektit politik, gjatë heshtjes zgjedhore dhe ditës së votimit në rrjetin e saj social facebook kanë bërë fushatë zgjedhore dhe kanë udhëzuar që të votohet subjekti i tyre dhe kandidatët e subjektit politik në fjalë, ku me këtë veprim ka bërë thyerjen e heshtjes zgjedhore.

Paneli, konform nenit 8 par. 5 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.02/2015, ndërmori hetim lidhur me pretendimet e paraqitësit të ankesës, dhe gjeti se të njëjtat janë të bazuara, për faktin se në llogaritë e Facebook-ut të lartë cekura, ashtu siç pretendon paraqitësi i ankesës, në ditën e heshtjes zgjedhore dhe në ditën e votimit janë hasur reklama politike aktive, të cilat promovojnë subjektin politik N.N, dhe kandidatët për deputet nga radhët e këtij subjekti politik, ku me këtë veprim kanë bërë thyerjen e heshtjes zgjedhore.

## Shënim

Paneli, vendimin e tij e mbështet në dëshmi të qarta dhe bindëse, konform nenit 117 par.3 të LZP-së, Paneli, vlerëson se gjoha e shqiptuar si masë, përveç aspektit të dënimit në raport me subjektin që nuk e ka respektuar Kodin e Mirësjelljes, shërben edhe si masë preventive që në të ardhmen subjektet politike të përmbahen nga veprimet e tilla që bien ndesh me rregullativën ligjore, që cenojnë të drejtën apo lirinë e votimit, në mënyrë që të sigurohet klimë e qetë dhe e përshtatshme për votim të lirë dhe të pa ndikuar si bazament i një procesi demokratik zgjedhor.

Nëse subjekti të cilit i është shqiptuar dënimi nuk e paguan të njëjtin brenda afatit të përcaktuar në dispozitiv të tij, atëherë në pajtim me nenin 120.2 të LZP-së, subjektit do ti shqiptohet dënim shtesë. Ky paralajmërim për dënim shtesë është përcaktuar me nenin 120.2 të LZP, i cili përcakton: “ 120.2 Dështimi për të paguar dënimin apo për t'ju bindur një urdhërese të PZAP-it brenda periudhës kohore të saktësuar në vendimin e PZAP-it, është një shkelje tjetër e këtij ligji që mund të sanksionohet me dënim shtesë nga PZAP-i.”

Në këtë rast PZAP-i, ka aprovuar ankesën pasi që në llogaritë e Facebook-ut te kandidatëve të subjekteve politike në ditën e heshtjes zgjedhore dhe në ditën e votimit janë hasur reklama politike aktive, të cilat promovojnë subjektin politik N.N, dhe kandidatët për deputet nga radhët e këtij subjekti politik, ku me këtë veprim kanë bërë thyerjen e heshtjes zgjedhore.

Andaj këto veprime janë të ndaluara sponsorizimi dhe bërja e fushatës zgjedhore nëpërmjet facebookut dhe mjeteve të tjera elektronike

Ndërsa neni 120.2 përcakton se në rast se subjekti politik i gjobitur dështon për të paguar dënimin apo për t'ju bindur një urdhërese të PZAP-it, brenda periudhës kohore të saktësuar në vendimin e PZAP-it, është një shkelje tjetër e këtij ligji që mund të sanksionohet me dënim shtesë nga PZAP-i.

## Parashtruesi i çështjes, Subjektet politike N.N dhe X.X kanë paraqitur ankesat kundër subjektit politik A.A, me të cilën pretendon se në ditën e heshtjes zgjedhore subjekti politik A.A ka mbajtur tubim politik, dhe ka bërë fushatë zgjedhore

### Lidhur me këtë çështje PZAP-i, ka nxjerr Vendimin Anr.439/2021 të datës 16.02.2021

**Faktet e Çështjes-** PZAP-i, më datën 14.02.2021, ka pranuar ankesat Anr.439/2021, nga subjekti politik N.N, dhe ankesën Anr.470/2021 nga X.X.

Në ankesën Anr.439/2021 të N.N pretendohet se gjatë ditës së heshtjes zgjedhore subjekti politik A.A ka mbajtur tubim politik për të cilën si provë kanë bashkangjitur CD, ku dëgjohet dhe shihet video dhe audio – incizimi. Duke vepruar kështu subjekti politik A.A ka bërë shkelje të Ligjit nr.03/L-073, për zgjedhjet e përgjithshme. Gjithashtu ka theksuar se N.N për shkeljen e supozuar është njoftuar me datë 14.02.2021, andaj në afatin e paraparë brenda 24 orëve ka parashtruar ankesë në PZAP. Ka propozuar që subjektit A.A të aplikohen dispozitat për Kategorizimin e sanksioneve të Gjykatës.

Subjekti politik X.X në ankesën e tyre Anr.470/2021 pretendojnë se me datën 13.02.2021 rreth orës 13:00 A.A ka mbajtur një takim me qytetarë në ambientet e hotel “Afa” në Prishtinë, në këtë tubim me qytetarë kanë marrë pjesë anëtarë të strukturave udhëheqëse të A.A, përfshirë edhe kryetarin e këtij subjekti, A.K, Me këtë parashtruesi i ankesës pretendon se A.A ka shkelur dispozitat ligjore, përkatësisht të rregullës zgjedhore Nr.13/2013. Si provë kanë bashkangjitur një CD me përmbajtje të videos.

### Arsyetimi i Panelit – PZAP



Në përgjigjet e ankesave A.A, thekson se nga provat e bashkangjitura (audio - video - incizimi), në asnjë mënyrë parashtruesit e ankesës nuk e kanë argumentuar pretendimin e tyre të paraqitur në ankesë. Subjekti politik A.A, ditën e heshtjes zgjedhore nuk ka organizuar asnjë tubim politik. Pamjet filmike të paraqitura në portalin “Insajder”, në të cilat parashtruesi i ankesës i mbështet thëniet e ankesës nuk janë pamje të incizuara në selinë e A.A. Nga këto pamje me zë dhe figurë mund të konstatohet se ato janë marr nga një sall hoteli ku shihen një grup personash por assesi nuk mund të konstatohet se njerëzit që shihen brenda në këto pamje janë organizuar nga A.A dhe aq më pak në një tubim politik. Ka propozuar që të ankesat të refuzohen si të pa bazuara. Paneli, paraprakisht ka vlerësuar se ankesat: Anr.439/2021 dhe Anr.470/2021, të dyja të datës 14.02.2021, të cilat për nga përmbajtja janë të njëjta, për nga natyra e shkeljes së pretenduar janë të njëjta, paraqitës të ankesave janë subjekti politik N.N dhe X.X, dhe po ashtu të njëjtat janë paraqitur kundër subjektit të njëjtë politik, A.A, prandaj Paneli, bazuar në nenin 8 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave Nr.02/2015, të PZAP-it, në të cilën përcaktohet se: “Me qëllim të lehtësimit të shqyrtimit të ankesave kryesuesi i panelit vendimmarrës mund të vendos ta bëjë bashkimin e ankesave që përmbajnë në vete çështje të ngjashme dhe se ato ankesa të trajtohen me një vendim”, andaj paneli edhe bëri bashkimin e ankesave dhe për të njëjtat vendosi me një vendim, si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli, pas shikimit dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, provave që gjenden në shkresat e lëndës, CD-së, si dhe përgjigjes në ankesë, erdhi në përfundim se ankesa është e bazuar. Nga prova e bashkangjitur me ankesë CD, shihet qartë se subjekti politik A.A ka thyer heshtjen zgjedhore duke mbajtur tubim politik.

Në raport me pretendimet e subjektit politik A.A të parashtruara në përgjigjet e ankesave, se pamjet e bashkangjitura nuk janë pamje të xhiruara në selinë e A.A, këtë pretendim Paneli e vlerësoi si jo relevant dhe pa ndikim në vendosje.

Në rastin konkret nuk ka rëndësi se ku mbahet tubimi, e rëndësishme është se kur është mbajtur takimi, numri i personave që kanë prezantuar pra masa, pastaj nën organizimin e kujt është bërë takimi, dhe nga video – incizimi shihet qartë se nga po i njëjti subjekt është organizuar ky tubim, gjë që me këtë veprim ka bërë shkelje të heshtjes zgjedhore.

Përveç kësaj edhe sikur takimi në fjalë mos të ishte organizuar nga subjekti A.A, kjo nuk e përjashton përgjegjësinë e subjektit, meqenëse pjesëmarrësit në këtë takim identifikohen me shenja dhe logo se janë aktivistë të subjektit në fjalë.

Paneli i shqyrtoi edhe pretendimet tjera të subjektit A.A, por nuk gjeti asnjë argument apo provë bindëse që dëshmon së audio – incizimi, nuk ka të bëjë me këtë subjekt.

Nga zëri që dëgjohet nga pjesëmarrësit në takim, masa në momente të caktuara elektrizohet dhe fillon të brohoras emrin e kryetarit të subjektit politik A.A A. K, gjë që pa dyshim vërteton faktin se organizimi ka qenë nën patronatin e subjektit VV, dhe në takim ka qenë edhe kryetari i subjektit politik dhe kjo përbën shkelje të heshtjes zgjedhore por pesha e shkeljes është më e rëndë, pasi subjekti në fjalë është i njoftuar me rregullat që e karakterizojnë procesin zgjedhor dhe detyrimet e subjekteve politike se si duhet të sillen gjatë procesit.

## Shënim

Me nenin 6 paragrafi 2 i Rregullores Nr.01/2012, për Kategorizimin e Sanksioneve dhe Gjobave të PZAP-it, përcaktohet se: “Në qoftë se subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij bëjnë fushatë në çfarëdo mënyre njëzetekatër (24) orë para hapjes së Qendrave të Votimit, për hedhjen e votës e deri në mbylljen e tyre, i shqiptohet gjoja subjektit politik që është i përfaqësuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës dënohet me gjashtëmijë e pesëqind (6, 500) euro, deri me njëzetepesëmijë (25.000) euro”.

Paneli, vlerëson se gjoja e shqiptuar si masë, përveç aspektit të dënimit në raport me subjektin që nuk e ka respektuar Kodin e Mirësjelljes, shërben edhe si masë preventive që në të ardhmen subjektet politike të përmbahen nga veprimet e tilla që bien ndesh me rregullativën ligjore, që cenojnë të drejtën apo lirinë e votimit, në mënyrë që të sigurohet klimë e qetë dhe e përshtatshme për votim të lirë dhe të pa ndikuar si bazament i një procesi demokratik zgjedhor.

Nëse subjekti të cilit i është shqiptuar dënimi nuk e paguan të njëjtin brenda afatit të përcaktuar në dispozitiv të tij, atëherë në pajtim me nenin 120.2 të LZP-së, subjektit do ti shqiptohet dënim shtesë. Ky paralajmërim për dënim shtesë është përcaktuar me nenin 120.2 të LZP, i cili përcakton: “ 120.2 Dështimi për të paguar dënimin apo për t'ju bindur një urdhërese të PZAP-it brenda periudhës kohore të saktësuar në vendimin e PZAP-it, është një shkelje tjetër e këtij ligji që mund të sanksionohet me dënim shtesë nga PZAP-i.”,

Pala ndaj se cilës ishte bere ankesa ka theksuar se ky tubim nuk është mbajtur ne selinë e subjektit te tyre politik , mirëpo Në rastin konkret nuk ka rëndësi se ku mbahet tubimi, e rëndësishme është se kur është mbajtur takimi, numri i personave që kanë prezantuar pra masa, pastaj nën organizimin e kujt është bërë takimi, dhe nga video – incizimi shihet qartë se nga po i njëjti subjekt është organizuar ky tubim, gjë që me këtë veprim ka bërë shkelje të heshtjes zgjedhore.

Përveç kësaj edhe sikur takimi në fjalë mos të ishte organizuar nga subjekti A.A, kjo nuk e përjashton përgjegjësinë e subjektit, meqenëse pjesëmarrësit në këtë takim identifikohen me shenja dhe logo se janë aktivistë të subjektit në fjalë.

Ndaj këtij vendimi pala e pakënaqur ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme të Kosovës, dhe i njëjti vendim është vërtetuar edhe nga Gjykata Supreme e Kosovës me vendimin e tij A.A.nr.21/2021

**Parashtruesi i çështjes, Subjekti politik N.N dhe Organizata Jo Qeveritare X.X kanë paraqitur ankesat kundër subjektit politik A.A, me të cilën pretendon se në ditën e heshtjes zgjedhore gjatë ditës së votimit subjekti politik A.A ka mbajtur tubim politik, dhe ka bërë fushatë zgjedhore, me të cilën pretendojnë se me datën 14.02.2021, në ditën e mbajtjes së zgjedhjeve, kryetari i A.A dhe njëkohësisht kandidati për kryeministër nga radhët e këtij subjekti politik E.H, ka thyer heshtjen zgjedhore duke bere deklarate publike ne intervistën e tij para mediave pasi ka kryer votimin**

[Lidhur me këtë çështje PZAP-i, ka nxjerr Vendimin Anr.419/2021 të datës 15.02.2021](#)

**Faktet e Çështjes-** PZAP-i, më datën 14.02.2021, ka pranuar ankesën Anr.419/2021, nga Subjekti Politik N.N, me seli në Prishtinë, si dhe ankesën A.nr.438/2021 e datës 14.02.2021 e X.X, me të cilën pretendojnë se me datën 14.02.2021, në ditën e mbajtjes së zgjedhjeve, kryetari i A.A dhe njëkohësisht kandidati për kryeministër nga radhët e këtij subjekti politik E.H, ka thyer heshtjen zgjedhore duke bere deklarate publike ne intervistën e tij para mediave pasi ka kryer votimin.

Parashtruesit e ankesave theksojnë se gjate prononcimit para mediave kryetari i subjektit politik A.A thekson se “ Sot është dita e kur flasin qytetaret, jo politikanet por është dita kur flasin qytetaret e Kosovës dhe ne mendojmë qe sot qytetaret e Kosovës janë para dy opsioneve, para opsionit të rimëkëmbjes ekonomike dhe stabilitetit politik dhe të integritetit ndërkombëtar apo para misionit të mjegullës dhe të mjegullës së izolimit ndërkombëtar, prandaj unë pres vendimin që do ta marrin qytetarët dhe verdiktin që do ta japin sot gjatë ditës, është verdikti ma i rëndësishëm” Subjekti politik A.A në fushatë zgjedhore ka pasur sloganin “Rimëkëmbje” të cilin slogan kandidati për kryeministër i këtij subjekti politik e theksoj në intervistën para mediave. Parashtruesit e ankesave theksojnë se subjekti politik e ka thyer heshtjen zgjedhore të sanksionuar me nenin 36 paragrafi 1 pika b) te LZP-se si dhe nenin 8 paragrafi 1 pika c) të Rregullës Zgjedhore 13/2013 të KQZ-s

## Arsyetimi i Panelit – PZAP



Paneli, në bazë të nenit 13 paragraf 2, të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka vendosur të bashkon ankesat e lartcekura dhe ti trajton si një ankesë, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve, dhe për të gjitha të vendos me një vendim për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

Në përgjigjen në ankesë subjekti politik A.A, thekson se këto pretendime nuk qëndrojnë për faktin se fjalët e përdorura rimëkëmbje ekonomike nuk aludojnë ne sloganin e PDK-se Rimëkëmbje, pasi qe kjo shprehje është përdorur nga te gjitha partitë politik e si proces dhe kuptimi i mirëfilltë i fjalëve i referohet aspektit dhe

shprehjes ekonomike, dhe se për më shumë kjo shprehje është përdorur në vazhdimësi edhe nga liderët e partive tjera që janë edhe kandidat për kryeministër si z A.H dhe z A.K, si dëshmi për këtë ka paraqitur linqet e publikuara. Me tutje në përgjigjen në ankesë theksohet se deklarimi për media i E.H ishte pas votimit në qendrën përkatëse të votimit dhe deklarimi i tij për media përkon me të gjitha mesazhet politike që i adresojnë të gjithë akterët politik dhe në asnjë mënyrë ky deklarim dhe shprehjet e përdorura nuk kane të bëjnë me fushatë zgjedhore dhe si i tillë nuk bie ndesh me asnjë dispozitë ligjore dhe aq më pak me nenin 36 pika b) të cilës i referohet pala ankuese. E njëjta thekson se me qëllim të respektimit të heshtjes zgjedhore në konferencën e organizuar gjatë ditës së votimit subjekti politik A.A i ka hijezuar dhe mbuluar në tërësi sloganin Rimëkëmbje i cili ishte i vendosur në prapavijën e sallës në të cilën mbahen konferencat. Përkundër kësaj e njëjta thekson se me datën 02.02.2021 përmes njoftimit zyrtar dhe publik në ueb faqen e partisë dhe në rrjetet sociale kanë adresuar thirrjet për respektimin e fushatës dhe të rregullave që janë përcaktuar me legjislacionin në fuqi, andaj të njëjtit konsiderojnë se është e pa drejte dhe jo etike që të tentohet një manipulim i tillë kur dihet fakti se subjekti politik A.A, ka kërkuar publikisht nga të gjithë kandidatët për deputet anëtarët, mbështetësit dhe përkrahësit e tyre që ta respektojnë Kodin e Mirësjellje për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe kandidatët. Me propozim për panelin që ankesat të refuzohet si të pabazuara.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës, gjeti se: **Ankesat janë të bazuara**

Paneli, pas shikimit dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, ka gjetur dhe ka vërtetuar se kryetari i Subjektit Politik A.A E.H, me qëllim të promovimit të subjektit të tij politik dhe kandidatëve të tyre, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, gjatë ditës së votimit, me datë 14.02.2021 përmes mediave publike ka thyer heshtjen zgjedhore, përmes “Sot është dita e kur flasin qytetaret, jo politikanet por është dita kur flasin qytetaret e Kosovës dhe ne mendojmë që sot qytetaret e Kosovës janë para dy opsioneve, para opsionit të rimëkëmbjes ekonomike dhe stabilitetit politik dhe të integritetit ndërkombëtar apo para misionit të mjegullës dhe të mjegullës së izolimit ndërkombëtar, prandaj unë pres vendimin që do ta marrin qytetarët dhe verdiktin që do ta japin sot gjatë ditës, është verdikti ma i rëndësishëm”, ky komunikim në tërësinë e fjalisë së tij jo vetëm që thekson sloganin e partisë së A.A, me të cilën ka garuar në zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, por njëherit nga vet konstruksioni i fjalisë që ka dhënë rezulton se kemi të bëjmë me thyerjen e heshtjes zgjedhore.


Lidhur me pretendimet në përgjigje në ankesë të Subjektit A.A, se ky slogan është përdorur edhe nga liderët e subjektet e tjera politike dhe se ky deklarim ishte pas votimit në qendrën e votimit Paneli vlerëson se këto pretendime janë të paqëndrueshme sepse gjatë ditës së votimit kryetari i subjektit politik ka kërkuar që të votohet subjekti i ti politik A.A duke përdorur sloganin Rimëkëmbje të cilin ky subjekt politik këtë slogan e ka pasur gjatë fushatës zgjedhore, fakt ky që KQZ-ja ka certifikuar sloganin e tillë të subjektit politik A.A. Nga përgjigja në ankesë e A.A -se, Paneli gjeti se subjekti politik përkatësisht Kryetari i A.A E.H, gjatë ditës së votimit ka dhënë deklaratë para mediave duke përmendur sloganin e A.A -se gjatë fushatës zgjedhore dhe duke theksuar fjali të tjera të theksuara si më lartë që konsistojnë në thyerjen e heshtjes zgjedhore. Andaj me këtë rast Paneli, vlerëson se ka ndodhur thyerja e heshtjes zgjedhore veprime këto të ndaluara me nenin 36 paragrafi 1 pika b) e LZP-së. Adresimi i zakonshëm para mediave siç është bërë praktikë e rëndomtë e të gjitha shteteve

demokratike për nxitje, për të votuar në mënyrë të lirë dhe masovike është keqpërdorur nga kryetari i subjektit garues përmes thirrjes së hapur të qytetarëve se për kënd duhet të votohet, cenon rëndë lirinë e përcaktimit të qytetarit me rastin e votimit. Cenimi i lirisë së votimit përmes thirrjes publike paraqet tendencë për ndërhyrje të pastër në proces zgjedhor, përmes përçimit të mesazhit të ndikimit dhe kështu e drejta e votimit të lirë cenohet. Kur veprimeve të kryetarit të subjektit politik A.A, kur merret parasysht edhe fakti se ai si kandidat për kryeministër nga subjekti politik A.A dhe si kryetar i këtij subjekti politik, në mënyrë të hapur fton për votim në ditën e votimit me qëllimin e vënies se theksit të slogani identifikues, përbën ndikim indirekt të qytetarit.

## Shënim

*Në këtë rast Paneli, vlerëson se subjekti politik i lartpërmendur ka bërë shkelje të Kodit Të Mirësjelljes Për Subjektet Politike, Mbështetësit e Tyre Dhe Kandidatët, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 36 paragrafi 1 pika b) e LZP-së, që përcakton veprimet e ndaluara para procesit të votimit, ku përcaktohet se 24 orë, para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e votës, deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndalohet bërja fushatë në çfarëdo mënyre. Me nenin 120 paragraf 1 pika c) të LZP-së, i dhe me nenin 6 paragrafi 2 i Rregullores Nr.01/2012, për Kategorizimin e Sanksioneve dhe Gjjobave të PZAP-it, përcaktohet se: “ Në qoftë se subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij bëjnë fushatë në çfarëdo mënyrë njëzetekatër (24) orë para hapjes së Qendrave të Votimit, për hedhjen e votës e deri në mbylljen e tyre, i shqiptohet gjoba subjektit politik që është i përfaqësuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës dënohet me gjashtëmijë e pesëqind (6, 500) euro, deri me njëzetepesëmijë (25.000) euro”. Paneli, me rastin e shqiptimit të gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, u mbështet në dispozitat e lart cituara, e në veçanti duke marr parasysht rrethanat e rastit. Paneli, vlerëson se gjoba e shqiptuar si masë, përveç aspektit të dënimit në raport me subjektin që nuk e ka respektuar Kodin e Mirësjelljes, shërben edhe si masë preventive që në të ardhmen subjektet politike të përmbahen nga gjuha e tillë dhe veprimet që bien ndesh me rregullativën ligjore, që cenojnë të drejtën apo lirinë e votimit, në mënyrë që të sigurohet klimë e qetë dhe e përshtatshme për votim të lirë dhe të pa ndikuar si bazament i një procesi demokratik zgjedhor. Përveç të cekurave më lartë Paneli, me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e subjektit politik A.A, në kuadër të pretendimeve të theksuara në përgjigje në ankesë, mirëpo të njëjtët ishin jo relevante dhe pa ndikim për një vendimmarrje ndryshe nga ajo që është vendos. PZAP-i vendosi që nëse subjekti të cilit i është shqiptuar dënimi nuk e paguan të njëjtin brenda afatit të përcaktuar në dispozitiv të tij, atëherë në pajtim me nenin 120.2 të LZP-së, subjektit do ti shqiptohet dënim shtesë. Ky paralajmërim për dënim shtesë është përcaktuar me nenin 120.2 të LZP, i cili përcakton: “ 120.2 Dështimi për të paguar dënimin apo për t'ju bindur një urdhërese të PZAP-it brenda periudhës kohore të saktësuar në vendimin e PZAP-it, është një shkelje tjetër e këtij ligji që mund të sanksionohet me dënim shtesë nga PZAP-i.” Kundër këtij vendimi subjektit politik A.A ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme të Kosovës, por e njëjta e ka refuzuar ankesën e palës ankuese dhe ka vërtetuar vendimin e PZAP-it duke e lënë të njëjtin në fuqi. Vendim i PZAP-it Anr.419/2021, i datës 15.02.2021, është vërtetuar me Vendimin e Gjykatës Supreme me numër A.A.20/2021 të datës 19.02.2021*





Në këtë pjesë janë përzgjedhur vendimet të cilat i referohen ditës së votimit për zgjedhjet e parakohshme të vitit 2019 të mbajtura për Kuvendin e Republikës së Kosovës

## Parashtruesi i çështjes, Subjekti politik N.N. ka paraqitur ankesë kundër subjektit politik X.X për shkak të presionit ndaj votuesve, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 14.02.2021

### Lidhur me këtë çështje PZAP-i, ka nxjerr Vendimin Anr.457/2021 të datës 15.02.2021

**Faktet e Çështjes-** Me datën 14.02.2021, PZAP-i ka pranuar ankesën nga N.N, me të cilën pretendohet se aktivistët e N.N kanë vërejtur se portali, Indeksonline ka raportuar që komisioneri i X.X në komunën e Shtërpçës në qendrën e votimit në shkollën fillore “Staja Markovic” ka thyer rregullat zgjedhore, duke thyer parimin e paanshmërisë dhe duke ushtruar presion mbi votuesit, për t’u përcaktuar atyre se për kë të votojnë. Më tutje në ankesë pretendohet se nga lajmi gazetaresk i Indeksonline, provohet se komisioner të tjerë kanë raportuar se komisioneri i Listës Serbe, duke shkelur rregullat dhe përgjegjësitë e komisionerit nuk ka dhënë informata të paanshme për subjektet politike, duke ushtruar presion ndaj votuesve dhe kjo mund të dëshmohet me lajmin dhe videon e bashkangjitur në portal.

Sipas pretenduesit të ankesës në këtë rast komisioneri i X.X, ka kodin e sjelljes për anëtarë të KKZ-ve të sanksionuar me nenin 68 par.1 pika c) të LZP-së dhe pikën b) të Shtojcës IV të Kodit të Sjelljes së Anëtarëve të KKZ të Rregullës Zgjedhore 18/2016 të KQZ-së

Parashtruesi i ankesës lidhur me pretendimet e tij ka shënuar linkun e indksonline si provë lidhur me rastin.

### Arsyetimi i Panelit – PZAP



Në përgjigjen në ankesë të subjektit politik N.N të datës 15.02.2021 konsiderojnë se këto pretendime të ankuesit janë absolutisht të pa bazuara, sepse sipas kontrollit të tyre, në qendrën e votimit, anëtar i komisionit në tavolinën ndihmëse, informoj qytetarët ku ata mund të ushtrorjnë të drejtën e tyre të votimit në vendvotimin e përmendur, siç theksoj se është detyrë e personelit në fjalë të angazhuar nga KQZ-ja. Më tutje theksohet se personi në fjalë në asnjë mënyrë nuk ka sugjeruar, dhe në asnjë mënyrë tjetër nuk ndikoi në vullnetin zgjedhor dhe të drejtën të e qytetarëve. Në vazhdim të përgjigjes pretendojnë se qytetari kërkoi, që ti shpjegohej se në cilën klasë apo vendvotim mund të praktikonte të drejtën për të votuar, sepse ndryshimet në listën e zgjedhësve, dhe zvogëlimi i numrit të vendvotimeve ndryshuan vendvotimin e personave me atë mbiemër nga zgjedhjet e mëparshme. Kjo ngjarje pretendojnë se nuk ishte regjistruar në procesverbal, në vet qendrën e vendvotimit dhe se ka shume dëshmitarë të cilët e mohojnë shkeljen e pretenduar. Lidhur me median Indeks Online, në përgjigjen e tyre pretendojnë se është larguar ky informacion, siç theksojnë se ata e kuptuan se shkelja e pretenduar nuk ekzistonte. Subjekti politik N.N propozon PZAP-in që ankesën ta refuzoj si të pabazuar.


Nga pretendimet në ankesë lidhur me presionin ndaj votuesve të paraqitura nga Indeksonline, paneli vlerësoi se janë të paqëndrueshme sepse nuk ka asnjë informatë lidhur me këto pretendime. Në linkun e shënuar në ankesë të Indeksonline është tentuar për gjetjen e njëjtës video por e njëjta është tërhequr dhe nuk ka videoinqizim siç është pretenduar në ankesë se është bërë presion ndaj votuesve, por shihet vetëm një fotografi me një person duke kontrolluar lejen e identifikimit. Ndërsa nga provat që gjenden në shkresat e lëndës parashtruesi i ankesës nuk i ka mbështetur me prova pretendimet e tij se subjekti politik Lista Serbe, ka bërë shkelje nga dispozita ligjore të nenit 34 par.1 dhe 2 të LZP-së, ashtu siç pretendohet në ankesë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën gjeti se: **Ankesa është e pabazuar**

## Shënim

*Paneli gjatë vendosjes së ankesës i ka shqyrtuar dhe hetuar me kujdes të gjitha provat dhe ka vërtetuar në mënyrë të padyshimtë, se pretendimet ankimore janë të pabazuara në ligj sepse të njëjtat, nuk mbështeten me asnjë provë nga parashtruesi i ankesës, andaj ankesa e ankuesit u refuzua si e pabazuar në kuptim të nenit 118 të LZP-së. Nisur nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.*

*Në këtë rast PZAP-i kishte refuzuar ankesën pasi që pala ankuese me asnjë provë nuk i ka argumentuar pretendimet e tija ashtu siç e parasheh neni 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: “vendosja për apelet dhe ankesat nga PZAP-i mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”.*



Në këtë pjesë janë përzgjedhur vendimet të cilat i referohen rezultateve përfundimtare për zgjedhjet e parakohshme të vitit 2019 të mbajtura për Kuvendin e Republikës së Kosovës

## Parashtruesi i çështjes, Subjektet politike NN, XX dhe YY kishin parashtruar apel ndaj vendimit të KQZ-së, për shkak se votat e fituara ishin në disproporcion me numrin e banorëve të komuniteteve, në disa komuna

Lidhur me këtë çështje PZAP-i, ka nxjerr Vendimin Anr.656/2021, të datës 07.03.2021

**Faktet e Çështjes-** subjektet politike NN, XX dhe YY kanë paraqitur apel kundër vendimit të KQZ-së nr.860-2021 të datës 04.03.2021, për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvendin e Kosovës, të mbajtura me 14 Shkurt 2021.

Pretendimet ankimore të parashtruesve të apeleve kishin të bëjnë me votat e përgjithshme të partive boshnjake të cilat shënuan rritje për 49% në krahasim me zgjedhjet e kaluara, rreth 6000-7000 vota. Rreth 90% të këtyre votave për këtë parti vijnë nga komunitetit serbe mandej edhe në komunat ku nuk banon as edhe një boshnjak i vetëm partia e NN kishte arritur të marre qindra vota, përderisa partitë specifike jo serbe në këtë manipulim NN, Koalicioni XX dhe BB morën mbi 9000 vota, nga banoret e komunave serbe.

Me anë të këtyre apeleve kërkohet nga PZAP-i, të ndërmarr veprimet e nevojshme dhe të rishikohen të gjitha vendvotimet ku ka ardhur deri tek manipulimet me trupin votues në komunat e banuara me shumice serbe

### Arsyetimi i Panelit – PZAP



Me datën 05.03.2021 PZAP-i, ka pranuar apelet Anr.656/2021, Anr.733/2021 dhe A.nr.735/2021 të paraqitura nga subjektet politike NN, me seli në Mitrovicë, XX me seli në Prizren si dhe YY me seli në Prizren, kundër vendimit të KQZ-së, 860-2021 të dt.04.03.2021 në të cilën pretendohet se në zgjedhjet e 14 Shkurtit 2021, votat e përgjithshme të partive boshnjake shënuan rritje për 49% në krahasim me zgjedhjet e kaluara rreth 6000-7000 vota, me tepër se kudo here tjetër. Një rritje e tille enorme e votës se përgjithshme boshnjake erdhi për një arsye të vetme ku si asnjëherë me pare mijëra votues të komunitetit serb në Kosovë votuan për përfaqësuesit boshnjak, përderisa në zgjedhjet e vitit 2019 përfaqësuesit boshnjak kishin arritur qe ti fitonin bashkërisht në komunat serbe vetëm 195 vota, në zgjedhjet e 14 Shkurtit 2021, partitë boshnjake fituan në këto komuna 6446 vota një rritje prej 3205%. Rritja e tille e votës për përfaqësuesit boshnjak nuk ishte votë e krijuar spontanisht dhe në mënyrë natyrale nga komuniteti serb, në fakt ajo ishte votë tërësisht e manipuluar dhe dirigjuar nga faktorë tjerë. Në këto zgjedhje NN fitoi plotë 6379 vota pa numëruar ato me kusht dhe me postë. Këto vende janë të garantuara për komunitetet përkatëse dhe supozohet se vota vjen pikërisht nga komuniteti i njëjtë me atë që deklarohet se përfaqëson komunitetin që konkurron për deputet. Si në Kosove ashtu edhe gjetiu për realizimin efektiv të demokracisë konsciacionale nuk mjafton vetëm deklarimi se personi përfaqëson një komunitet të vetëm por duhet të ekzistoj edhe lidhja objektive në mes të këtij deklarimi dhe përkatësisë se dhënë etnike, gjuhësore, fetare, nacionale etj,

kjo behet e qartë në praktiken gjyqësore evropiane për te drejtat e njeriut, që sipas nenit 53 të Kushtetues zbatohet nga çdo autoritet publik në Kosovë.

Në bazë të Rregullës Zgjedhore Nr. 06/2013, secili Formular i Rezultateve, para se të filloj të procedohet, i nënshtrohet procesit të auditimit në QNR, gjatë të cilit proces krahasohen votat e Procedura e QNR-së, nuk lejon asnjë Formular të Rezultateve të kalojë (të procedohet si i rregullt) nëse nuk përputhen votat e subjekteve me votat e kandidatëve, që do të thotë se nëse subjekti nuk ka vota dhe kandidatët kanë vota, atëherë Formulari nuk procedohet si i rregullt dhe shkon në auditim. Po ashtu, në rastet kur subjekti ka vota dhe kandidatët nuk kanë vota, Formulari nuk procedohet i rregullt dhe shkon në auditim.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, me rastin e gjeti se:

**Apelet janë pjesërisht të bazuara**- Pas zhvillimit të hetimeve për të vërtetuar gjendjen faktike, shqyrtimit të pretendimeve ankimore, provave që gjinden në shkresat e lëndëve, materialin zgjedhor dhe pas vlerësimit të gjithanshëm të tyre Paneli, erdhi në përfundim se ankesat janë pjesërisht të bazuara, për arsye se: votat e marra nga NN dhe Koalicioni - XX, ishin në disproporcion me numrin e banorëve të komunitetit boshnjak, komunitet që i përkasin edhe subjektet ankuuese por edhe subjekti i atakuar, paraqesin vota të pavlefshme, për faktin se është standard jodemokratik, që me votat e votuesve të një komunitetit të sigurohet e drejta e përfaqësimit të një komuniteti tjetër dhe si të tilla nuk paraqesin lidhja objektive në mes të votuesit dhe subjektit të votuar. Për herë të parë në zgjedhjet e përgjithshme të Republikës së Kosovës, subjekte të caktuara si në këtë rast NN dhe Koalicioni – XX, kanë marrë shumicën e votave nga komuniteti serb, gjë që në këtë rast paraqet devijim të vullnetit të votuesit të komunitetit boshnjak, e krejt kjo në thelb paraqet minim të procesit zgjedhor por edhe të integritetit të këtij procesi. Po ashtu, në raport me pakicat ekzistojnë standarde ndërkombëtare sipas të cilave shtetet përkatëse duhet të themelojnë praktika apo mekanizma të atillë, që u mundësojnë pjesëtarëve të pakicave votim të lirë, krijimin të subjekteve të tyre si dhe parandalimin e çdo lloj diskriminimi për të zgjedh dhe për tu zgjedhur.

## Shënim

*Paneli, në bazë të nenit 13.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, i ka bashkuar apelet e lartcekura dhe të njëjtat i trajton si një apel, të evidentuar me Anr.656/2021, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve për çka të gjitha i vendosi me një vendim për hire të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.*

*E drejta e votës dhe liria e votimit sipas vlerësimit të Panelit, në rastin e vendeve të rezervuara nuk është identike me rastin e vendeve jo të rezervuara, pasi për vendet e rezervuara është me rëndësi lidhja objektive në mes të votuesit dhe subjektit të votuar, dhe vetëm kështu sigurohet e drejta e përfaqësimit në kuptim të dispozitave të LPZ-së, dhe në frymën e dispozitave dhe standardeve kushtetuese.*

*Vendet e rezervuara janë garanci kushtetuese të cilat Republika e Kosovës i ka marr, me të vetmin qëllim për trajtimin e avancuar të të drejtave të pakicave në kuadër të institucioneve shtetërore, dhe se anulimi i pjesshëm i votave për subjektet e cekura, ka për qëllim ruajtjen dhe garantimin e të drejtës së përfaqësimit, në raport me përqindjen e popullsisë nga ky komunitet sikurse garantohet me ligj dhe Kushtetutë.*


*Ndaj vendimit të PZAP-it, Anr.656/2021, kishin paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme të Kosovës, subjekti politike XX dhe subjekti politik ZZ. Gjykata Supreme e Kosovës me aktgjykimin AA.nr.30/2021 të datës 11.03.2021, kishte vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të kontestuar të PZAP-it, dhe kishte ardhur në përfundim se ankesat e parashtruara nga subjekti politik XX dhe subjekti politik ZZ janë të papazuara.*



# ZGJEDHJET LOKALE TË MBAJURA NË VITIN 2021

# 2021

Në këtë pjesë janë përzgjedhur vendimet të cilat i referohen para fushatës për zgjedhjet lokale të mbajtura në vitin 2021



**Parashtruesi i çështjes, përfaqësuesi i apelit D.A nga Iniciativa Qytetare X.X., për Drenasin, apel në PZAP, kundër aktit administrativ Nr.779/27.08.2021 të Zyrës për Regjistrim të Partive Politike dhe Certifikim (ZRPPC) të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të kërkesës për ndryshim të emrit të “Inicativës Qytetare X.X për Drenasin” për pjesëmarrje në Zgjedhjet Lokale 2021**

[Lidhur me këtë çështje PZAP-i, ka nxjerr Vendimin Anr.548/2021 të datës 30.08.2021](#)

**Faktet e Çështjes**-Përfaqësuesi i apelit D.A nga Iniciativa Qytetare X.X., për Drenasin, në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), ka paraqitur apel në PZAP, kundër aktit administrativ Nr.779/27.08.2021 të Zyrës për Regjistrim të Partive Politike dhe Certifikim (ZRPPC) të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të kërkesës për ndryshim të emrit të “Inicativës Qytetare X.X për Drenasin” për pjesëmarrje në Zgjedhjet Lokale 2021.

Parashtruesi i apelit D.A, nga Iniciativa Qytetare X.X për Drenasin, me datën 28.08.2021, ka paraqitur apel në PZAP, kundër aktit administrativ Nr.779/27.08.2021 të Zyrës për Regjistrim të Partive Politike dhe Certifikim (ZRPPC) të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me të cilin pretendon se KQZ-ja, e ka zbatuar në mënyrë të gabuar dispozitën e nenit 21 të LZP-së, pasi që i ka kërkuar iniciativës qytetare në fjalë që ta ndërroj emërtimin e tij, me arsyetimin që ky emërtim mund të shkaktoj ngatërrim, apo çorientim të votuesve për shkak që ky emërtim është përdorur nga subjekti politik Y.Y, si platformë politike dhe vazhdon të përdoret ende. Andaj sipas parashtruesit të apelit duke e interpretuar në mënyrë të gabuar, neni 21 paragrafi 1 i LZP-së, i cili parasheh se: “KQZ-ja, nuk e certifikon subjektin politik me emër apo akronim që është i njëjtë si apo sipas gjykimit të KQZ-së, është i ngatërrueshëm, mashtrues ose i ngjashëm me emrin apo akronimin me të cilin një subjekt tjetër politik është certifikuar më herët”. Nga kjo dispozitë rrjedh se një subjekt politik nuk mund të certifikohet nëse emri apo akronimi i tij është i ngjashëm me emrin apo akronimin që një subjekt tjetër, i cili është certifikuar në zgjedhjet e mëhershme. Pra nga ky interpretim mund të konkludohet se emri apo akronimi i një subjekti politik që aplikon për certifikim nuk mund të jetë i njëjtë apo i ngjashëm, ngatërrues, apo mashtrues me emrin e një subjekti tjetër nga zgjedhjet e mëparshme.

Sipas parashtruesit të apelit Y.Y, asnjëherë nuk ka pasur emërtimin “X.X ” apo akronimin “DRD” dhe se ky emërtim nuk ka qene emërtimi me të cilin subjekti politik Y.Y, ka aplikuar në zgjedhjet e kaluara për certifikim dhe nuk është shfaqur as në fletëvotimet e zgjedhjeve asnjëherë më parë si ato të zgjedhjeve parlamentare apo komunale andaj këtu konsiston shkëlja kryesore materiale e KQZ-së, pasi që dispozita e nenit 21 të LZP-së, nuk mbron sloganet por vetëm emrat dhe akronimet e njëjta, ngatërruese, mashtruese apo të ngjashme, përderisa LZP-ja, sanksionon vetëm emërtimet dhe akronimet, andaj kjo dispozite nuk mund të zgjerohet dhe të përfshij edhe sloganet.



Parashtruesi i apelit thekson se me ane te këtij akti juridik, janë duke u cenuar interesat juridike te “Iniciativës Qytetare X.X për Drenasin”, pasi që KQZ-ja, është dashur që të nxjerr vendim me të cilin obligohet që të bëjë ndryshimin e emrit brenda një afati të caktuar dhe jo të procedoj menjëherë me kërkesën për ndërrim të emrit, e i cili në rastin konkret përbën akt real administrativ, pasi që ky akt nuk përmban as dispozitivin e tij me anë të të cilit obligohet ndërrimi i emrit, e i cili element është i detyrueshëm në bazë të nenit 27 të LPA-së dhe se arsyetimi i këtij akti është në kundërshtim me nenin 48 të LPA-së, pasi që i njëjti nuk përmban fakte mbi të cilat është bazuar nxjerrja e vendimit. Parashtruesi i apelit kërkon nga PZAP-i, që të aprovohet ankesa dhe të anulohet akti administrativ Nr. 779-27.08.2021 i KQZ-së, dhe e njëjta ta bëjë certifikimin e Iniciativës Qytetare X.X për Drenasin me emërtimin, akronimin dhe përmbajtjen me të cilën ka aplikuar.

PZAP-i, apelin e parashtruar e ka hudhur si të palejuar, pasi që vlerësoi lejueshmërinë e apelit dhe ka ardhur në përfundim se i njëjti nuk i ka plotësuar kushtet e përcaktuara me nenin 122 të LZP-së, dhe nenin 10 të Rregullës Nr. 02/2015- Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, dhe konstaton se pretendimet ankimore të parashtruara nga D.A, nga Iniciativa X.X për Drenasin, të paraqitur kundër kërkesës me Nr. 779-27.08.2021 të Zyrës për Regjistrim të Partive Politike dhe Certifikim (ZRPPC), të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), lidhur me kërkesën për ndryshim të emrit X.X për Drenasin për pjesëmarrje në Zgjedhjet Lokale 2021, nuk mund të jetë objekt i vlerësimit në këtë fazë të procesit zgjedhor, për faktin se, KQZ-ja nuk ka marrë vendim lidhur me certifikimin apo refuzimin e kësaj iniciative qytetare me emërtimin X.X për Drenasin. Mbi këtë bazë nuk është cenuar e drejta e ankuesit që pas certifikimit të subjektit politik dhe listës së kandidatëve për pjesëmarrjen në gara për Zgjedhjet Lokale të cilat janë mbajtur më 17 Tetor 2021, të paraqes sërish apel, nëse konsideron se i është cenuar e drejta e pretenduar, edhe pas certifikimit të listës nga ana e KQZ-së.

## Arsyetimi i Panelit – PZAP



KQZ-ZRPPC-ja, në përgjigjen në ankesë ka theksuar, Zyra gjatë procesit të shqyrtimit të aplikacionit të “IQ X.X për Drenasin”, e verifikoj edhe kundrejt kriterit të emërtimit të aplikuesit për certifikim sipas nenit 21 te Ligjit për Zgjedhje të Përgjithshme (LZP), i cili thekson: “21.1 KQZ-ja, nuk e certifikon subjektin politik me emër apo akronim që është i njëjtë si, apo sipas gjykimit të KQZ-së, është i ngatërrueshëm, mashtrues ose i ngjashëm me emrin apo akronimin me të cilin një subjekt tjetër politik është certifikuar më herët, 21.2 Nëse dy apo më shumë subjekte politike aplikojnë për certifikim me emra apo akronime që janë të njëjta, apo aq të ngjashme sa që me siguri se do të shkaktojnë ngatërrim apo çorientojnë votuesit, KQZ-ja, vendos se cili subjekt ka të drejtën për t'u certifikuar apo çorientojnë votuesit, KQZ-ja, vendos se cili subjekt ka të drejtën për t'u certifikuar me emrin dhe akronimin. Në vendimin se cili subjekt politik ka të drejtën për t'u certifikuar nën cilin emër dhe akronim, KQZ-ja, ka parasysh datën kur secili subjekt ka dorëzuar aplikimin e tij në KQZ dhe përdorimin paraprak të emrave dhe akronimeve, dhe 21.4 Asgjë në këtë nen nuk e pamundëson certifikimin e kandidatëve të pavarur me

emrin ligjor të tij apo saj.

Në rast se emrat janë të njëjtë, KQZ-ja mund të përfshijë informata për të bërë dallimin e tyre dhe për t'i ikur ngatërrimit në fletëvotim”.

Me procesin e shqyrtimit të aplikacionit për certifikim të “Iniciativës Qytetare X.X për Drenas”, për pjesëmarrje në Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, që do të mbahen me datën 17 tetor 2021, Zyra ka pranuar edhe një shkresë të Partisë Y.Y. Pastaj, Iniciativa Qytetare X.X, me shkresë është njoftuar me përmbajtjen e pretendimeve të Y.Y. Brenda afatit të caktuar z. A. në emër të Iniciativës Qytetare X.X ka kthyer përgjigje duke i hedhur poshtë pretendimet e Y.Y.

Zyra në emër të KQZ, me përkrahjen edhe të Këshillit për Çështje Ligjore të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ka shqyrtuar pretendimet e të dyja palëve dhe ka ardhur në përfundim që emri i Iniciativës Qytetare X.X për Drenas, mund të shkaktoj ngatërrim apo çorientim të votuesit për shkak që ky emër është përdorur nga Partia Demokratike e Kosovës si platformë politike dhe vazhdon të përdoret.

Rrjedhimisht, Zyra i kërkoj Iniciativës Qytetare X.X për Drenas që të ndryshojnë emërtimin, për të ju mundësuar certifikimin. Në të kundërtën, Zyra do të rekomandojë mos-certifikim të iniciativës në fjalë për shkak të mospërputhshmërisë me nenin 21 të LZP-së.

Z. A., në emër të Iniciativës Qytetare X.X për Drenas, me datë 28 gusht 2021, ka dorëzuar shkresën me të cilën njofton që ndërron emërtimin, nga Iniciativa Qytetare X.X për Drenasin, në X.X për Drenasin me akronim DD, por në të njëjtën kohë do ndjek rrugët ligjore për të rikthyer emrin, Dekada e Re për Drenas.

Pasi që iniciativa qytetare ka ndërruar emërtimin sipas kërkesës së Zyrës dhe ka përmbushur të gjitha kriteret tjera ligjore, Zyra ka rekomanduar certifikimin e Iniciativës Qytetare X.X. KQZ ka certifikuar Iniciativën X.X për Drenasin me vendimin numër 2146/2021 të datës 28 gusht 2021, me listën prej një kandidati për kryetar komune dhe 34 kandidat për Kuvend Komunal.

Paneli, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoj të gjitha pretendimet e apelimit, në kuptim të nenit 117 par.2 të LZP-së, gjeti se: **Apeli është i palejuar**

## Shënim

Paneli, vlerësoi lejueshmërinë e apelit dhe ka ardhur në përfundim se i njëjti nuk i plotëson kushtet e përcaktuara me nenin 122 të LZP-së dhe nenin 10 të Rregullës Nr. 02/2015- Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it.

Paneli, konstaton se pretendimet ankimore të parashtruara nga D.A, nga Iniciativa Qytetare X.X për Drenasin, të paraqitur kundër kërkesës me Nr. 779-27.08.2021 të Zyrës për Regjistrim të Partive Politike dhe Certifikim (ZRPPC), të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), lidhur me kërkesën për ndryshim të emrit X.X për Drenasin për pjesëmarrje në Zgjedhjet Lokale 2021, nuk mund të jetë objekt i vlerësimit në këtë fazë të procesit zgjedhor, për faktin se, KQZ-ja nuk ka marrë vendim lidhur me certifikimin apo refuzimin e kësaj iniciative qytetare me emërtimin X.X për Drenasin.

Pra faza kur është parashtruar apeli është e parakohshme sepse nuk kemi vendimmarrje të KQZ-së, për certifikim apo refuzim të subjektit politik dhe listës së tyre me emërtimin X.X për Drenasin, por kemi vetëm kërkesë për ndryshim të emërtimit ndaj iniciativës qytetare të cilit i përket apeluasi, dhe se i njëjti nuk është i obligueshëm të bëjë ndryshimin e emërtimit nëse vlerëson se emërtim është i përshtatshëm dhe në pajtim me nenin 21 të LZP-së.

Meqenëse në rastin konkret nga ana e KQZ-së, nuk është marrë vendim lidhur me këtë çështje juridike, Paneli vlerëson se nuk është nën juridiksionin e këtij institucioni që në këtë fazë të procesit, të vendosë lidhur me kërkesat e ZRPPC-së – KQZ-së, lidhur me ndryshimin e emërtimeve të subjekteve politike, ngase sipas nenit 122 par.1 pikat a), b), c), d), e) dhe f) të LZP-së, PZAP-i, vendos vetëm për vendime të KQZ-së, të cilat përfshihen shprehimisht në dispozitën e sipërsënuar. Në këtë rast, meqenëse nga ana e KQZ-së, nuk është marrë vendim lidhur me certifikimin apo refuzimin e subjektit politik në fjalë për pjesëmarrje në zgjedhje, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Hudhja e ankesës së ankuesit në këtë fazë të procedurës, mbi këtë bazë nuk cenon të drejtën e ankuesit që pas certifikimit të subjektit politik dhe listës së kandidatëve për pjesëmarrjen në gara për Zgjedhjet Lokale të cilat do të mbahen më 17 Tetor 2021, të paraqes sërish apel, nëse konsideron se i është cenuar e drejta e pretenduar, edhe pas certifikimit të listës nga ana e KQZ-së.

Ky Vendim i PZAP-it, me numër Anr.548-2021 i datës 30.08.2021 ishte apeluar në Gjykatën Supreme të Kosovës, e cili me Aktvendimin me nr.A.A.nr.46/2021 të datës 02.09.2021 kishte Refuzuar si të pathemeltë apelin e përfaqësuesit të autorizuar të "Iniciativës Qytetare X.X" dhe ka vërtetuar vendimin e PZAP-it, Anr.548-2021

## **Parashtruesi i çështjes, S.L kandidati për kryetar në Komunën e Skenderajt, nga radhët e subjektit politik X.X, me datën 26.08.2021, nëpërmjet avokatit të tij, V.B, apel në PZAP, kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të largimit nga lista e kandidatëve për pjesëmarrje në Zgjedhjet Lokale 2021**

### Lidhur me këtë çështje PZAP-i, ka nxjerr Vendimin Anr.537/2021 të datës 27.08.2021

**Faktet e Çështjes**-Përfaqësuesi i apelit S.L, kandidati për kryetar në Komunën e Skenderajt, nga radhët e subjektit politik X.X, me datën 26.08.2021, nëpërmjet avokatit të tij, V. B, në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), ka paraqitur apel në PZAP, kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të largimit nga lista e kandidatëve për pjesëmarrje në Zgjedhjet Lokale 2021, si kandidat për kryetar në komunën e Skenderajt.

Parashtruesi i apelit S. L, kandidati për kryetar në Komunën e Skenderajt, nga radhët e subjektit politik X.X, me datën 26.08.2021, nëpërmjet avokatit të tij, V. B. , ka paraqitur një apel në PZAP, kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me të cilin pretendon se me datë 24.08.2021, subjekti politik X.X ka pranuar Njoftimin në emailin zyrtar lidhur me kandidatët të cilët nuk janë certifikuar nga KQZ, për shkak se të njëjtit nuk plotësojnë kushtet të cilat duhet ti plotësoj një kandidat për të u certifikuar si kandidat për zgjedhjet lokale të cilat do të mbahen me 17 tetor 2021. Në vazhdim të apelit theksohet se subjekti politik, X.X, respektivisht z.S L., sipas njoftimit nuk i ka plotësuar kushtet e nevojshme ligjore për tu certifikuar si kandidat për Kryetar në komunën e Skenderajt dhe se i njëjti nuk mund të kandidoj pasi që në kuptim të dispozitave përkatëse ligjore të cilat përcaktojnë që Kandidati nuk duhet të ketë një Aktgjykim të formës së prerë ku është dënuar në tre vitet e fundit dhe për shkak të faktit që i njëjti ka një aktgjykim ku është dënuar me gjobë për një vepër penale, kjo rrethanë ja pamundëson certifikimin si kandidat në Zgjedhjet Lokale të cilat do të mbahen me 17 tetor 2021. Me tutje parashtruesi i apelit thekson se kandidati për kryetar në komunën e Skenderajt, S. L këtë njoftim e ka pranuar me datë 24 gusht 2021 brenda afatit ligjor.

Parashtruesi i apelit pretendon se Komisioni qendror i Zgjedhjeve (KQZ) në njoftimin e nxjerrë ka bërë shkelje të dispozitave të Ligjit për Zgjedhje të Përgjithshme në Republikën e Kosovës si dhe dispozitave Kushtetuese. Gjithashtu parashtruesi i apelit pretendon se KQZ ka vlerësuar gabimisht dhe njëanshëm provat dhe faktet në raport me certifikimin e kandidatit për kryetar në komunën e Skenderajt z.S. L.

Paneli vlerëson se nuk është nën juridiksionin e këtij institucioni që në këtë fazë të procesit, të vendosë lidhur me kërkesat e ZRPPC-së, ngase sipas nenit 122 par.1 pikat a), b), c), d), e) dhe f) të LZP-së, mbi këtë bazë nuk cenon të drejtën e ankuesit që pas certifikimit ose periudhës së kundërshtimit për certifikim nga ana e KQZ-së, të paraqes sërish ankesë, nëse konsideron se i është cenuar e drejta e pretenduar si dhe nga arsyet e theksuara më lart si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 117 par.3, 118 par.1, 122 par.1 pika b) të LZP-së, si dhe nenit 11 par.6 të Rregullës Nr.02/15 të PZAP-it, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

## Arsyetimi i Panelit – PZAP



Me datë 26.08.2021 PZAP, i ka paraqitur KQZ-së, kërkesë për përgjigje duke kërkuar që të paraqesë përgjigje në ankesë deri me datë 26.08.2021 ora 12:00.

KQZ-ja, në përgjigjen në ankesë ka theksuar, se ka kërkuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), që të bëjë verifikimin e kandidatëve që marrin pjesë në garë zgjedhore për Zgjedhjet Lokale që do të mbahen me 17 tetor 2021, nëse të njëjtit janë dënuar me aktgjykim të plotfuqishëm nga Gjykatat e Republikës së Kosovës. Në këtë rast S. L., kandidat për kryetar në komunën e Skenderajt, nga subjekti politik X.X, dega në Skenderaj, nga të dhënat e pranuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në listën e Kandidatëve të subjektit politik X.X, rezultojnë të jetë shpallur fajtor për vepër penale me vendim përfundimtar të gjykatës në tri (3) vitet e fundit.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në përgjigjen e parashtruar ka sqaruar se subjekti politik X.X e ka bërë zëvendësimin. Gjithashtu KQZ ka deklaruar se nuk ka marrë ndonjë vendim për certifikim-mos certifikim të kandidateve të X.X i cili do të mund të ankimohej.

Paneli, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoj të gjitha pretendimet e apelimit, në kuptim të nenit 117 par.2 të LZP-së, gjeti se: **Apeli është i palejuar**

## Shënim

*Paneli, vlerësoi lejueshmërinë e apelit dhe ka ardhur në përfundim se i njëjti i plotëson kushtet e përcaktuara me nenin 122 të LZP-së dhe nenin 10 të Rregullës Nr. 02/2015-Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it.*

*Paneli, konstaton se pretendimet ankimore të parashtruesit të apelit S. L. për mos largim nga lista e kandidatëve për pjesëmarrje në Zgjedhjet Lokale 2021, si kandidat për kryetar në Komunën e Skenderajt nga subjekti politik X.X, dega në Skenderaj, nuk mund të jetë objekt i vlerësimit në këtë fazë të procesit zgjedhor, për faktin se, KQZ-ja, ende nuk ka marrë vendim lidhur me certifikimin apo mos certifikimin e kandidatëve të subjekteve politike, ashtu siç del edhe nga vet përgjigja në ankesë nga ana e KQZ-së, e parashtruar më datën 26.08.2021. Kërkesa e ZRPPC-së, drejtuar subjekteve politike për zëvendësim të kandidatëve të tyre nuk është ndonjë vendim nga KQZ-ja, por është një kërkesë nga ZRPPC-ja, në lidhje me rastin në fjalë, ku subjektit i është kërkuar që ti zëvendësoj kandidatët e caktuar.*

*Pra faza kur është parashtruar apeli është e parakohshme sepse nuk kemi vendimmarrje të KQZ-së, për certifikim të subjektit dhe listës së tyre, por kemi vetëm zëvendësim nga subjekti të cilit i përket apeluesi, dhe se subjekti nuk është i obligueshëm të bëjë zëvendësimin e kandidatit nëse vlerëson se të gjithë kandidatët janë të përshtatshëm konform nenit 29 të LZP-së.*

*Meqenëse në rastin konkret nga ana e KQZ-së, nuk është marrë vendim lidhur me këtë çështje juridike, prandaj paneli vlerëson se nuk është nën juridiksionin e këtij institucioni që në këtë fazë të procesit, të vendosë lidhur me kërkesat e ZRPPC-së, ngase sipas nenit 122 par.1 pikat a), b), c), d), e) dhe f) të LZP-së, PZAP-i, vendos vetëm për vendime të KQZ-së, të cilat përfshihen shprehimisht në dispozitën e sipërhënuar. Në këtë rast, nga ana e KQZ-së nuk është marrë vendimi lidhur me certifikimin apo refuzimin e kandidatëve të caktuar të subjekteve politike, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.*

*Hudhja e ankesës së ankuesit në këtë fazë të procedurës, mbi këtë bazë nuk cenon të drejtën e ankuesit që pas certifikimit ose periudhës së kundërshtimit për certifikim nga ana e KQZ-së, të paraqes sërish ankesë, nëse konsideron se i është cenuar e drejta e pretenduar.*

*Prandaj, nga arsyet e theksuara më lart si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 117 par.3, 118 par.1, 122 par.1 pika b) të LZP-së, si dhe nenit 11 par.6 të Rregullës Nr.02/15 të PZAP-it, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.*

**Parashtruesi i çështjes, përfaqësuesi i apelit F.H, kandidat për asamble të Kuvendit Komunal në Gjakovë, nga subjekti politik X.X, në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ka paraqitur apel kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr.2143-2021 të datës 28.08.2021, për shkak të largimit nga lista e kandidatëve për pjesëmarrje në Zgjedhjet Lokale 2021, si kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Gjakovë.**

**Lidhur me këtë çështje PZAP-i, ka nxjerr Vendimin Anr.568/2021 të datës 01.09.2021**

**Faktet e Çështjes**-Përfaqësuesi i apelit F.H, kandidat për asamble të Kuvendit Komunal në Gjakovë, nga subjekti politik X.X, në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ka paraqitur apel kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr.2143-2021 të datës 28.08.2021, për shkak të largimit nga lista e kandidatëve për pjesëmarrje në Zgjedhjet Lokale 2021, si kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Gjakovë. Me datën 31.08.2021 PZAP-i ka pranuar një apel nga F. Xh, kandidat për asamble të Kuvendit Komunal në Gjakovë, në të cilin pretendon se pas dorëzimit të listës me datë 16.08.2021, nga ana e degës në Gjakovë është publikuar emri i tij me vërejtje me arsyetimin se nuk i plotësojë kushtet pasi që në emër të tij është evidentuar një lëndë penale aktive me numër P.nr.3/18 e datës 10.05.2019.

Gjithashtu thekson se është njoftuar nga Gjykata Themelore në Gjakovë, se vepra penale Rrezikim i Trafikut Publik nga neni 378/6 të KPRK-së, është shqiptuar dënimi me gjobë në shumën prej 200 euro. Ndërsa me aktvendim të veçante EDGJ.nr.144/19 të datës 09.07.2019 të formës së prerë të datës 22.07.2019, është ndërpre procedura pasi realisht vepra e lartcekur sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës, nr.06/1-074, i hyrë në fuqi me 14.04.2019, vepra e lartcekur nuk përbën vepër penale. Kërkon nga PZAP, që ti mundësohet kandidimi për anëtar në Komunën e Gjakovës.

Parashtruesi krahas apelit ka bashkangjitur si dëshmi vërtetimin nga Prokuroria Themelore në Gjakovë PP/II.nr.914/2017, Prokuroria Themelore në Gjakovë ER-3004 – 181 – 2017 Gjakovë, të datës 27.08.2021, nr.Ref. EDGJ.144/19.

Paneli pas shqyrtimit paraprak të apelit të ushtruar nga kandidati për asamble komunale nga radhët e subjektit politik X.X. F. Xh., ka gjetur se i njëjti është paraqitur pas afatit ligjor të përcaktuar me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, nga neni 122.1 sepse apeli është paraqitur në PZAP me datë 31.08.2021 në ora 15:30 derisa vendimi për certifikim të kandidatëve për asamble komunale është bërë me datë 29.08.2021, që rezulton se parashtruesi apelin në PZAP e ka dorëzuar pas afatit ligjor prej 24h, nga data e certifikimit të kandidatëve nga ana e KQZ-së, prandaj si i tillë hudhet i pa lejuar. Paneli pasi shikoi lejueshmërinë e apelit dhe gjeti se i njëjti është i ushtruar pas afatit ligjor, që rezulton të jetë i pa lejueshëm, nuk u lëshua në përmbajtjen-vendosjen meritorë të këtij apeli dhe në kuptim të nenit 115 paragrafi 1, neni 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

## Arsyetimi i Panelit – PZAP



PZAP-i me datën 31.08.2021 ka dërguar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) kërkesën për përgjigje në ankesë.


Zyra për Regjistrimin e Partive Politike ZRPPC-KQZ ka dërguar përgjigjen në ankesë më datën 01.09.2021, në të cilën theksohet se sa i përket kandidatit për deputet F. Xh. kandidat për anëtar në Kuvendin Komunal të Komunës së Gjakovës, nga subjekti politik X.X, për Gjakovën, me datë 20.08.2021 është kërkuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës që ti sigurojë KQZ-së, emrat e individëve nga lista e kandidatëve të subjektit politik X.X të cilëve me anë të vendimit të gjykatës iu është hequr e drejta për të qenë kandidat apo që janë shpallur fajtor për vepër penale me një vendim përfundimtar të gjykatës në tri (3) vitet e fundit. Me datë 23.08.2021, ka pranuar shkresën nga KGJK, me të cilën, ndër të tjera është identifikuar edhe ky kandidat me të dhëna si në vijim: F. Xh është i dënuar me aktgjykim të plotfuqishëm P-3/2018 të datës 10.05.2019

Paneli, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoj apelin, gjeti se: **Apeli është i palejuar**

## Shënim

Paneli pas shqyrtimit paraprak të apelit të ushtruar nga kandidati për asamble komunale nga radhët e X.X, F. Xh. , ka gjetur se i njëjti është paraqitur pas afatit ligjor të përcaktuar me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, nga neni 122.1 me të cilin përcaktohet se: “Personi fizik ose juridik, të drejtat ligjore të të cilit janë prekur nga cilat do vendime të mëposhtme, vendime këto të marra nga KQZ-ja, mund të apelojë atë vendim në KZAP: a) përfshirjen ose largimin e një personi për të marrë pjesë në programin votues brenda dhe jashtë Kosovës; b) certifikimin ose kundërshtimin për të certifikuar një subjekt politik ose kandidat për të marrë pjesë në zgjedhje; c) kandidatin i cili pas certifikimit nuk dëshiron të marrë pjesë në zgjedhje; d) akreditimin ose refuzimin për akreditim të një vëzhguesi zgjedhor; e) vendosjen e një gjobe administrative ndaj një subjekti politik sipas nenit 42 të këtij ligji; dhe f) refuzimin për të regjistruar një parti politike brenda Zyrës, dhe Ligji nr.03/L-256, për Ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 03/L-073, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, saktësisht neni 122.1, me të cilin përcaktohet se: “Personi fizik ose juridik, të drejtat ligjore të të cilit janë prekur nga cilat do vendime të mëposhtme, vendime këto të marra nga KQZ-ja, mund të apelojë atë vendim në PZAP brenda njëzetekatër (24) orëve pasi që vendimi i apeluar shpallet nga KQZ-ja dhe apeli duhet të vendoset nga PZAP-i brenda shtatëdhjetedy (72) orëve pasi të jetë parashtruar apeli”. Në rastin konkret apeli është paraqitur ne PZAP me datë 31.08.2021 në ora 15:30 derisa vendimi për certifikim të kandidatëve për asamble komunale është bërë me datë 29.08.2021, që rezulton se parashtruesi apelin në PZAP e ka dorëzuar pas afatit ligjor prej 24h, nga data e certifikimit të kandidatëve nga ana e KQZ-së, prandaj si i tillë hudhet i pa lejuar. Paneli pasi shikoi lejueshmërinë e apelit dhe gjeti se i njëjti është i ushtruar pas afatit ligjor, që rezulton të jetë i pa lejueshëm, nuk u lëshua në përmbajtjen-vendosjen meritore të këtij apeli.





Në këtë pjesë janë përzgjedhur vendimet të cilat i referohen fushatës zgjedhore për zgjedhjet lokale të mbajtura në vitin 2021

## Parashtruesi i çështjes, Kompania private N.SH.T- D.HHED, ka paraqitur ankesë kundër S.Z, kandidat për kryetar komune në komunën e Suharekës nga subjekti politik N.N, për shkak të vendosjes së posterit në objekt privat

[Lidhur me këtë çështje PZAP-i, ka nxjerr Vendimin ZL.Anr.605/2021 të datës 04.10.2022](#)

**Faktet e Çështjes**-Kompania private N.SH.T- D.HHED, me seli në Suharekë, ka paraqitur ankesë kundër S.Z, kandidat për kryetar komune në komunën e Suharekës nga subjekti politik N.N dega në Suharekë, për shkak të vendosjes së posterit në objekt privat, për Zgjedhjet Lokale 2021.

Me datën 30.09.2021, kompania private N.SH.T- D.HHED, me seli në Suharekë, ka paraqitur ankesë në PZAP, në të cilën pretendon se kjo kompani është kompani marketingu dhe ka në shfrytëzim hapësirën publike për 10 vite rresht të Kuvendit Komunal të Suharekës, ku për këtë është votuar në Kuvendin Komunal të Suharekës, mirëpo në këtë hapësirë subjekti politik N.N, ka vënë reklamë dhe i ka cenuar kështu punën dhe veprimtarinë kësaj kompanie duke vendosur murale në pronën private të tyre ashtu që të njëjtit si kompani i ka shkaktuar dëme.

PZAP-i, duke u mbështetur në dispozitat e nenit në nenin 118 par.1 të LZP-së, **ankesën e parashtruar e ka refuzuar si të pabazuar**, pasi që pretendimet e paraqitësit të ankesës janë të paqëndrueshme se këto veprime përbëjnë shkelje nga ana e subjektit politik N.N, pasi që posterit në fjalë është i vendosur në vendin e dedikuar për reklamim - vendosje të posterave sipas marrëveshjes së arritur në mes të kompanisë Frutex sh.p.k, dhe subjektit politik N.N dega në Suharekë ashtu siç vërtetohet edhe nga Marrëveshja për shfrytëzimin e aseteve e datës 25.09.2021 për vendosjen e reklamës në hapësirat e objekteve.

### Arsyetimi i Panelit – PZAP



PZAP-i me datën 30.09.2021, ka dërguar subjektit politik N.N, kërkesën për përgjigje në ankesë në të cilën i ka kërkuar që të përgjigjet deri me datë 01.10.2021 deri në ora 09:00.

Në përgjigjen në ankesë të datës 30.09.2021, subjekti politik N.N, thekson se pretendimet e ankuesit janë të pa bazuara për faktin se për shfrytëzimin e hapësirës private për qëllime reklamuese të cekur në ankesë subjekti politik N.n ka arritur marrëveshje me Frutex sh.p.k në cilësinë e pronarit të objektit ku është vendosur posterit kontestues.

Përgjigjes në ankesë i ka bashkangjitur Marrëveshjen për shfrytëzimin e aseteve (vendosjen e reklamës në hapësirat e objekteve) të datës 25.09.2021 e cila në nenin II e ka të theksuar se N.n-dega Suharekë dhe Frutex sh.p.k pajtohen që të vendosin reklama në objektin afarist në Rr. “Brigada 123” Suharekë me detaje të specifikuar dhe se kjo marrëveshje vlen gjer me datë 17.11.2021.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën gjeti se: **Ankesa është e pabazuar**

## Shënim

*Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës se kompania private N.SH.T-D.HHED, me seli në Suharekë ka në shfrytëzim hapësirën publike për 10 vite rresht të Kuvendit Komunal të Suharekës, dhe se në këtë hapësirë subjekti politik N.N, ka vënë reklamë posterin e kandidatit S.Z, kandidat për kryetar komune, dhe me këtë i ka cenuar kështu punën dhe veprimtarinë kësaj kompanie duke vendosur murale në pronën private të tyre, janë të pabazuara, dhe nuk përbëjnë shkelje të nenit 33 pika (b) të LZP-së, pasi posterit i kandidatit S.Z, kandidat për kryetar komune në Komunën e Suharekës është i vendosur në pronë private që rezultojnë e vendosur sipas marrëveshjes së arritur me kompaninë Frutex sh.p.k dhe subjektit politik N.N dega në Suharekë. PZAP, rikujton se nuk është e kompetencën e këtij institucioni që të vlerësojë se vendosja e kësaj reklame a është në përputhje me rregulloret e nivelit të komunës, nga se çështja e tillë duhet të vlerësohet nga ana e organeve Komunale.*

*Paneli po ashtu pas shqyrtimit të kësaj ankese e duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së “vendosja për apelet dhe ankesat nga PZAP-i, mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse” vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, pasi që ankesa e parashtruesit ka qene sipërfaqësore dhe jo e konkretizuar, pasi që në momentin kur kompania private N.SH.T- D.HHED, pretendon se ka në shfrytëzim hapësirën publike për 10 vite rresht të Kuvendit Komunal të Suharekës, është e detyruar që nëpërmjet provave të vërtetoj faktin e pretenduar, se e ka në shfrytëzim hapësirën private në të cilën pretendon se është vendosur posterit reklamues i kandidatit S.Z, kandidat për kryetar komune në Komunën e Suharekës nga subjekti politik N.N.*

*Paneli erdhi në përfundim se janë të paqëndrueshme pretendimet e paraqitësit të ankesës se këto veprime përbëjnë shkelje nga ana e subjektit politik N.N pasi që posterit në fjalë është i vendosur në vendin e dedikuar për reklamim - vendosje të posterave sipas marrëveshjes së arritur në mes të kompanisë Frutex sh.p.k, dhe subjektit politik N.N dega në Suharekë ashtu siç vërtetohet edhe nga Marrëveshja për shfrytëzimin e aseteve e datës 25.09.2021 për vendosjen e reklamës në hapësirat e objekteve.*

## Parashtruesi i çështjes, subjekti politik N.N, ka paraqitur ankesë kundër subjektit politik, X.X, për shkak të pjesëmarrjes së përfaqësuesve të bashkësive fetare në tubime politike

Lidhur me këtë çështje PZAP-i, ka nxjerr Vendimin ZL.Anr.1110/2021 të datës 11.11.2021

**Faktet e Çështjes**-Subjekti Politik N.N, me seli në Prishtinë, ka paraqitur ankesë kundër Subjektit Politik X.X, me seli në Prishtinë, dega në Podujevë, për shkak të pjesëmarrjes së përfaqësuesve të bashkësive fetare në tubime politike, për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve Lokale 2021.

PZAP-i, më datë 10.11.2021, ka pranuar ankesën Anr.1110/2021, nga subjekti politik N.N, me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër subjektit politik X.X, me seli në Prishtinë, dega në Podujevë, me të cilën ndër të tjera pretendon se aktivistët e subjektit të tyre kanë vërejtur se në rrjetin social Facebook janë shpërndarë fotografi të cilat janë në kundërshtim me nenin 1 të Rregullës Zgjedhore Nr.20/2019, për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullës Zgjedhore Nr.13/2013 Fushata e Zgjedhjeve dhe Njoftimi për Ngjarjet Politike të cilat në fushatën e tyre kanë përfshirë përfaqësues të bashkësive fetare. Më tutje shtoi se në fotografitë e bashkangjitura si prova shihen në takim z .I.B, imam në Xhaminë “Met Podujeva” në Podujevë dhe z. B.LL, imam në Xhaminë e fshatit Herticë.

PZAP-i, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 115.1 dhe nenit 117.3 lidhur me nenin 118 par.1 të LZP-së, **ankesën e parashtruar e ka refuzuar si të pabazuar**, pasi që ka vlerësuar se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë dhe nga provat e ofruara si dëshmi paraqitësi i ankesës nuk ka arritur që me sukses t'i argumentojë pretendimet e veta, pasi që nga fotografitë të cilat paraqitësi i ka bashkangjitur si dëshmi ankesës, nuk mund të vërtetohet se kur subjekti politik X.X, ka bërë fushatë me përfaqësues të bashkësive fetare, dhe të cilat mund të paraqesin shkelje të dispozitave ligjore të Rregullës Zgjedhore Nr.13/2013.

### Arsyetimi i Panelit – PZAP



PZAP-i, në kuptim të nenit 7 paragrafi 1, të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e ka njoftuar subjektin politik X.X, për ankesën që është bërë ndaj tij dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj saj deri më datë 11.11.2021, në ora 09:00. Në përgjigje në ankesë të datës 11.11.2021, subjekti politik X.X, konsideron se pretendimet e subjektit politik N.N, janë jo të drejta, për faktin se ankuesi me qëllim që ta vë në lajthitje Panelin Zgjedhor nuk ka cekur datë se kur pretendon se kundërshtuesi ka vepruar në kundërshtim me rregullat zgjedhore të lartcekura, për faktin se i njëjti ka qenë në dijeni se fotot e bashkangjitura i ka marrë nga portalet e ndryshme elektronike, ndërsa ngjarjet të cilat ankuesi pretendon se është bërë shkelje të rregullave ka ndodhur më datë 02.11.2021. Si provë ka shënuar linkun e Portalit Llapi, info dhe propozojnë PZAP-in që ankesa në fjalë ta hedh poshtë si të palejuar.


PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën gjeti se: **Ankesa është e pabazuar**

## Shënim

*Paneli me rastin e shikimit të shkresave të lëndës, vlerësoi se paraqitësi i ankesës nuk ka arritur që me sukses t'i argumentojë pretendimet e veta, pasi që nga fotografitë të cilat paraqitësi i ka bashkangjitur si dëshmi ankesës, nuk mund të vërtetohet se kur Subjekti Politik X.X, ka bërë fushatë me përfaqësues të bashkësive fetare.*

*Nga fotografitë të cilat gjenden në shkresat e lëndës, vërehet vetëm se është realizuar një tubim i subjektit politik X.X, në të cilin tubim kanë marrë pjesë disa persona, por nuk është cekur se në cilën faqe të facebookut janë postuar fotot e bashkangjitura në ankesë lidhur me tubimin në fjalë, dhe nuk është i argumentuar me asnjë provë se kur është mbajtur ky tubim publik në çfarë date apo kohe, andaj një pretendim i tillë është i përgjithshëm i pa argumentuar ashtu siç kërkohet me nenin 117.3 të LZP-së*

*Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: “vendosja për apelet dhe ankesat nga PZAP-i mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkuara në ankesë dhe nga provat e ofruara si dëshmi parashtruesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj se këto veprime paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura të Rregullës Zgjedhore Nr.13/2013, pasi që ankesa e parashtruesit ka qenë sipërfaqësore dhe jo e konkretizuar, dhe si të tillë të njëjtën e refuzoi si të pabazuar.*



Në këtë pjesë janë përzgjedhur vendimet të cilat i referohen heshtjes zgjedhore për zgjedhjet lokale të vitit 2021

## Parashtruesi i çështjes, Organizata Jo Qeveritare N.N. gjatë ditës së heshtjes zgjedhore ka paraqitur ankesa kundër subjektit politik X.X me të cilën pretendonin se subjekti politik në fjalë nëpërmjet Facebookut, ka bërë sponsorimin e fushatës zgjedhore edhe në ditën e heshtjes zgjedhore

Lidhur me këtë çështje PZAP-i, ka nxjerr Vendimin Anr.647/2021 të datës 20.10.2021

**Faktet e Çështjes**-Me datë 18.10.2021, PZAP-i ka pranuar ankesën, Anr.647/2021, e paraqitur nga Organizata Joqeveritare N.N, kundër A. M, kandidat për kuvend komunal në Malishevë, nga radhët e subjektit politik X.X, në të cilën pretendon se me datë 17.10.2021, përmes rrjetit “Facebook”, ka sponsorizuar një postim me anë të të cilit ka kërkuar nga qytetarët që ta votojnë. Më tej në ankesë, parashtruesi i ankesës thekson se ky postim i sponsorizuar u është shfaqur përdoruesve të këtij aplikacioni ditën e zgjedhjeve dhe në këtë mënyre konsiderojnë se ka ndikuar në mënyrën e votimit. Subjekti politik X.X, me datë 19.10.2021 në PZAP, ka paraqitur përgjigje në ankesë me të cilën pretendimet e ankuesit janë verifikuar nga ana e tyre dhe se të njëjtit kanë zhvilluar komunikime me kandidatin A.M, lidhur me shkeljen e pretenduar në ankesë. Më tej në përgjigje në ankesë X.X, kanë shtuar se me 16.10.2021, kandidati në fjalë është kontaktuar nga Shtabi Zgjedhor selia qendrore e X.X, e cila ka kërkuar që të respektohet heshtja zgjedhore nga kandidatët e subjektit politik X.X.

Në përgjigjen sqaruese të cilën e kishte bërë gjatë komunikimit kandidati A.M kishte pranuar se gjatë fushatës llogaria e tij facebook është administruar nga dy vajzat e vëllait të tij dhe se të njëjtat i ka larguar menjëherë pas kontaktimit me zyrtarët e X.X.

X.X, në përgjigje në ankesë shton se është e padrejtë që përmes postimeve të profileve private të adresohet ankesa në drejtim të PDK-së, dhe se e njëjta nuk mban përgjegjësi për veprime të tilla individuale dhe kërkon që ankesa e parashtruar nga Organizata Joqeveritare N.N, të hudhet poshtë si e pabazuar.

### Arsyetimi i Panelit – PZAP



PZAP-i, pas shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesave dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, provave materiale, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se: Ankesa është e pabazuar

Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve në ankesë, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret të provuarit e asaj se shkelësit e supozuar me datë 17.10.2021, e kanë vazhduar sponsorimin e fushatës zgjedhore në rrjetin social “Facebook”, në ditën e heshtjes zgjedhore dhe ditën e votimit.

Nga provat e ofruara nga ankuesi, nuk mund të vërtetohet në mënyrë bindëse dhe të qartë se reklama e shkelësit të supozuar është publikuar apo ka vazhduar sponsorizimi i fushatës zgjedhore në ditën e heshtjes zgjedhore dhe ditën e votimit, edhe pse parashtruesi i ankesës ka paraqitur një fotografi me të cilat pretendon se postimi i sponsorizuar ka qenë aktiv në ditën e votimit, paneli këto pretendime nuk mundi ti vërtetoj sepse me asnjë provë shkresore nuk është argumentuar data dhe ora e reklamave të shkelësve të supozuar siç pretendohet në ankesë.

## Shënim

---

*Paneli, konform nenit 8 par. 5 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr. 02/2015, me datë 18.10.2021, ndërmori hetim lidhur me pretendimet e paraqitësit të ankesës dhe gjeti se të njëjtat janë të pa bazuara ngase nga ekzaminimi i bërë shihet se llogaria e kandidatit Alban Mazreku nuk ka qenë aktive dhe nuk kishte sponsorizim..*

*Për rastet e tilla PZAP-i ndërmerte veprime hetimore e qe ne rastin konkret nuk kishte arritur qe te vërtetonte pretendimet ankimore pasi qe ne ankese nuk kishte ndonjë date apo ore se kur ka ndodhur shkelja e pretenduar.*



## Parashtruesi i çështjes, Subjekti Politik N.N. gjatë ditës së heshtjes zgjedhore ka paraqitur ankesa kundër subjektit politik X.X me të cilën pretendonin se deputeti i subjektit politik X.X, Sh. S është parë pranë qendrës së vendvotimit në ditën e votimit

Lidhur me këtë çështje PZAP-i, ka nxjerr Vendimin Anr.1136/2021 të datës 15.11.2021

**Faktet e Çështjes**-PZAP-i, më datë 14.11.2021, ka pranuar ankesën Anr.1120/2021, nga subjekti politik N.N, me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër subjektit politik X.X, me seli në Prishtinë, dega në Gjilan, me të cilën pretendon se aktivistët e subjektit të tyre kanë vërejtur se deputeti i X.X Sh.S është parë pranë vendvotimit në shkollën Thimi Mitko në Gjilan duke biseduar me të rinj dhe duke ndikuar tek ata e duke iu bërë thirrje për votim. Parashtruesi i ankesës thekson se ky veprim është në kundërshtim me nenin 36 paragrafi 1 pika b) të LZP-së.

Më tej parashtruesi i ankesës ka kërkuar nga PZAP-i, që subjekti politik LVV, të sanksionohet sipas legjislacionit në fuqi. Paraqitësi i ankesës, si dëshmi për pretendimet e tij, ankesës i ka bashkangjitur tri fotografi të printuar.

### Arsyetimi i Panelit – PZAP



Në përgjigje në ankesë të datës 14.11.2021, subjekti politik X.X, konsideron se pretendimet e subjektit politik N.N janë jo të drejta dhe të pabazuara, për faktin se nga fotografit e ofruara si dëshmi nuk mund të dëshmohet se personi i fotografuar është Sh.S, andaj edhe propozon që ankesa të refuzohet e pabazuar.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën gjeti se: **Ankesa është e pabazuar**


Parashtruesi i ankesës me ankesën e tij pretendon se në afërsi të shkollës Thimi Mitko në Gjilan aktivistët e subjektit politik N.N kanë vërejtur se deputeti i X.X Sh.S është parë pranë vendvotimit në shkollën Thimi Mitko në Gjilan duke biseduar me të rinj dhe duke ndikuar tek ata e duke iu bërë thirrje për votim.

### Shënim

*Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, Paneli konstaton se nga provat e ofruara nga parashtruesi i ankesës nuk mund të identifikohet se personi në fjalë në fjalë është Sh.S ashtu siç pretendohet në ankesë sepse nga fotoja e ofruar nuk mund të identifikohet në mënyrë bindëse dhe të qartë se i njëjti është duke qëndruar pranë shkollës e cila shërben si Qendër e Votimit, në ditën e votimit.*

*Nga arsyet e theksuar më lartë, duke bazuar nenin 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.*

*Për PZAP - in nuk kishte ndonjë prove relevante apo të argumentuar ajo çka pala ankuese pretendonte me ankesën e saj, andaj edhe për këtë arsye edhe e kishte refuzuar ankesën si të pabazuar.*



Në këtë pjesë janë përzgjedhur vendimet të cilat i referohen ditës së votimit për zgjedhjet lokale të mbajtura në vitin 2021

## Parashtruesi i çështjes, Subjekti politik N.N. përmes përfaqësuesit tij, ka paraqitur ankesë kundër komisionerëve të vendvotimit, nën pretendimin se në vendvotimin ka pasur manipulim dhe është bërë vjedhje masive e votave

Lidhur me këtë çështje PZAP-i, ka nxjerr Vendimin Anr.664/2021 të datës 20.10.2021

**Faktet e Çështjes**-Me datën 18.10.2021 PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjektit politik N.N, me seli në Mitrovica e Veriut, në të cilën pretendon se në vendvotimin nr. 3805 / 08R, anëtarja e tyre në vendvotim, Z.A, u largua nga vendvotimi në orën 9 për shkak të vjedhjes masive të votave. Pas kësaj, votimi në atë vendvotimi vazhdoi, ndërsa zëvendësimi nuk është aktivizuar. Të njëjtit theksojnë se kur dolën rezultatet kuptuan se kishte parregullsi të mëdha, vjedhja ishte e madhe ndërsa votat e tyre anuloheshin në numërim. I njëjti kërkon që të i mundësohet qasje në kutit me vota dhe përputhshmëria me nënshkrimet në mënyrë që ti dëshmojnë pretendimet e tyre. Më tutje theksohet se anëtari i tyre në këtë vendvotim nuk e nënshkroi librin në të cilin shënohen votat, dhe nuk e nënshkroi librin me rezultatet përfundimtare. Si dëshmitar ka paraqitur emrat e anëtarëve të vendvotimit Z. A, dhe D M.

### Arsyetimi i Panelit – PZAP



PZAP-i, pas shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, provave materiale, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se: **Ankesa është e pabazuar**

Neni 94 i LZP-së përcakton qartë se kryesuesi, anëtarët e KVV-së dhe vëzhguesit e akredituar të pranishëm lejohen të bëjnë shënime apo vërejtje në librin e votimit (librin e shënimeve në vendvotim) në të cilën shënohen ngjarjet që ndodhin në vendvotim. Paneli, konform nenit 8 par. 5 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr. 02/2015, ndërmori hetim lidhur me pretendimet e paraqitësit të ankesës dhe nga hetimi i bërë gjeti se pretendimi i parashtruesit të ankesës se në vendvotimin 3805B/08R ka pasur vjedhje masive të votave nuk mund ta konsideroj si të bazuar për faktin se në librin e shënimeve në këtë vendvotim nuk ka pasur ndonjë shënim- vërejtje apo ndonjë parregullsi tjetër të shënuar nga asnjë anëtarë apo vëzhgues i atij vendvotimi lidhur me vjedhje te votave dhe për parregullsi tjera për të cilat pretendon pala ankuese.

### Shënim

*Paneli me rastin e shikimit të shkresave të lëndës, vlerësoi se paraqitësi i ankesës nuk ka arritur që me sukses t'i argumentojë pretendimet e veta, pasi që nga pretendimet e paraqitura në ankesë, nuk janë vërtetuar ato të cilat janë theksuar në ankesë.*

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: “vendosja për apelet dhe ankesat nga PZAP-i mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë dhe nga provat e ofruara si dëshmi parashtruesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj shkeljet e pretenduara, andaj ankesa e parashtruesit ka qenë sipërfaqësore dhe jo e konkretizuar, dhe si të tillë të njëjtën e refuzoi si të pabazuar.

Neni 94 i LZP-së përcakton qartë se kryesuesi, anëtarët e KVV-së dhe vëzhguesit e akredituar të pranishëm lejohen të bëjnë shënime apo vërejtje në librin e votimit (librin e shënimeve në vendvotim) në të cilën shënohen ngjarjet që ndodhin në vendvotim.

Në këtë rast nga hetimi i PZAP-it që i kishte bere hetimit ne librin e votimit nuk gjeti ndonjë parregullsi te paraqitur nga ndonjë anetare i atij këshilli te vendvotimi.

**Parashtruesi i çështjes, Subjekti politik N.N. përmes përfaqësuesit tij, ka paraqitur ankesë kundër subjektit politik X.X, nën pretendimin se në vendvotim gjatë procesit të votimit janë shënuar dy raste të fotografimit të votës dhe të dyshuarit për kryerjen e këtyre veprimeve janë arrestuar nga policia dhe se rastet janë shënuar edhe në Librin e Vërejtjeve në këtë vendvotim**

[Lidhur me këtë çështje PZAP-i, ka nxjerr Vendimin Anr.671/2021 të datës 20.10.2021](#)

**Faktet e Çështjes**-Me datën 18.10.2021, PZAP-i ka pranuar një ankesë Subjektit Politik N.N, me seli në Skenderaj, paraqitur kundër Subjektit Politik X.X, me të cilën pretendon se në vendvotimin numër 2114B/04D, gjatë procesit të votimit janë shënuar dy raste të fotografimit të votës dhe të dyshuarit për kryerjen e këtyre veprimeve janë arrestuar nga policia dhe se rastet janë shënuar edhe në Librin e Vërejtjeve në këtë vendvotim.

Më tej në ankesë theksohet se këto veprime të kundërligjshme dëshmojnë blerjen e votës, nga ana e Subjektit Politik X.X.

Parashtruesi i ankesës shton se personat e raportuar të cilët kanë fotografuar votën janë K. T dhe A. Xh, dhe kërkojnë që të ndërmerren masa ligjore ndaj tyre.

Parashtruesi i ankesës lidhur me pretendimet e tij ka bashkangjitur deklaratën e A. M, komisioner nga Subjekti Politik Y.Y.

## Arsyetimi i Panelit – PZAP



Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën, në kuptim të nenit 117.3 të LZP-së gjeti se: **Ankesa është e pabazuar** Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve në ankesë, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret të provuarit e asaj se shkelësit e supozuar me datë 17.10.2021, në vendvotimin numër 2114B/04D, gjatë procesit të votimit kanë bërë fotografimin e votës dhe se të njëjtit janë arrestuar nga Policia e Kosovës.

### Shënim

*Nga raporti i Policisë së Kosovës, i datës 17.10.2021, paneli konstatoi se pretendimet në ankesë janë të pabazuara lidhur me fotografimin e votës në vendvotimin 2214B në Shkollën Fillore “Shotë Galica” në Runik, ku thuhet se në vendin e ngjarjes ishte përgjigjur një njësi policore mirëpo, nuk është vërtetuar se ka pasur tentim të fotografimit të votës, rrjedhimisht nuk ka rast të iniciuar në drejtim të ndonjë vepr penale, dhe se lidhur me rastin ka qenë e njoftuar edhe prokurorja e cila ka qenë e caktuar për ditën e zgjedhjeve.*

*Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: “vendosja për apelet dhe ankesat nga PZAP-i mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë dhe nga provat e ofruara si dëshmi parashtruesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj se këto veprime paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura të Rregullës Zgjedhore Nr.13/2013, pasi që ankesa e parashtruesit ka qenë sipërfaqësore dhe jo e konkretizuar, dhe si të tillë të njëjtën e refuzoi si të pabazuar.*

*Në këtë rast PZAP-i kërkoi informata edhe nga Policisë së Kosovës por e njëjta me raportin e sajë nuk konfirmoi se ka patur ndonjë parregullsi për të cilën kishte pretenduar pala ankuese.*

*Kundër këtij vendimi subjektit politik N.N ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme të Kosovës, por e njëjta e ka refuzuar ankesën e palës ankuese dhe ka vërtetuar vendimin e PZAP-it duke e lënë të njëjtin në fuqi.*

*Ky vendim është vërtetuar me vendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës me nr. AA.nr.53/2021 të datës 23.10.2021*

## Parashtruesi i çështjes, Subjekti politik N.N. përmes përfaqësuesit tij, ka paraqitur ankesë kundër votueses V.P, nën pretendimin se përkundër që e njëjta është me vendbanim në Zvicër dhe është në listën e votuesve jashtë Kosovës e njëjta ka votuar në Qendrën e Votimit VV 05R në Junik dhe po ashtu ka asistuar tek votuesit e tjerë

[Lidhur me këtë çështje PZAP-i, ka nxjerr Vendimin Anr.697/2021 të datës 21.10.2021](#)

**Faktet e Çështjes-**Me datë 21.10.2021, PZAP-i ka pranuar përmes postës ankesën Anr.697/2021 të datës 18.10.2021 nga subjekti politik N.N, dega në Junik në të cilën pretendohet se V.P nga Juniku, me vendbanim në Zvicër është në listën e votuesve jashtë Kosovës dhe ka votuar në Qendrën e Votimit VV 05R në Junik e po ashtu ka asistuar. Sipas parashtruesit të ankesës dyshohet se e njëjta ka votuar përmes postës e po ashtu ka votuar edhe në Junik. Ankesës i ka bashkangjitur një listë me emra në të cilët gjendet edhe emri i V.P dhe një fotografi e printuar e komunikimit në mes të komisionerëve.

### Arsyetimi i Panelit – PZAP




PZAP-i, pasi që shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës, gjeti se: **Ankesa është e pa bazuar**. Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës lidhur me shkeljet e pretenduara, për parregullsitë në ditën e zgjedhjeve se V.P, ka bërë votim të dyfishtë, Paneli i vlerësoi si të pabazuara, sepse ankuesi me asnjë provë shkresore nuk e ka provuara, që në rastin konkret shkelësi i supozuar ka votuar dy herë siç pretendon ankuesi, pasi që lista e bashkangjitur krahas ankesës si dhe komunikimi në mes të komisionerëve nuk vërtetojnë faktin se e njëjta ka bërë votim të dyfishtë pasi që ky është një komunikim jozyrtar ndërmjet komisionarëve, në vendvotimin lëndor.

### Shënim

*Andaj, Paneli vlerësoi se ankesa e parashtruar nga Subjekti politik N.N, dega në Junik, nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, ku thuhet se “Vendosja për apelet dhe ankesat nga PZAP-i mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse.” pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur një shkelje e tillë e pretenduar si në ankesës.*

*Në nenin 117 par.3, të LZP-së, ku thuhet se “Vendosja për apelet dhe ankesat nga PZAP-i mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse.” në këtë rast pala ankuese nuk e kishte bashkangjitur asnjë prove apo ndonjë dokument lidhur me ate të cilën e theksonin në ankese andaj PZAP-i e kishte refuzur ankesën duke u bazuar në nenin e sipërcituar.*



Në këtë pjesë janë përzgjedhur vendimet të cilat i referohen rezultateve preliminare për procesin zgjedhor në nivelin lokal të mbajtura në vitin 2021

## Parashtruesi i çështjes- Subjekti politik X.X. me seli në Komunën e Skenderajt, ka pashtuar ankesë për shkak të fletëvotimeve të pavulosura në një vendvotim

Lidhur me këtë çështje PZAP-i, ka nxjerr Vendimin Anr.673/2021, të datës 20.10.2021

**Faktet e Çështjes-**Subjekti politik X.X. me seli në Komunën e Skenderajt, në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), ka pashtuar ankesë me datën 18.10.2021, kundër Anëtareve të Vendvotimit 2108B/02D, për shkak të parregullsive gjatë procesit të numërimit të fletëvotimeve për Zgjedhjet e Lokale 2021, të mbajtura më 17 Tetor 2021, sepse gjatë procesit të votave janë evidentuar dy fletëvotime të pavulosura, njëra e pa plotësuar dhe tjetra e votuar për YY, po ashtu në këtë vendvotim nuk kishte pasur barazim të votave të kandidatëve për anëtarë të kuvendit komunal të Komunës së Skenderajt.

Parashtruesi i ankesës kishte kërkuar që të bëhet përsëritja e votimit pasi që kishin dyshime të mëdha për vjedhje të votave sipas sistemit të “trenit bullgar”.

### Arsyetimi i Panelit – PZAP



Me datë 18.10.2021, PZAP, ka pranuar ankesë nga XX, me të cilën pretendon se në vendvotimin nr.2108B/02D gjatë procesit të numërimit të votave janë evidentuar dy fletëvotime të pavulosura, njëra e pa plotësuar dhe tjetra e votuar për YY, po ashtu në këtë vendvotim nuk ka pasur barazim të votave për kuvend komunal ku kanë ardhur edhe zyrtar të KQZ dhe nuk kanë mundur të barazohen. Parashtruesi i ankesës ka kërkuar që të bëhet përsëritja e votimit pasi që ka dyshime të mëdha për vjedhje të votave sipas sistemit të “trenit bullgar” dhe kishin kërkuar që të përsëritet votimi, në Vendvotimin 2108B/02D.

Ankesa është pjesërisht e bazuar-PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe provave të bashkangjitura, konstatoi se ankesa është pjesërisht e bazuar në pjesën që ka të bëjë se në vendvotimin lëndor janë dy fletëvotime të pavulosura, kjo është konstatuar nga deklarata e kryesuesit dhe anëtarit të Këshillit të Vendvotimit 2108B/02D. Andaj në raport me këto parregullsi paneli vendosi si në pikën -I-, të dispozitivit të këtij vendimi, bazuar në dispozitën ligjore të nenit 120 par.3, pika d), të LZP-së, në të cilin parashihet se: “Në rast se ka ndodhur një shkelje e këtij ligji ose rregullave zgjedhore e cila e minon integritetin e zgjedhjeve PZAP-i mundet d) Ndalojë një individ të marr pjesë në zgjedhjet e mbajtura nën autoritetin e KQZ-së, si kandidat apo edhe si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor, për një periudhë kohore që nuk u kalon gjashtë (6) vite”. Lëshimet e pretenduara dhe të konstatuara nga paneli i atribuohen përgjegjësisë së kryesuesit të vendvotimit sipas nenit 74.10, pasi integritetit i procesit mbetet përgjegjësi e kryesuesit. Me nenin 74.10 të LZP-së përcaktohet “KVV-ja është përgjegjëse për sigurimin e integritetit, sigurisë dhe të qetësisë në procesin e votimit dhe numërimit në Vendvotim nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë nga KKZ-ja”.



Në raport me pjesën refuzuese për urdhërimin e përsëritjes së votimit Paneli i vlerëson se mospërputhja e rezultatit konstatuar si më lartë nuk është bazë e mjaftueshme dhe me peshë në rezultat për të urdhëruar përsëritjen e votimit në vendvotimin e pretenduar, bazuar në nenin 117 paragrafi 3 dhe nenin 118, të LZP-së, ngase nuk janë ofruar dëshmi të qarta dhe bindës se ka pas parregullsi të asaj natyre për të ndikuar në vendimmarrje ndryshe në këtë rast, siç është vendosur në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi.

## Shënim

*Paneli kishte konstatuar se ankesa ishte pjesërisht e bazuar, lidhur me pjesën që kishte të bëjë me çështjen e dy fletëvotime të pa vulosura, kryesuesit të vendvotimit paneli i kishte ndaluar pjesëmarrjen në zgjedhje, si kandidat apo si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vite, nga dita e marrjes së vendimit.*

*Ndërsa lidhur me pjesën refuzuese të ankesës për urdhërimin e përsëritjes së votimit Paneli, kishte vlerësuar se mospërputhja e rezultatit nuk ishte bazë e mjaftueshme dhe me peshë në rezultat për të urdhëruar përsëritjen e votimit.*

*Ndaj vendimit të PZAP-it, Anr.673/2021, kishte paraqitur apel në Gjykatën Supreme të Kosovës, subjekti politike XX. Gjykata Supreme e Kosovës me aktgjykimin AA.nr.53/2021 të datës 23.01.2021, kishte vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të kontestuar të PZAP-it, dhe kishte pranuar si të bazuar qëndrimin juridik të PZAP-it, ndërsa apeli i parashtruar nga subjekti politik XX, ishte i pabazuar sepse nuk kishte të bashkangjitura prova të mjaftueshme për të vërtetuar manipulimet e pretenduara.*

## Parashtruesi i çështjes, Kandidati i pavarur për Kryetar të Komunës së Hanit të Elezit, XX, ka paraqitur ankesë për shkak të parregullësive në vendvotime-tentim për blerje të votave dhe ndikim tek votuesit

[Lidhur me këtë çështje PZAP-i, ka nxjerr Vendimin Anr.693/2021 të datës 21.10.2021 dhe vendimin A.nr. 693-2/2021 të datës 27.10.2021, të rivendosur nga PZAP-i](#)

**Faktet e Çështjes**-Kandidati i pavarur XX, në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), ka parashtruar ankesë duke pretenduar se gjatë fushatës zgjedhore dhe në ditën e zgjedhjeve të Zgjedhjeve Lokale 2021, në Komunën e Hanit të Elezit, kishte parregullsi, tentim për blerje të votave, presion tek votuesit për të votuar. Parashtruesi i ankesës ka pretenduar se sipas raportimit të vëzhguesve të tyre, janë njoftuar se në ditën e zgjedhjeve kandidati për kryetar të Komunës së Hanit të Elezit XX, nga radhët e Subjektit Politik XX, dhe kandidatët për kuvend komunal të këtij subjekti kanë vizituar të gjitha vendvotimet në Hanin e Elezit, dhe gjatë kësaj vizite kanë biseduar me zyrtarët e vendvotimeve duke i pyetur “ si jeni, a jeni lodh, a keni ndonjë problem”, po ashtu në korridor kanë biseduar me votuesit duke i sugjeruar “votoni nr.177 dhe numrat e kandidatëve”.

### Arsyetimi i Panelit – PZAP



Në këtë rast Paneli në bazë të provave kishte vlerësuar se vetë fakti i mënyrës së organizimit të votimit, presionit dhe përmendja e shpërblimit qoftë ky shpërblim në emër të organizimit apo blerjes, mesazhi me konfirmimin e votës për kandidatin fitues atë të subjektit politik YY, kishte rezultuar se ka pas ndikim në procesin e votimit dhe ndikim në rezultatin përfundimtar. Sipas Panelit kjo ishte bazë e mjaftueshme për të përsëritur votimin, pasi çdo vendimmarrje ndryshe do të nënkuptonte shtrembërim të vullnetit të votuesve, dhe mungesë e legjitimitetit, ndërsa në instancë të fundit cenim dhe minim të integriteti zgjedhor.

gjeti se: **ankesa është e bazuar**-Paneli pasi i shqyrtoj pretendimet ankimore dhe materialin zgjedhor si dhe pas vlerësimit të gjithanshëm të tyre, kishte vendosur që të anulohen rezultatet e Zgjedhjeve Lokale të datës 17.10.2021, vetëm për kryetar Komune së Hanit të Elezit, për shkak të minim të integritetit të zgjedhjeve si rezultat i presionit dhe organizimit me qëllim të përfitimit të mbështetjes së votuesve dhe kishte vendosur që ta përsërisë votimin vetëm për kryetar komune në Qendrat e Votimit (QV) Nr. 3301d, 3302d, 3303d dhe 3304d të gjitha në po të njëjtën komunë.

Paneli duke u bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse siç përcaktohen me nenin 117 par.3 të LQP-së, në të cilën përcaktohet se: “Vendosja për apelet dhe ankesat nga PZAP-i, mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”, siç edhe ishin në rastin konkret, dhe duke u bazuar edhe në nenin 120 par.1 pika b), i LQP-së, në të cilin përcaktohet se: “Para certifikimit të rezultateve zgjedhore është në kompetencë të PZAP-it, në raste të jashtëzakonshme të anuloj rezultatet në një vendvotim apo qendër votimi, dhe ta urdhëroj KQZ-në, të përsërisë votimin në një qendër votimi apo vendvotim, nëse konsideron se ka ndikim në rezultatet finale”.

## Arsyetimi i Panelit – PZAP me rastin e rivendosjes



Me rastin e rivendosjes sipas ankesës së lartë përmendur të ankuesit XX, duke vepruar në tërësi sipas vërejtjeve të dhëna nga Gjykata Supreme e Kosovës, në aktvendimin e AA.nr.52/2021 i datës 23.10.2021, dhe me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, në këtë procedurë të rigjykimit, PZAP-i mblodhi, analizoi dhe vlerësoi të gjitha provat si në vijim: katër mesazhe të komunikimit përmes telefonit, CD1 me dy video, CD2 dhe CD3, komunikimet në rrjete sociale “Facebook”, raportin e datës 22.10.2021 të lëshuar nga KQZ lidhur me rrjedhshmërinë e procesit zgjedhor në ditën e Zgjedhjeve Lokale të datës 17.10.2021 për Komunën e Hanit të Elezit, Librat e Votimit, Deklaratat e Menaxherëve të QV, dhe Raportin e Policisë së Kosovës të datës 26.10.2021.

Paneli, pasi që vlerësoi secilën nga provat një nga një, dhe të gjitha së bashku, vërtetoi një gjendje tjetër faktike, dhe si rrjedhojë u desh që,

- **ankesa të aprovohet pjesërisht si e bazuar**- Paneli, duke iu referuar provave të cekura më lart dhe në mbështetje të dispozitave ligjore të LZP-së, konstaton se subjekti politik YY, është përgjegjëse për veprimet e tij, pasi që me veprimet e lartë cekura ka shkelur nenin 36 paragrafi 1 pika b) të LZP-së, e cila dispozitë ligjore përcakton veprimet e ndaluara para procesit të votimit ku thuhet se “24 orë para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e votës, deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndalohet bërja e fushatës në çfarë do mënyre”, që në këtë rast vetë prezenca e kandidatit në fjalë nëpër vendvotime pa qenë votues në ato vendvotime është bërje e fushatës në një farë mënyre.

Ndërsa në raport me pjesën refuzuese të ankesës, për urdhërimin e përsëritjes së votimit Paneli vlerëson se me asnjë nga provat e vlerësuara si më lart nuk është vërtetuar se është ushtruar ndonjë ankesë për ndonjë parregullsi në ndonjë vendvotim, po ashtu as në polici nuk është paraqitur ndonjë ankesë apo kallxim penal që ka të bëjë me presionin që iu është bërë votuesve siç pretendohet nga ankuesi, vizita e kandidatit për kryetar të komunës në katër vendvotime edhe pse nuk ishte votues, nuk është bazë e mjaftueshme dhe me peshë në rezultat për të urdhëruar përsëritjen e votimit në vendvotimin e pretenduar, bazuar në nenin 117 paragrafi 3 dhe nenin 118, të LZP-së, ngase nuk janë ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse


## Shënim

Vendimi i Panelit, është vendim administrativ sipas LZP-së, me të cilin nuk paragjykohet sanksionimi penal që mund të pasoj, sipas nenin 120 par.5 të LZP-së.

Vendimi i PZAP-it lidhur me këtë rast ishte apeluar nga kandidati i subjektit politik YY, dhe se në procedurën ankimore, Gjykata Supreme e Kosovës, me aktvendimin AA.nr.52/2021, të datës 23.10.2021, kishte aprovuar ankesën e të njëjtit, duke anuluar vendimin e PZAP-it, A.nr.693/2021 të datës 21.10.2021, dhe çështjen e kishte kthyer në rivendosje.

Paneli gjatë procedurës së rigjyimit e kishte ardhur në përfundim që vendimi Anr.693-2 i datës 27.10.2021, të pranohej pjesërisht duke konstatuar se kandidati për kryetar të komunës së Hanit të Elezit, nga radhët e subjektit politik YY, kishte thyer heshtjen zgjedhore në ditën e votimit, duke e gjobitur me 10.000.00 euro ndërsa kishte refuzuar pjesën e ankesës që kishte të bënte me anulimin e zgjedhjeve për kryetar të Komunës së Hanit të Elezit.

Kundër vendimit të PZAP-it, Anr.693-2/2021 i datës 27.10.2021, kishin parashtruar ankesë në Gjykatën Supreme të Kosovës, kandidati i pavarur XX dhe subjekti politik YY, përmes përfaqësuesit të tij. Mirëpo Gjykata Supreme e Kosovës, i kishte **refuzuar ankesat** e tyre me Aktgjykimin me nr AA.56/2021, të datës 28.10.2021.



Në këtë pjesë janë përzgjedhur vendimet të cilat i referohen rezultateve përfundimtare për zgjedhjet e nivelit lokal të mbajtura në vitin 2021

## Parashtruesit e çështjes- Kandidatët për Anëtarë të Kuvendit Komunal të Mitrovicës së Jugut, nga radhët e subjekteve të ndryshme politike, kishin paraqitur ankesat e tyre lidhur me Rezultatin Përfundimtar për kuvend komunal për Zgjedhjet Lokale 2021, të shpallura nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ)

[Lidhur me këtë çështje PZAP-i, ka nxjerr Vendimin Anr.783/2021, të datës 05.11.2021](#)

**Faktet e Çështjes**-57 kandidatë për anëtarë të Kuvendit Komunal në Mitrovicën e Jugut, nga radhët e Subjekteve Politike XX, YY, ZZ, SS si dhe nga subjekti politik AA, cilët ishin përfaqësuar sipas autorizimeve nga avokatet MM dhe NN nga Komuna e Mitrovicës së Jugut, kanë paraqitur ankesat e tyre kundër vendimit me numër 2948-2021 të datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), lidhur me Rezultatin Përfundimtar për Zgjedhjet Lokale 2021, për Anëtarët e K

Parashtruesit e apeleve theksojnë se gjatë procedurave të numërimit dhe të regjistrimit të votave në Formularët e Rezultateve të Kandidatëve-FRK, kanë shumë mospërputhje të votave për bartësit e listës së kandidatëve nga subjekti politik me numrin e votave të kandidatëve të po të njëjtit subjekt politik. uvendit Komunal.

Në këto apele ishte kërkuar rinumërimi i plotë i të gjitha vendvotimeve në Komunën e Mitrovicës së Jugut, sepse sipas tyre gjatë procedurave të numërimit dhe të regjistrimit të votave në Formularët e Rezultateve të Kandidatëve-FRK, kishin hasur në shumë mospërputhje të votave për bartësit e listës së kandidatëve nga subjektet politike me numrin e votave të kandidatëve të po të njëjtit subjekt politik.

### Arsyetimi i Panelit – PZAP



PZAP-i, me datën 04.11.2021 ka pranuar 57 apele, përmes përfaqësve të kandidatëve për anëtarë të Kuvendit Komunal në Mitrovicën e Jugut, avokatet MM dhe NN, me të cilat kërkohet rinumërimi i plotë i të gjitha vendvotimeve në Komunën e Mitrovicës së Jugut, për shkak të manipulimeve në regjistrimin e votave në FRP dhe FRK.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, pas shqyrtimit të pretendimeve të apeleve, materialit zgjedhor dhe provave që gjinden në shkresat e lëndëve, gjeti se, **apeli është i pjesërisht i bazuar**, dhe ka konstatuar se ka mospërputhje të rezultateve të shpallura nga KQZ-ja, me provat e ofruara nga pala ankuese, siç rezultojnë edhe nga provat e ofruara si dëshmi nga vet pala ankuese, dhe mungesë të votave për kandidatet e këtyre subjekteve deri në atë masë sa që disa prej kandidatëve nuk kanë asnjë votë që do të thotë as votën e vet, çka është absurde dhe e pa pranueshme dhe për më tepër, rezultatin e numërimit e bën me bazë të pa pranueshëm.

Vet fakti se kandidatët për anëtarë të subjekteve politike XX, YY, ZZ, dhe SS, të certifikuar për pjesëmarrje në Zgjedhjet Lokale 2021, e kontestojnë se bashku numërimin e fletëvotimeve në Komunën e Mitrovicës së Jugut, për kandidatët për

anëtar të Kuvendit, tregon se rezultati përfundimtar i shpallur nga KQZ, vërtetë është i kontestueshëm, i cili rezultat në bazë të argumenteve e provave të cilat gjenden në shkresa të lëndës, edhe sipas vlerësimit të PZAP-së, është bazë e mjaftueshme për rinumërim ashtu siç është vendosur me këtë vendim. PZAP-i gjen se, përveç tjerave, me rinumërim, askujt nuk i cenohet rezultati real dhe i vërtetë, përkundrazi për secilin kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal të Mitrovicës së Jugut, del rezultat zgjedhor i sigurt dhe i pranueshëm nga të gjithë.

Paneli, vlerëson se ky rinumërim e bënë procesin e numërimit të fletëvotimeve dhe shpalljen e rezultateve, të saktë në kuptim të nenit 101 paragrafi 1 i LZP-së, me të cilën dispozitë përcaktohet se: “Procedura e numërimit të fletëvotimeve qeverisen nga objektivat e mëposhtme: saktësia, transparencja, efikasiteti, mundësia për rinumërim dhe përsëritja e zgjedhjeve dhe mbrojtja e fshehtësisë së votës”. Nga kjo rezultojnë se mos procedimi i fletëvotimeve sipas dispozitës së lartë cituar, përveç cenimit të saktësisë, transparencës dhe kredibilitetit, po ashtu cenon integritetin e procesit zgjedhor dhe se pa evitimin e kësaj parregullsie, përmes rinumërimit, ky integritet dhe kredibilitet do të vihet në pikëpyetje.

## Shënim

*Paneli, në bazë të nenit 13.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, i ka bashkuar apelet e lartcekura dhe të njëjtat i trajton si një apel, të evidentuar me Anr.783/2021, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve për çka të gjitha i vendosi me një vendim për hire të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.*

*Paneli me qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenin 115.1, 117.4 dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi që ankesat e parashtruara ti pranoi si të bazuara dhe kishte urdhëruar KQZ-në që të rinumëroj të gjitha fletëvotimet për të gjitha subjektet politike dhe të të gjithë kandidatëve të tyre në Vendvotimet në të cilat nuk kishte rinumëruar KQZ, ndërsa rezultatin i cili del pas rinumërimit të përfshihen në rezultatin përfundimtar.*

*Ndërsa për disa vendvotime ka refuzuar apelin për arsye se në ato vendvotime veç se janë të rinumëruara nga KQZ-ja, dhe nga këto rinumërimet janë evituar shumë parregullsi dhe përmirësime në vota, andaj Paneli konstaton se nuk ka arsye që të njëjtat vendvotime të rinumërohen përsëri.*








**ZGJEDHJET LOKALE  
TË MBAJURA NË VITIN 2021**

**2021**

**RAUNDI I II**

Në këtë pjesë janë përzgjedhur vendimet të cilat i referohen rezultateve përfundimtare të raundit të dytë për zgjedhjet lokale të mbajtura në vitin 2021



## Parashtruesi i çështjes, Subjekti politik NN, ka parashtruar ankesë, në Raundin e II-të të Zgjedhjeve Lokale për shkak të manipulimeve gjatë procesit të votimit

[Lidhur me këtë çështje PZAP-i, ka nxjerr Vendimin Anr.1143/2021 të datës 19.11.2021](#)

**Faktet e Çështjes**-Gjatë procesit zgjedhor të Zgjedhjeve Lokale 2021, në ankesën Anr.1143/2021, e paraqitur nga subjekti politik XX, ishte pretenduar se në Raundin e Dytë të zgjedhjeve, të mbajtura më datë 14.11.2021, për kryetar të Komunës në Dragash, kishte pasur manipulime të cilat kanë cenuar rëndë integritetin e procesit zgjedhor, duke devijuar vullnetin e shumicës së votuesve të cilët kishin votuar nga jashtë Kosove.

Parashtruesi i ankesës më tej pretendon se pjesa më e madhe e zarfeve me fletëvotime të supozuara të dërguara me postë të ardhura nga Austria, Zvicra dhe Gjermania janë të organizuara nga më së shumti 3 persona, të cilët lehtësisht evidentohen me zarfet e mbishkruara me dorën e njëjtë nga i njëjti person për vend dërgesa të ndryshme si Linc- Donau, Haid bei Ansfelden, nga Viena dhe Cyrihu, të cilat në postë janë dërguar nga i njëjti person brenda disa minutave.

Subjekti Politik NN, kërkon nga PZAP-i, që të aprovohet në tërësi ankesa dhe të anulohen fletëvotimet e dorëzuara përmes postës në Raundin e Dytë të Zgjedhjeve Lokale 2021, për Kryetar të Komunës së Dragashit, dhe të urdhërohet KQZ-ja, që të shpallë Rezultatet Përfundimtare për Komunën e Dragashit duke i përjashtuar rezultatet e Votimit me postë.

### Arsyetimi i Panelit – PZAP



Në fazën e procesit zgjedhor në të cilën është procesi i Zgjedhjeve Lokale 2021, paneli vlerësoi lejueshmërinë e paraqitjes së ankesës në këtë fazë të procesit dhe gjeti se ankesa është e lejuar në kuptim të nenit 105 par.1 të LZP, pasi që kemi të bëjmë me kërkesën e ankuesit sa i për ketë administrimit të fletëvotimeve me postë në QNR. Në nenin 105 par. 1 është përcaktuar se “Ankesat lidhur me administrimin e numërimit në QNR dorëzohen me shkrim pranë PZAP-it brenda njëzet e katër (24) orëve nga ndodhja e shkëljes së supozuar”, andaj paneli pasi që ka gjetur se ankesa është e lejuar, është lëshuar në meritat e vendosjes sipas kësaj ankese.

Paneli pas vlerësimit të shkresave të lëndës dhe hetimeve të bëra konstatoi se tek pakot e fletëvotimeve të dorëzuara nga votuesit e shtetit të Austrisë, Gjermanisë dhe të Zvicrës, tek disa familje kishin dorëshkrimin e njëjtë, me rastin e plotësimit në zarfin mbështjellës të fletëvotimeve dhe se mënyra e dorëzimit në postë e këtyre pakove ishte e organizuar.

Paneli kishte urdhëruar KQZ-në, që të gjitha fletëvotimet e dorëzuara përmes postës, për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve Lokale 2021, të mbajtura më datë 14.11.2021, për kryetar të Komunës në Dragash, ti anuloj dhe të njëjtat të mos i përfshijë në rezultatin përfundimtar.

**Ankesa është e bazuar**-Paneli konstaton nga vulat që janë vendosur në zarf nga postat pranuese, me rastin e pranimit të pakove të fletëvotimeve të lart cekura, se mënyra e dorëzimit në postë të këtyre pakove është pa dyshim e organizuar sepse siç u vlerësua më lart kemi të bëjmë me disa familje, me adresa të ndryshme brenda shtetit ku jetojnë dhe nuk është e mundur që të gjitha familjet së bashku ti dorëzojnë pakot e tyre në postë me fletëvotime në orët përfaqësues të njëjta (çështje minutash), dhe me data të njëjta, kur dihet që votimi për votuesit e diasporës zgjatë disa ditë, kjo mënyrë e organizimit të dorëzimit të pakove të fletëvotimeve nëpër postat është njëra ndër elementet që ndikon në minimin e integritetit të zgjedhjeve.

Nga raporti i statistikave të KQZ-së, për Zgjedhjet Lokale 2021, të raundit të dytë në Komunën e Dragashit, paneli konstaton se: 24 votues të Komunës së Dragashit, që kanë dërguar pako me fletëvotime nga jashtë Kosovës, të cilët në periudhën e aplikimit për regjistrim, si vendbanim në formularët e regjistrimit kanë dhënë shtete të ndryshme, pra nuk i kanë dërguar pakot me fletëvotime nga ato shtete që i kanë shkruar në formularë me rastin e aplikimit dhe që ishin regjistruar me adresën si votues jashtë Kosove. Prej votuesve të lartcekur, 10 prej këtyre votuesve kanë dërguar pako me fletëvotime nga Austria, ndërsa në formularët e aplikimit për regjistrim e kanë deklaruar se e kanë vendbanim në shtetin e Italisë, 6 votues, i kanë dërguar pako me fletëvotime nga shteti Austria, ndërsa në formularët e aplikimit për regjistrim e kanë deklaruar si vendbanim, shtetin e Gjermanisë, 1 votues ka dërguar pako me fletëvotime nga Gjermania, ndërsa në formularin e aplikimit për regjistrim e ka deklaruar si vendbanim, shtetin e Zvicrës, 2 votues kanë dërguar pako me fletëvotime nga Austria, ndërsa në formularët e aplikimit për regjistrim e kanë deklaruar si vendbanim, shtetin e Republikës së Çekisë, 4 votues kanë dërguar pako me fletëvotime nga Franca, ndërsa në formularët e aplikimit për regjistrim e kanë deklaruar si vendbanim, shtetin e Maqedonisë së Veriut dhe 1 votues ka dërguar pako me fletëvotime nga Austria, ndërsa në formularin e aplikimit për regjistrim e ka deklaruar si vendbanim, shtetin e Zvicrës.

## Shënim

*Paneli duke u bazuar në të gjitha shkeljet e theksuara më larte dhe arsyet e dhëna, duke u bazuar në nenet 117, 118 dhe në nenin 120 par.1 pika b) të LZP-së, ku përcaktohet se para certifikimit të rezultateve zgjedhore, është në kompetencë të PZAP-it, në raste të jashtëzakonshme të anuloi rezultatet në një vendvotim apo qendër votimi, nëse konsideron se ka ndikim në rezultatin final, dhe në rrethana të jashtëzakonshme është në fushe veprimin e PZAP-së, për të evituar shkeljet dhe parregullsitë që janë evidentuara gjatë procesit të votimit, në këtë rast me postë, duke mos përfshirë ato fletëvotime me rastin e shpalljes së rezultatit përfundimtar.*

*Andaj, mënyra e tillë e organizimit të votimit, vlerësohet nga paneli, si jo i ligjshëm dhe si i tillë e dëmton seriozisht procesin zgjedhor të Raundit e Dytë për Kryetar në Komunën e Dragashit.*

*Për hetime të mëtejshme lidhur me elementet e veprës penale në këtë rast konkret, paneli duke u bazuar në nenin 3 par.11 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, me Nr.02/2015, lëndën do ta dërgon në Prokurorinë e Shtetit, duke mos e paragjykuar*

*ndonjë procedurë tjetër pasi që vendimet e PZAP-së, janë të karakterit administrativ.*

*Vendimin në fjalë subjekti politik NN, e kishte apeluar në Gjykatën Supreme të Kosovës, dhe se kjo gjykatë me Aktgjykimin me nr. A.A nr.84/2021, e kishte ndryshuar pjesërisht vendimin e PZAP-it, Anr. 1143/2021, duke Urdhëruar KQZ-në që të bëjë përsëritjen e procesit të votimit për votuesit jashtë, Kosove, për Raundin e Dytë të zgjedhjeve, për kryetar të Komunës së Dragashit.*



